


VLERËSIM BAZË

PËR INSPEKTIMIN, HETIMIN DHE NDËSHKIMIN E
KUNDËRVAJTJEVE DHE KRIMEVE MJEDISORE NË SHQIPËRI



Ky dokument u financua, si pjesë e projektit të prezencës së OSBE-së në Shqipëri, "Forcimi i Qeverisjes dhe Sigurisë Mjedisore në Shqipëri", mbështetur nga Qeveritë e Norvegjisë dhe Francës. Gjithsesi pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të Qeverisë së Norvegjisë dhe asaj të Francës.

Menaxhues të Projektit: Dr. Elton Qendro,
Menaxher Projekti,
Zyrtar Vendas për Qeverisjen Mjedisore dhe Vendore, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Ergi Bregasi,
Asistent Projekti, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Autorë: L.LM. Olsi Çoku; PhD. Ornela Shoshi; Dr. Genti Kromidha; M.Sc. Olsi Nika;

Statusi: Janar 2023

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Sheshi "Italia",
Tirana, Albania
Office: +355 4 2240001
pm-al@osce.org

Mohim përgjegjësie:

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë vlerësim bazë janë tërësisht të autorëve dhe nuk duhet t'i atribuohen në asnjë mënyrë prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Falenderime



Ky raport u hartua nga një ekip ekspertësh të kontraktuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri që përfshin: Olsi Coku, Ornela Shoshi, Genti Kromidha, Olsi Nika.

Ekipi i ekspertëve dëshiron t'ju shpreh mirënjohjet dhe falenderimet të gjithë ekspertëve, prokurorëve, drejtuesve të policisë, inspektorëve mjedisore, dhe gjithë institucioneve që kontribuan me informacion dhe morën pjesë në intervista dhe në takimin teknik, duke përfshirë: Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Rrethit Durrës, Prokurorinë e Rrethit Elbasan, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Ujore, Shkollën e Magjistraturës, Akademinë e Sigurisë, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe atyre mediatike.

Dëshirojmë të falënderojmë palët e interesuara për kontributin e tyre të vlefshëm përgjatë takimeve dhe intervistave konsultuese. Veçanërisht dëshirojmë të falënderojmë Anila Leka, Adriana Petri, Josif Shtëmbari, Juljan Hodaj, Lediana Karalliu, Neritan Postoli, Marjeta Perlalaj, Nexhip Hysonlako, Xhek Nezha, Bajram Kullolli, Ornela Poçi, Alba Zhori, Irma Themeli, Hubert Toshi, Fjoralba Tota, Bledar Dollaku, Arben Rakipi, Ina Vejsiu, Jolia Korita, Taulant Bino, Aleksander Trajçe, Kristina Voko, Ola Mitre, Esmeralda Keta, Artan Rama, Sabina Veizaj, Luljeta Barjamaj, Sajmir Shehu, Gentian Habazaj, Arber Berexha, Aida Cakaj, Luljeta Progni, Apostol Qirko, Denis Vogli, Mihallaq Qirjo, Ervin Buzi, Erinda Misho, Alminda Mema, Edvin Pacara, Ottaviani Fabio, Erald Xeka, Madrid Kullolli, Gezim Veizi, Alba Zhori, Entelena Ndrevataj, Jola Proko, Ilir Bala, Artion Seferi.



Përmbledhja ekzekutive

Krimet mjedisore po kthehen në një problem në rritje dhe me rëndësi që ngadalësojnë politikat qeveritare për të menaxhuar dhe mbrojtur mjedisin në mënyrë të qëndrueshme. Sipas raportit të Interpol-it (2018)¹, krimet mjedisore janë në rritje dhe rrjetet e organizuara kriminale i përdorin, duke marrë shkas se këto krime janë me rrezik të ulët dhe fitim të lartë. Ndërsa legjislacioni mjedisor përparon, kostot e pajtueshmërisë rriten. Me qëllim uljen e kostove, individë apo grupe kriminale përfitojnë nga boshllëqet ligjore, kontrolli i dobët apo kapacitetet e ulëta inspektuese dhe hetuese. Prandaj, legjislacioni efektiv rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve përgjatë zinxhirit të kontrollit, inspektimit dhe hetimit është i domosdoshëm për të adresuar mjedisore.

Ky raport paraqet vlerësimin bazë, duke marrë në konsideratë analizën e kornizës ligjore, kapacitetet institucionale dhe ekspertizën teknike. Raporti është realizuar gjatë harkut kohor tetor 2022 – janar 2023 përmes shqyrtimit të bazës ligjore, literaturës, realizimit të 25 intervistave institucionale dhe validimit të gjetjeve në një uorkshop teknik me pjesëmarrjen e 40 pjesëmarrësve nga agjencitë ligjzbatuese, menaxhuese, policisë, prokurorisë, shoqërisë civile, medias dhe botës akademike të mbajtur në 2 shkurt 2023.

Ndërgjegjësimi i kufizuar institucional, legjislacioni i paqartë, burimet e pamjaftueshme, boshllëqet në aftësi dhe kapacitete, si dhe koordinimi i pamjaftueshëm ose i munguar ndërmjet autoriteteve janë shkaqet kryesore që ende kryhen krime mjedisore. Sanksionet e parashikuara për krimet mjedisore duket se janë pak parandaluese dhe jo efektive. Për më tepër, proporcionaliteti i disa sanksioneve kundrejt shkelësve në raport me dëmet aktuale të shkaktuara ndaj mjedisit dhe shëndeti e njeriut është gjithashtu i diskutueshëm.

Megjithatë, vlerësimi bazë nxorri në pah mundësitë dhe rekomandime konkrete. Vëmendja politike ndaj krimeve mjedisore është duke u rritur. Analiza thekson se ngritja e një grupi institucional për të bashkërenduar luftën ndaj shkeljeve mjedisore është e rëndësishme. Gjithashtu, është e rëndësishme forcimi i kapaciteteve institucionale, njohurive teknike dhe akademike dhe vendosja e kriterëve të sakta ligjore për sanksionet e këtyre shkeljeve. Puna dhe kontributi i organizatave të shoqërisë civile dhe medias investigative ngelen thelbësore për të tërhequr vëmendjen institucionale.

¹ Raporti vjetor 2018, Interpol

TABELA E PËRMBAJTJES

Falenderime	2
Përmbledhja ekzekutive	3
Tabela e përmbajtjes.....	4
Lista e shkurtimeve	6
Lista e tabelave	7
Lista e figurave	7
1. HYRJE	8
1.1. Konteksti i përgjithshëm	8
1.2. Objektivat e vlerësimit	9
2. METODOLOGJIA E STUDIMIT	11
2.1 Llojet e metodave të hulumtimit të përdorura.....	11
2.2 Palët e interesuara të përfshira në raport	12
2.3 Kufizimet e raportit	12
3. VLERËSIMI I KUADRIT LIGJOR	13
3.1 Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me zbatimin e ligjeve mjedisore dhe luftën kundër krimit mjedisor	13
3.1.1 Konventat kryesore	13
3.1.2 Niveli i harmonizimit të konventave dhe direktivave në legjislacionin Shqiptar.	15
3.2 Legjislacioni i BE-së dhe legjislacioni kombëtar për krimin mjedisor.....	15
3.2.1. Legjislacioni i BE-së për krimin mjedisor dhe mbrojtjen e mjedisit.....	15
3.2.2. Legjislacioni kombëtar për mjedisore.....	21
3.3 Politikat dhe strategjitë kombëtare për adresimin e çështjeve që lidhen me krimin mjedisor	27
4. VLERËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL.....	29
4.1 Institucionet qeveritare me rol inspektues.....	29
4.2 Institucionet ligjzbatuese	32
4.3 Institucione të tjera	33
5. ANALIZA E MANGËSIVE	38
5.1. Mangësitë në kuadrin ligjor	38
5.1.2. Ndëshkueshmëria e krimeve mjedisore.....	41
5.2 Mangësitë në kuadrin institucional, aspektin e kapaciteteve, burimeve dhe infrastrukturë.....	43
5.3 Bashkëpunimi, mbivendosja, duplikimi i rolit dhe qartësim i kompetencave	46
Informimi, OJQ-të dhe media	48
6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	49
6.1. Propozime për përmirësimin e kuadrin ligjor.....	51
6.2 Rekomandime për forcimin e kuadrin institucional, kapaciteve, burimeve dhe infrastrukturës	53

LITERATURA	56
Shtojca	58
Shtojca nr.1: Gjetje dhe rekomandime të shtuara nga takimi teknik i mbajtur në 2 shkurt 2023.....	58
Shtojca nr.2: Pyetje të mundshme kërkimore: Analiza ligjore, mjedisore dhe institucionale	61
Shtojca nr.3: Lista e aktorëve dhe institucioneve të intervistuar	65
Shtojca nr.4: Lista e harmonizimit të direktivave dhe koventave mjedisore	66

Lista e shkurtimeve

AKZM	Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura
ADZM	Agjencia Rajonale për Zonat e Mbrojtura
AMBU	Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AOS	Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Investigimit dhe Rportimit
BE	Bashkimi Evropian
DG-NEAR	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
FSHN	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
GKKKM	Grupi Këshillimor Kundër Krimit Mjedisor
KE	Komisioni Evropian
MMSH	Marrëveshjeve Mjedisore Shumëpalëshe
NjQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
RGJM	Raporti i Gjendjes së Mjedisit
SANE 27	Mbështetja e negociatave shqiptare në fushën e mjedisit - Kapitulli 27
SELP	Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut
UT	Universiteti i Tiranës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e tabelave

Tabela 1. Përmbledhje e dënimeve për veprat penale kundër mjedisit.....	26
Tabela 2. me frekuencë më të lartë 2020/21. Burimi: Prokuroria e Përgjithëshme	42

Lista e figurave

Figura 1. Procesi kërkimor i Vlerësimit Bazë	11
Figura 2. Kuadri strategjik, ligjor për krimin mjedisor në Shqipëri.....	27



Hyrje

1. Hyrje

1.1. Konteksti i përgjithshëm

Veprat penale kundër mjedisit ashtu si një pjesë e mirë veprave penale në përgjithësi ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Megjithatë në kontekstin e këtij punimi, duke huazuar edhe mënyrën e të shprehurit të Direktivës 2008/99/EC "Për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal" të Komisionit Europian, është përdorur termi "krim mjedisor" për t'iu referuar çdo aktiviteti të paligjshëm që dëmton mjedisin për përfitime financiare të individëve, grupeve ose kompanive. Pra, pavarësisht përdorimit simbolik të fjalës krim mjedisor, sipas kontekstit kjo do të nënkuptojë gjithmonë krimin ose kundërvajtjen penale dhe atë administrative përkatëse sipas rastit, në bazë të rregullimit dhe sanksionimit në Kodin Penal dhe legjislacionin administrativ. Veprat penale kundër mjedisit mund të përfshijnë ndër të tjera, shfrytëzimin dhe trafikimin e paligjshëm të burimeve natyrore, duke përfshirë florën dhe faunën, si dhe ndotjen e tokës dhe ujit nga hedhja e paligjshme e mbetjeve.

Disa krime mjedisore bien gjithashtu në kategorinë e krimit të organizuar dhe ndërkombëtar,² pasi grupet dhe rrjetet kriminale po përfshihen gjithnjë e më shumë në këtë biznes fitimprurës në rritje. Shumë shpesh *modus operandi* i rrjeteve kriminale përfshin korrupsionin, pastrimin e parave, krimin financiar, humbjen e të ardhurave nga taksat, tregtimin paralel me forma të tjera të veprimtarisë kriminale dhe shtrembërimin e ekonomisë së ligjshme.³

Krimet mjedisore jo vetëm që ndikojnë rëndë cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës, duke kërcënuar mbijetesën e specieve dhe duke shkaktuar fatkeqësi të pakontrollueshme, por ato paraqesin gjithashtu kërcënime për sigurinë dhe për një numër të madh njerëzish me ndikime të konsiderueshme negative në zhvillim dhe minojnë sundimin e ligjit.

Ekzistojnë një numër i madh i Marrëveshjeve Mjedisore Shumëpalëshe (MMSH) për të trajtuar çështje të ndryshme, duke përfshirë, ndër të tjera: biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, mbrojtjen e shtresës së ozonit, shkretëtirëzimin, menaxhimin e kimikateve dhe mbetjeve, ndotjen ndërkufitare të ujit dhe ajrit, qeverisjen mjedisore dhe përgjegjësi mjedisore.

Megjithatë, mjedisore shpesh dështojnë të nxisin një përgjigje të përshtatshme qeveritare. Të perceptuara shpesh si krime "pa viktima" dhe të rastësishme, mjedisore shpesh renditen poshtë në listën e prioriteteve të zbatimit të ligjit dhe zakonisht ndëshkohen me sanksione të ulëta, si rezultat i përkufizimeve të paqarta dhe keqinterpretimit të koncepteve.⁴

Në këtë kontekst, ky vlerësim bazë mundëson një analizë të detajuar të kuadrit ligjor mjedisor shqiptar, të kapaciteteve institucionale, duke përfshirë si aspektin e burimeve njerëzore dhe financiare, ashtu edhe aspekte të veprimtarisë së tyre. Vlerësimi analizon dhe bashkëpunimin institucional.

² Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional nuk përmban një përkufizim të krimit të organizuar transnacional ose krimit të organizuar, por ajo përcakton "një grup kriminal të organizuar në (neni 2a) si "një grup prej tre ose më shumë personave që ekzistojnë gjatë një periudhe kohore që veprojnë në bashkëpunim me qëllimin e kryerjes së krimeve për përfitime financiare ose materiale." Ky përkufizim u miratua gjithashtu në Vendimin Kuadër të Këshillit të BE-së 2008/841/JHA të datës 24 tetor 2008 për luftën kundër krimit të organizuar. Europol përfshin në mënyrë specifike trafikimin e specieve të rrezikuara midis aktivitetet kriminale të kryera nga grupet e krimit të organizuar. Shih EUROPOL, "Përcaktimi i krimit të rëndë dhe të organizuar." <https://www.europol.europa.eu/socta/2017/defining-serious-and-organised-crime.html>

³ Krimi i rëndë përkufizohet në nenin 2, nënparagrafi (b), i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC) si "sjellje që përbën një veprë të dënueshme me një heqje maksimale të lirisë prej të paktën katër vjet ose një dënimi më të rëndë". Shih Konferencën e Palëve në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (2012), "Nocioni i krimit të rëndë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", sesioni i gjashtë, Vjenë, 15-19 tetor 2012. https://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/COP6/CTOC_COP_2012_CRP/CTOC_COP_2012_CRP4.pdf

⁴ Huisman J., Botezatu I., Luda di Cortemiglia V. et al., 2015, p.20

Hartimi i një raporti të tillë për vlerësimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe praktikën në ndjekjen hallkë pas hallkë të personave që shkelin ligjin apo çenojnë parimet ndërkombëtare në mbrojtje të mjedisit është i nevojshëm për të arritur një vështrim më të qartë të punës që realizohet nga institucionet ligj zbatuese, qofshin këto administrative apo të ndjekjes penale. Prandaj, ky raport shërben edhe për hulumtimin dhe vlerësimin e hapësirave për përmirësim, sidomos sa i përket inspektimit, forcimit të zbatimit të ligjit , nëpërmjet hetimit të duhur dhe ndjekjes penale.

Përgjatë **analizës ligjore**, është realizuar edhe një studim i nivelit të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë Bashkimit Evropian dhe më gjerë, sa i përket ndëshkueshmërisë së krimeve mjedisore dhe zbatimit në praktikë të këtyre ligjeve e parimeve ndërkombëtare.

Forcimi i **hallkave institucionale** ose së paku përmirësimi dhe rritja e efikasitetit në veprimtarinë e tyre parashikohet si një nga arritjet që synohen dhe që mund të realizohen përmes mbështetjes së vazhdueshme institucionale dhe vlerësimeve dhe analizave ligjore.

Vlerësimi i realizuar përmes këtij punimi lidhur me raportimin dhe pasqyrimin e kuadrit ligjor nga njëra anë dhe kapacitetet institucionale nga ana tjetër, shërbejnë për krijimin e një panorame më të qartë të gjendjes aktuale dhe aspekteve ku paraqitet nevoja për përmirësim. Vlerësimi ka analizuar shkaqet, ndikimin dhe ekzistencën e shkeljeve të ligjit mjedisor, **kapacitetet, aftësitë, njohuritë dhe nevojat për trajnimin e mëtejshëm** apo përforsim të burimeve njerëzore dhe materiale për agjencitë shtetërore, dhe organet e tjera që veprojnë në mbrojtje të mjedisit.

Duke u përqendruar te kuadri ligjor, planet e veprimit dhe politikat shtetërore, ekspertët e patën edhe më të qartë se cilat janë rekomandimet më urgjente dhe cilat janë përmirësimet afatgjata që Shqipëria duhet të realizojë në aspektin e legjislacionit mjedisor dhe zbatimit të tij për të luftuar krimin kundër mjedisit në mënyrën më efektive të mundshme.

1.2. Objektivat e vlerësimit

Ky Vlerësim Bazë është rezultat i kërkimit dhe punës që është realizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadër të Projektit “Forcimi i Qeverisjes dhe Sigurisë Mjedisore në Shqipëri”,⁵ me qëllim mbledhjen e informacionit të saktë dhe të besueshëm për kapacitetet dhe aftësinë e vendit në parandalimin, ndëshkimin dhe hetimin e krimeve kundër mjedisit.

Ndër objektivat dhe synimet kryesore të këtij vlerësimi janë radhitur më poshtë:

1. Së pari evidentimi i legjislacionit përkatës, normave ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ndëshkimit të shkeljeve në mjedis,⁶
2. Së dyti roli i institucioneve të përfshira përgjatë gjithë zinxhirit të përputhshmërisë, forcimit ligjor dhe hetimit e ndëshkimit të krimeve mjedisore në vend,
3. Së treti analiza e sfidave në zbatimin praktik të hetimit, gjykimin dhe ndëshkimit të krimeve mjedisore, si dhe paraqitja e problematikave dhe hapësirave për përmirësim në drejtimin e kapaciteteve dhe nevojave.

⁵ Mbështetur nga Qeveria e Norvegjisë dhe e Francës.

⁶ Pyetjet kërkimore që kanë udhëhequr ekspertët në këtë studim punim janë: Sa shtrëngues është legjislacioni shqiptar në garantimin e një mjedisi të pastër dhe në ndëshkimin e krimeve mjedisore? A janë harmonizuar ligjet dhe aktet nënligjore të Shqipërisë me direktivat e Bashkimit Evropian? Në ç’masë zbatohen ligjet në mbrojtje të mjedisit? A është e qartë ndarja e përgjegjësisë për secilin institucion sa i përket zbatimit të ligjit dhe ndëshkimit të shkeljeve mjedisore? Cilat janë hapësirat apo mangësitë e legjislacionit të mjedisit që mund të krijojnë premisa për mosndëshkimin e shkeljeve në dëm të mjedisit? Cilat janë faktorët kryesorë që ndikojnë në krijimin e pengesave për realizimin sa më të mirë të mundshëm të zbatimit praktik të legjislacionit mjedisor? Cilat janë shkeljet më të shpeshta dhe më të mëdha? Cilat janë mangësitë në kuadrin ligjor të cilat kanë nevojë më urgjente për përmirësim dhe në cilat aspekte ka nevojë për rregullim të mëtejshëm e më të detajuar?

Raporti është i ndarë në krerë që trajtojnë përkatësisht vlerësimin e kuadrit ligjor, vlerësimin e kuadrit institucional dhe analizat e mangësive në aspektin ligjor, institucional, në kontekstin e kapaciteteve, të burimeve dhe infrastrukturës, si dhe propozimet për kuadrin ligjor dhe institucional duke përfshirë edhe mekanizmat e mundshëm të bashkëpunimit.

Sa i përket kuadrit ligjor vlerësimi realizohet duke analizuar konventat dhe marrëveshjet mjedisore ndërkombëtare që lidhen me zbatimin e ligjeve mjedisore dhe luftën kundër krimit mjedisor, legjislacionin e Bashkimit Europian lidhur me krimin mjedisor dhe politikat e strategjitë kombëtare që adresojnë çështje lidhur me mjedisin.

Shqyrtimi i legjislacionit ndërkombëtar, e sidomos atij të Bashkimit Europian ndihmon në krijimin e një vizioni më të qartë sa i përket fushave që prezantojnë një nevojë më urgjente për përmirësimin, qoftë në kuadrin ligjor, qoftë në zbatimin e legjislacionit nga ana e institucioneve përgjegjëse. Për më tepër, vështrimi krahasues midis ligjeve të BE-së dhe atyre shqiptare në lidhje me krimin mjedisor paraqet edhe më qartë se sa po realizohen prioritet e vendosura nga Shqipëria, edhe si parakusht për t'u anëtarësuar në BE.

Harmonizimi sa më i mirë i ligjeve mundëson dhe rrit më tej hapësirat për realizimin e bashkëpunimeve më të efektshme mes vendit tonë dhe vendeve fqinje në rajon, BE e më tej. Po ashtu shqyrtimi i ndryshimeve më të fundit në legjislacionin europian krijon një premise për parashikimin e amendimeve që mund të priten në të ardhmen për kuadrin ligjor shqiptar kundër krimeve mjedisore.



2 Metodologjia e studimit



2. Metodologjia e studimit

2.1 Llojet e metodave të hulumtimit të përdorura

Raporti është realizuar përmes një analize të detajuar bazuar në një metodologji gjithëpërfshirëse që përmban dy faza të mbledhjes së të dhënave:

- 1) realizimin e kontekstit të përgjithshëm të kuadrit ligjor aktual, autoritetet përkatëse, shkaqet, ndikimi dhe ekzistenca e krimeve kundër mjedisit në Shqipëri;
- 2) vlerësimi i njohurive, kapaciteteve dhe nevojave të aktorëve përgjatë gjithë zinxhirit të përputhshmërisë dhe zbatueshmërisë, duke përfshirë policinë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, prokurorinë dhe përfaqësues të gjyqësorit.

Ekipi i ekspertëve ka zbatuar hapat e mëposhtëm për të përpiluar këtë raport:



Figura 1. Procesi kërkimor i vlerësimit bazë

1. Hulumtim dokumentar – i realizuar përmes shqyrtimit të ligjeve, akteve nënligjore, strategjive, politikave dhe dokumenteve zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe raporteve ndërkombëtare lidhur me krimin mjedisor në Shqipëri. Raportet vjetore, të dhënat statistikore lidhur me identifikimin dhe ndëshkimin e krimit mjedisor nga institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare kanë shërbyer për të realizuar një vështrim krahasues ndërmjet të dhënave të deklaruara zyrtarisht dhe raportimit të realizuar nga partnerë ndërkombëtarë si aktorë të interesuar, por edhe mjaft të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit në fuqi në mbrojtje të mjedisit.

2. Përgatitja dhe realizimi i intervistave – të realizuar përmes analizimit të të dhënave të mbledhura nga realizimi i intervistave me aktorë të përfshirë dhe të interesuar, duke nisur nga institucionet shtetërore përgjegjëse si: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prokuroria e Përgjithshme, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, agjencitë e varësisë, etj.

3. Sintetizimi i gjetjeve dhe rekomandimeve - ofruar nga institucione ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen faktike të mjedisit dhe ndëshkimin administrativ ose gjyqësor të krimit mjedisor siç është Progres Raporti i BE-së, UNODC⁷, Europol, Eurojust dhe IMPEL.

⁷ Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin

4. Analiza e informacionit të mbledhur - të paraqitura si përgjigje ndaj pyetësorëve të përgatitur për takimet dhe konsultimet e realizuara me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore përgjegjëse për aspekte të caktuara të kontrollit lidhur me zbatimin e krimit mjedisor dhe ndëshkimin efektiv të tij.

5. Validimim i fakteve - lidhur me perceptimin e efektshmërisë së zbatimit të legjislacionit në mbrojtje të mjedisit, nga aktorë të tjerë si media dhe OJF përmes një uorkshopi teknik konsultues të mbajtur në 2 shkurt 2023.

6. Përcaktimi i përfundimeve dhe rekomandimeve - të arritura bazuar në përmbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore të grumbulluara më sipër, duke u bazuar edhe në diskutimet e zhvilluara gjatë takimeve mes ekspertëve pjesëmarrës në hartimin e këtij raporti.

2.2 Palët e interesuara të përfshira në raport

Realizimi i një numri takimesh me palë të interesuara në mbrojtjen e mjedisit dhe ndëshkimin e krimit mjedisor, ishte një nga mënyrat më të mira për të përfituar një këndvështrim mbi perceptimin e legjislacionit mjedisor dhe zbatimit praktik të tij. Përzgjedhja e palëve të interesuara të cilat do të takoheshin për t'u intervistuar, u arrit përmes dakortësimit të grupit të ekspertëve në takimet e tyre, duke synuar përfshirjen sa më të gjerë të të gjitha palëve. *(Shih Shtojcën B për listën)*

Ekspertët realizuan takime me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Akademia e Sigurisë, Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Shkolla e Magjistraturës, Universiteti i Tiranës, bashkitë dhe donatorët, të cilat u realizuan sipas kalendarit të dakortësuar me OSBE-në në periudhën 15 tetor - 24 dhjetor 2022. Këto takime shërbyen për të paraqitur një sërë të dhënash të reja për ekspertët të cilat u përdorën në vijim për të realizuar analizën sasiore dhe cilësore të punimit lidhur me kryerjen e krimeve mjedisore, e sidomos në lidhje me ndjekjen dhe ndëshkimin e tyre, qoftë në aspektin administrativ, ashtu dhe në atë penal. Pyetjet kërkimore të paraqitura në shtojcën e raportit (Shih Shtojcën 4), shërbyen si pikënisje për realizimin e seksioneve të raportit, duke krahasuar të dhënat e viteve të mëparshme me ato të vitit 2022 apo ato të institucioneve vendore me ato qendrore.

2.3 Kufizimet e raportit

Hartimi i raportit vlerësues është realizuar duke kapërcyer disa vështirësi dhe kufizime të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kohën e shkurtër në dispozicion (Tetor 2022 – Dhjetor 2023) dhe hapësirën e studimit. Kufizimi në kohë, ka sjellë vështirësi dhe kufizime në numrin e institucioneve, kryesisht vendore/rajonale, të intervistuar dhe si rrjedhim mund të ketë disa mangësi në paraqitjen e tërësishme të situatës institucionale në vend lidhur me identifikimin, ndjekjen dhe procedimin e krimeve mjedisore. Nga ana tjetër, periudha aktuale (2022), kushtëzuar dhe ndikuar ndjeshëm nga procesi i integritimit në Evropë, është tepër dinamike përse i përket përmirësimit të legjislacionit dhe ndryshimeve institucionale. Ndërsa pritet të miratohen ligje të reja apo ndryshime në legjislacionin e vendit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të BE-së për harmonizim, po ashtu edhe në aspektin institucional disa ndryshime që kanë të bëjnë me ristrukturimet institucionale vitet e fundit kanë krijuar konfuzion për sa i përket dublimit të punës.

Më në detaje, këto situata janë shpjeguar në krerët në vijim. Teksa fokusi i studimit është krimi mjedisor dhe ndëshkimi i tij, shumë prej ligjeve të konsultuara për këtë raport nuk detajojnë qartë se cilat janë pasojat konkrete të kryerjes së një shkelje në fushën e mjedisit.



3 Vlerësimi i kuadrit ligjor



3. Vlerësimi i kuadrit ligjor

3.1 Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me zbatimin e ligjeve mjedisore dhe luftën kundër krimit mjedisor

Shqipëria i ka ratifikuar MSHM më të rëndësishme (*shih Aneks 1*). Gjithashtu, duke qenë se Shqipërisë i është dhënë statusi i vendit kandidatit për në BE në qershor 2014, ajo është e angazhuar për të transpozuar acquis mjedisor të BE-së në kuadrin e saj ligjor.

Të gjitha ligjet shqiptare për mbrojtjen e mjedisit që nga viti 1993 kanë theksuar se mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi është një prioritet kombëtar. Kuadri legjislativ për mbrojtjen e mjedisit që atëherë është zhvilluar në një kuadër të gjerë, i cili përfshin: kushtetutën, kodin penal, ligjin kuadër për mbrojtjen e mjedisit, ligjet sektoriale dhe akte nënligjore në përputhje me traktatet ndërkombëtare mjedisore ku Shqipëria është palë.⁸ Ky kre përmban më poshtë një shpjegim të zgjeruar të konventave kryesore ku ka aderuar Shqipëria si dhe tabelën e harmonizimit të të gjithë konventave dhe akteve ligjore evropiane në legjislacionin shqiptar.

3.1.1 Konventat kryesore

Konventa e Bazelit. Shqipëria, aderoi në vitin 1999 në Konventën “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”⁹ nëpërmjet ligjit nr.8216, datë 13.5.1997 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit”. Sipas Konventës, shtetet që janë palë të saj duhet të vendosin një politikë të përshtatshme penale në legjislacionin penal dhe legjislacionin e menaxhimit të mbetjeve dhe të ndëshkojnë rreptësisht trafikun e paligjshëm të mbetjeve të rrezikshme. Në ligjin shqiptar, këto të fundit përkufizohen sipas listave të Anekseve I, II dhe VIII të Konventës së Bazelit dhe Listës Evropiane të Mbetjeve.

Konventa e Stokholmit. Shqipëria aderoi në Konventën e Stokholmit në 2004 nëpërmjet ligjit nr.9263, datë 29.07.2004¹⁰. Në vitin 2006 u miratua Plani Kombëtar i Veprimit “Për reduktimin dhe asgjësimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm”, i cili iu dorëzua Sekretariatit të Konventës në 2007 si plan kombëtar i zbatimit të Konventës, ende nën rishikim me mbështetjen teknike dhe financiare të UNEP¹¹ dhe GEF¹². Në 2014 u dorëzua raporti i parë kombëtar, ndërsa tashmë Shqipëria ka miratuar një legjislacion kuadër për zbatimin e angazhimeve ndërkombëtare për kimikatet. Ligji “Për menaxhimin e kimikateve” nr. 27/2016 përcakton kuadrin ligjor për zbatimin e konventave ndërkombëtare në këtë fushë. Me synim përafrimin e plotë të kuadrit ligjor kombëtar me legjislacionin e BE-së, është miratuar legjislacioni shtesë mbi: regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve, eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme; klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve; testimi i kafshëve; asbestit; biocidet; dhe merkuri.

Konventa e Roterdamit. Shqipëria aderoi në Konventën e Roterdamit në vitin 2010 nëpërmjet ligjit nr. 10277, datë 13.05.2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit “Për procedurën e Pëlqimit të Informuar Paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e

⁸ Lista e plotë e ligjeve, marrëveshjeve mjedisore lidhur me mjedisin mund të aksesohet në: www.turizmi.gov.al/kuadriligjor

⁹ <http://www.basel.int/?tabid=4499>

¹⁰ <https://treaties.un.org/Pages/showActionDetails.aspx?objid=0800000280053a27&clang=en>

¹¹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin

¹² Fondit Global për Mjedisin

bimëve në tregtinë ndërkombëtare”¹³. Shqipëria i ka paraqitur Konventës procedurat për importimin e 47 kimikateve të listuara në Aneksin III të Konventës dhe që i nënshtrohen Procedurës së Pëlqimit të Informuar Paraprak. Në këtë kuadër me VKM nr. 665, datë 21.09.2016 “Për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme” synohet përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të BE-së.

Protokolli i Montrealit dhe amendimet e tij. Shqipëria ka aderuar në Konventën e Vjenës “Për mbrojtjen e shtresës së ozonit” dhe Protokollin e Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit” në vitin 1999. Shqipëria ka aderuar në të gjitha amendamentet.¹⁴ Ligji shqiptar përdor një sistem licencimi dhe kuotash për kontrollin e import/eksportit të hidroklorofluorokarbureve dhe përzierjeve që e përmbajnë, i cili zbatohet në mënyrë efektive e në përputhje me Protokollin e Montrealit. Oficerët doganorë janë trajnuar për monitorimin e importeve dhe parandalimin e tregtisë së paligjshme të substancave që shkatërrojnë ozonin.

Konventa CITES. Shqipëria ka aderuar në Konventën e CITES përmes ligjit nr. 9021, datë 06.03.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”¹⁵. Konventa CITES, e nënshkruar në Uashington dhe amenduar në Bon, Gjermani dhe Gaborone, Botsuana, rregullon në nivel ndërkombëtar lëvizjen e llojeve të caktuara të florës dhe faunës në rrezik, duke mbuluar importin, eksportin, tranzitin dhe riekportin e tyre. Synimi kryesor i saj është **eliminimi i tregtisë së paligjshme të florës dhe faunës**, ndërsa shkelja më e shpeshtë e saj përfshin tregtimin e palicencuar apo të paçertifikuar të llojeve të florës dhe faunës. Falsifikimi i këtyre dokumenteve është po ashtu një nga më të shpeshtat. Në Shqipëri megjithatë, e tregtimit të florës dhe faunës nuk raportohen ose identifikohen me ndonjë shpeshësi domethënëse.

Konventa e Bernës. Shqipëria ka aderuar në Konventën e Bernës, me ligjin nr. 8294, datë 02.03.1998 “Për ratifikimin e Konventës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës (Konventa e Bernës)”¹⁶. Kjo Konventë, nënshkruar në vitin 1979, ka si qëllim promovimin e bashkëpunimit mes palëve për ruajtjen e florës dhe faunës së egër, të mjedisit të tyre natyror dhe mbrojtjen e specieve migratore. Ai shërben si instrument për nxitjen e politikave kombëtare për ruajtjen e florës dhe faunës së egër, përfshirjen e tyre në politikat kombëtare të zhvillimit, planifikimit dhe mjedisit, si dhe të ndikojë në marrjen e masave ligjore dhe praktike për të ruajtur florën dhe faunën e për të mbrojtur mjedisin e tyre natyror.

Konventa e Bonit. Shqipëria ka aderuar në Konventën e Bonit me Ligjin nr. 8692, datë 16.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bonit “Për mbrojtjen e llojeve shtetguese të kafshëve të egra” dhe mirëkuptimet e kësaj konvente”¹⁷. Meqenëse në arenën ndërkombëtare, çështja e vrasjes së paligjshme të shpendëve ka fituar vazhdimisht rëndësi, sidomos vitet e fundit, Konventa për Speciet Migruese, së bashku me Konventën e Bernës shërbejnë si instrumente ligjore ndërkombëtare për caktuar kriteret dhe prioritetet kombëtare të hetimit dhe ndjekjes së veprave si vrasja, kapja dhe tregtia e paligjshme e shpendëve të egër.

Konventa e Aarhusit. Kjo konventë quhet ndryshe dhe “demokracia në fushën e mjedisit”, dhe paraqet një nga aktet më të rëndësishme në fushën e legjislacionit mjedisor në Shqipëri. Konventa e UNECE (KEEOKB-Komisioni Ekonomik për Evropën i OKB-së), e së Drejtës së Informacionit, Pjesëmarrjes Publike në Vendimmarrje, dhe Qasjes në Drejtësi në Çështje Mjedisore, u miratua më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhusit (Århus), nga mori dhe emrin “Konventa e Aarhusit”, dhe ku u nënshkrua edhe nga Shqipëria. Parlamenti shqiptar e ratifikoi konventën më 26 tetor 2000. Konventa hyri në fuqi më 30 tetor

¹³ <http://www.pic.int/Countries/Statusofratification/PartiesandSignatories/tabid/1072/language/en-US/Default.aspx>

¹⁴ https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=IND&mtdsg_no=XXVII-2-f&chapter=27&clang=_en

¹⁵ <https://cites.org/eng/disc/parties/chronolo.php>

¹⁶ <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=104>

¹⁷ <https://www.cms.int/en/parties-range-states>

2001. Konventa është një dokument juridik ndërkombëtar që vendos një sërë të drejtash për publikun dhe detyrime për autoritetet shtetërore. Konventa përmban tre shtylla themelore:

- E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor;
- E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
- E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit

3.1.2 Niveli i harmonizimit të konventave dhe direktivave në legjislacionin Shqiptar.

Pasi u shpjeguan konventat kryesore ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, gjendet Tabela nr. 1 e cila liston të gjithë aktet ndërkombëtare në formën e konventave (të shpjeguara dhe më lart) dhe direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke shfaqur dhe nivelin e tyre të harmonizimit me ligjin shqiptar (*Shih Shtojcën 3*).

3.2 Legjislacioni i BE-së dhe legjislacioni kombëtar për krimin mjedisor

3.2.1. Legjislacioni i BE-së për krimin mjedisor dhe mbrojtjen e mjedisit

Në vitin 2008, BE miratoi Direktivën kuadër për krimin mjedisor, përmes Direktivës 2008/99/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, më datë 19 Nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”, ku kriminalizohen veprat kundër mjedisit, duke përcaktuar edhe dënimet përkatëse në një formë të përmbledhur me legjislacionin e dedikuar, të cilin kanë detyrim ta zbatojnë të gjitha shtetet anëtare. Në Shqipëri, ndryshimet ligjore **të bëra në vitin 2019** në kreun IV të Kodit Penal janë bërë në përputhje me Direktivën e BE-së 2008/992, duke plotësuar kuadrin ligjor të veprave penale kundër mjedisit.

Shqetësimi i qeverive dhe organizatave ndërkombëtare që nuk po bëhet mjaftueshëm në parandalimin e ngrohjes globale dhe se e ardhmja mund të paraqesë një pamjaftueshmëri burimesh natyrore, pasqyrohet edhe në kërkesat e fundit të Komisionit Evropian¹⁸ për të forcuar mbrojtjen **e mjedisit përmes ligjit penal**, pasi rregullat aktuale nuk mjaftojnë për të trajtuar në mënyrë serioze mjedisore.

Sipas Komisionit Evropian¹⁹, të dhënat statistikore nga Interpoli dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, rendisin krimin mjedisor si të katërtin nga veprimtaritë më të mëdha kriminale pas trafikut të drogës, të qenieve njerëzore dhe falsifikimit. Krimi mjedisor sipas këtyre shifrave shënon, në vitet e fundit, rritje midis 5%-7% në vit, 2-3 herë më shumë se ritmi i rritjes ekonomike globale.²⁰ Duke cituar si burim Eurojust, KE ka vlerësuar edhe se trafikimi i paligjshëm i mbetjeve dhe i kafshëve të egra, e ndotjes dhe tregtia e paligjshme e substancave të rrezikshme janë ndër më të rënda mjedisore, por rregullat aktuale nuk i pengojnë ato në mënyrë efektive.

Pas një vlerësimi që Komisioni i bëri në vitet 2019-2020, Direktivës “Për krimin mjedisor” të 2008, arriti në përfundimin se nevojitet një reformë për të bërë më efektiv zbatimin e ligjit penal për mjedisin, pasi gjatë 10 viteve të fundit numri i rasteve të krimit mjedisor të hetuara dhe të dënuara me sukses mbeti shumë i ulët. Për këtë arsye, në fund të vitit 2021, Komisioni Evropian ka paraqitur një propozim²¹ për përmirësimin

¹⁸ Direktiva e BE-së mbi krimin mjedisor e rishikuar (europa.eu): https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_6745

¹⁹ Për më shumë shihni: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_6745

²⁰ Nellemann C., Henriksen R., Pravettoni R., et al., (Eds) (2018), “World atlas of illicit flows. A RHIPTO-INTERPOL-GI Assessment. RHIPTO -Norwegian Center for Global Analyses, INTERPOL and the Global Initiative Against Transnational Organized crime, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/09/Atlas-Illicit-Flows-FINAL-WEB-VERSION-copia-compressed.pdf>

²¹ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_6745

e legjislacionit të mjedisit, si pjesë e nismave në kuadër të Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, me qëllim **që të fuqizojë luftën kundër krimeve mjedisore**. Argumenti kryesor ishte se me Direktivën aktuale, numri i rasteve të kimit mjedisor të hetuara, të ndjekura penalisht dhe të dënuara me sukses mbetet i ulët. Përtej përcaktimit të llojeve të reja të krimeve, rrethanave lehtësuese dhe rënduese, përcaktohen për herë të parë edhe sanksione shtesë për shkelësit e ligjit në mbrojtje të mjedisit, si: tërheqja e lejeve, skualifikimet dhe përjashtimi nga aksesit në financimin publik. Këto konsiderohen më efektive se sanksionet financiare, veçanërisht për personat juridikë.

a. Mbrojtja e ajrit

Përgjatë viteve Parlamenti Evropian dhe Këshilli nxorën disa Direktiva që synonin të kontrollonin nivelin e kimikateve në ajër, përfshirë të substancave kancerogjene apo atyre që lëshohen nga djegia e karburanteve. Kështu, në 1994 Parlamenti miratoi Direktivën 94/63/EC për kontrollin e kimikateve organike që çlirohen nga depozitimi dhe shpërndarja e karburanteve në stacionet e furnizimit, ose ozonit, ndërsa në lidhje me mbrojtjen e ajrit nga mbetjet e karburanteve, u miratua Direktiva 1999/32/EC e cila u ndryshua disa herë në 10 vitet e mëpasshme, duke përcaktuar detyrimin për uljen e përmbajtjes së squfurit, për mbrojtjen nga niveli i substancave kancerogjene²². Akti më gjithëpërfshirës i BE-së për mbrojtjen e ajrit është Direktiva 2008/50/EC e vitit 2008, “Për cilësinë e ajrit të ambientit dhe për ajër më të pastër për Evropën”, ku vendosen themelet për kriminalizimin e mëtejshëm të ndotjes së ajrit.

b. Mbrojtja e ujit

Për herë të parë mbrojtja e ujit u sanksionua nëpërmjet Rregullave të Helsinkit “Për përdorimin e ujërave të lumenjve ndërkombëtarë” në 1966 ku flitej vetëm për ujërat në sipërfaqe apo mbi tokë, e më pas në Rregullat e Berlinit të vitit 2004, ku u përfshinë edhe ujërat nëntokësorë. Parimi kryesor në mbrojtje të mjedisit uhor është që shtetet palë të konventave në mbrojtje të ujit duhet të marrin të gjitha masat për të pakësuar ndotjen aktuale dhe të mos shkaktojnë dëm një pellgu uhor të një shteti tjetër, përndryshe duhet ta dëmshpërblejnë atë. Në **1972 u kriminalizua ndotja e deteve** përmes dy traktateve: Konventa e Oslos “Për parandalimin e ndotjes së deteve prej hedhjeve nga anijet dhe avionët” dhe Konventa e Londrës “Për parandalimin e ndotjes së deteve prej hedhjeve të mbeturinave dhe substancave të tjera”, ndërsa Konventa e CITES, e vitit 1973, përfshin edhe florën e faunën detare. Konventa e Parisit “Për parandalimin e ndotjes së deteve që vjen nga burimet tokësore” rregullon mbrojtjen e ujit nga burimet.

Në këtë drejtim, me Konventën e Helsinkit “Për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtarë”, në 1992, u forcuan masat kombëtare të të gjitha shteteve palë për mbrojtjen e ujërave ndërkombëtare sipërfaqësore e nëntokësore, duke i vënë të gjithë përpara përgjegjësisë për të mbrojtur mjedisin uhor të përbashkët, përmes sistemit të kompensimit të dëmit. Shqipëria ka aderuar në këtë Konventë që në 1994, ndërsa në amendamentet e saj në vitin 2014.

Sa i përket mbrojtjes së ujit, është miratuar Protokollin e Londrës “Për ujin dhe shëndetin”, në 1999, ku vendi ynë aderoi në 2002, si dhe Protokollin e Kievit “Për përgjegjësinë civile dhe kompensimin për dëmet e shkaktuara në ujërat ndërkufitare prej efekteve ndërkufitare të aksidenteve industriale”, krijoi një sistem të mirëfilltë të përgjegjësisë civile, për kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga efektet mbi ujërat ndërkufitare të aksidenteve industriale. Shqipëria bën pjesë edhe në traktatet rajonale si Konventa e Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe rajonit bregdetar të Mesdheut”, me protokollet e saj shtesë.

²² Direktiva 2004/107/EC

Në lidhje me hapësirat detare, BE ka të rregulluar me ligj mjedisor çdo basen ujëmbledhës lumor që mund të ketë efekte ndërkuftare. Direktiva Kuadër e BE-së për mbrojtjen e mjedisit, u pasua nga një Direktivë specifike për Ujërat Sipërfaqësorë, Direktiva 2006/118/EC, Direktiva 2007/60/EC273 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmytjet dhe Direktiva 2008/56/EC274 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, që krijoi kuadrin e veprimit komunitar në fushën e politikës mjedisore detare, quajtur edhe Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare, sipas së cilës shtetet anëtare duhet të hartojnë plane për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar.

Në mbrojtje të mjedisit sa i përket ujit, Shqipëria ka aderuar në: Konventën e UNECE “Për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkuftare dhe liqeneve ndërkombëtare” dhe protokollin e saj, Konventën ‘Për mbrojtjen e detit Mesdhe nga ndotja dhe ruajtjen e biodiversitetit’ dhe protokollin e saj, Direktivën Kuadër të Ujit të BE me ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Po ashtu Shqipëria ka marrëveshje me vendet e rajonit me të cilat ndan pellgje ujore, që nga Marrëveshja me Greqinë e vitit 2003 “Për krijimin e Komisionit të Përherëshëm shqiptaro-grek për ujërat e ëmbla ndërkuftare”, Marrëveshja “Për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe basenit të tij ujëmbledhës me Maqedoninë e Veriut”, në vitin 2004, Memorandumin e Mirëkuptimit me Malin e Zi “Për administrimin e ujërave të liqenit të Shkodrës dhe lumit të Bunës”, që në 2010.

Për të garantuar zbatimin e konventave evropiane dhe për të përcaktuar rregullat e normat në funksion të mbrojtjes së cilësisë së ujit, në Shqipëri janë miratuar një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave, si VKM nr.177, datë 31.5.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, VKM nr.1189, datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, VKM nr.797, datë 29.9.2010, “Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”, VKM nr.246, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore” dhe VKM nr.321, datë 28.5.2014, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”.

Përmes transpozimit të legjislacionit evropian është miratuar edhe struktura institucionale për menaxhimin e burimeve ujore dhe administrimin e tyre, duke përfshirë Këshillin e Ministrave, ministrinë përgjegjëse të Mjedisit, Këshillin Kombëtar të Ujit dhe Sekretariatit Teknik të Uji, si dhe tashmë agjencitë në terren kanë detyrimin të mirëmbajnë Regjistrin Kombëtar të Përdoruesve të Burimeve Ujore, sipas ligjit nr.111 të vitit 2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ndërsa Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave i krijuar në 2014, tashmë është shfuqizuar nga VKM nr.568, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

c. Mbrojtja e pyjeve

Mbrojtja e Pyjeve, ndryshe nga sektorët e tjerë të mjedisit, nuk bën pjesë në fushat që janë kompetencë e Bashkimit Evropian, prandaj shtetet anëtare zgjedhin vetë si të menaxhojnë mbrojtjen e tyre. Megjithatë ka pasur përpjekje për përafrimin e politikave pyjore duke koordinuar sektorët e tjerë, si mjedisi, bujqësia, energjia etj. Vitet e fundit djegia e pyjeve ka qenë një problem madhor i stinës së verës, jo vetëm për Shqipërinë apo rajonin, as vetëm për shtetet anëtare të BE-së, por për të gjitha vendet e botës.

Sa i përket krimit mjedisor ndaj pyjeve, në Shqipëri, vetëm dy vitet e fundit, sipas raportit vjetor për Kuvendin mbi kriminalitetin²³, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, **prerja e pyjeve ka qënë vepra më e shpeshtë e kryer kundër mjedisit**, më e ndjekura sa i përket hetimit dhe gjyqimit, si dhe më e dënuara.

Bashkimi Evropian si organizatë dhe të gjitha shtetet e saj anëtare bëjnë pjesë në Konferencën Ministre për Mbrojtjen e Pyjeve në Evropë ku zhvillohen strategji të përbashkëta lidhur me pyjet në kontinent. Në 2011 kjo Konferencë vendosi nënshkrimin e mandatit të zhvillimit të bisedimeve për të hartuar marrëveshjen me fuqi detyruese për pyjet në Evropë. BE, po ashtu bën pjesë në Konventën për Biodiversitetin, Konventën Kuadër për Ndryshimet Klimatike dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Shkretëtirëzimin dhe ka mekanizma bashkëpunimi e koordinimi për pyjet, për çështje me ndikim përtej kufijve shtetërorë, si zjarret, sëmundjet në pyje apo tregtimi i produkteve pyjore. Shqipëria është pjesë në të gjitha Konventat e përmendura më sipër Shqipëria bën pjesë, si dhe është gjithashtu pjesë në dy prej mekanizmave të bashkëpunimit me BE-në, përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Konferencës Ministre. Në 18 nëntor 2022, Shqipëria u bë gjithashtu anëtare e plotë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së.²⁴

d. Biodiversiteti

Konventa e Gjenevës “Për peshkimin dhe ruajtjen e gjallesave në det të hapur” rregulloi për herë të parë mbrojtjen e biodiversitetit nga rreziku i zhdukjes apo shkatërrimit. Konventa e CITES është traktati me rregullimin më të plotë mbi tregtinë ndërkombëtare të kafshëve e bimëve të egra, dhe me të gjitha amendimet e saj, sot mbikëqyr eksportin, importin dhe riekportin e kontrolluar të florës dhe faunës.

Konventa e Biodiversitetit, përfshin të gjitha aspektet: speciet, ekosistemet dhe burimeve gjenetike dhe në 2010, ajo u plotësua me Protokollin e 2010 të Nagojas, “Për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të ndershme të përfitimeve prej përdorimit të tyre”.

Në rrethanat globale të krijuara pas pandemisë Covid -19, u hartua Strategjia e BE-së për Biodiversitetin për 2030-n²⁵ e cila ka përfshirë si një nga kushtet kryesore ngritjen e sistemi të qëndrueshëm për t’iu përgjigjur kërcënimeve që i vijnë shoqërive nga ndryshimet klimatike, zjarrëvëniet në pyje, pasiguria ushqimore dhe shpërthimet e sëmundjeve, e sidomos duke përfshirë mbrojtjen e biodiversitetit dhe luftën ndaj tregtisë së paligjshme të kafshëve dhe shpendëve. Ngritja e një rrjeti më të gjerë mes shteteve anëtare për të ruajtur zonat e mbrojtura në tokë dhe në det, duke shtërnguar masat disiplinore ndaj shkeljeve që dëmtojnë zonat me vlerë të lartë të biodiversitetit dhe të klimës, zbatimi i një plani konkret për restaurimin e ekosistemeve të degraduara dhe marrja e masave për forcimin e qeverisjes në luftën ndaj krimit mjedisor janë disa nga veprimet që synohen të ndërmerren në bazë të kësaj strategjie. Strategjia e 2030 në vetvete synon që të financohet më tej mbrojtja e biodiversitetit dhe të vihet në lëvizje një kuadër më i fuqishëm i përgjigjes ndaj krimit mjedisor duke mundësuar zbatimin më efikas dhe ndjekjen e progresit në këtë fushë, duke rritur kapacitetet për informim më të gjerë publik dhe sidomos duke detyruar respektimin e natyrës në vendimmarrjen publike dhe në investimet e biznesit privat.

Shqipëria, ndërkohë, në mbrojtje të biodiversitetit përveçse ka aderuar në Konventën e CITES , ka ratifikuar gjithashtu edhe Konventën “Për biodiversitetin” dhe Protokollin e Kartagenës “Për biosigurinë”, Konventën e Bernës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës” dhe Konventën e Ramsarit “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”.

²³ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm, mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, viti 2021, fq.143. Per me shume shihni: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/

²⁴ Albania joins the EU Civil Protection Mechanism (europa.eu) [Albania joins the EU Civil Protection Mechanism \(europa.eu\)](https://environment.ec.europa.eu/strategy/biodiversity-strategy030_en#:~:text=The%20EU's%20biodiversity%20strategy%20for,contains%20specific%20actions%20and%20commitments)

²⁵ https://environment.ec.europa.eu/strategy/biodiversity-strategy030_en#:~:text=The%20EU's%20biodiversity%20strategy%20for,contains%20specific%20actions%20and%20commitments

Në vitin 2012, Rezoluta e Parlamentit Evropian për “Strategjinë e BE ‘Për biodiversitetin drejt 2020’”, tregoi se direktiva e vitit 2010 nuk kishte arritur të realizonte me sukses synimet e saj, ndërsa Programi i 7-të i Veprimit të BE për Mjedisin, me afat deri në vitin 2020, i miratuar në 2013, synonte që vendet e Bashkimit Evropian të reduktojnë me të paktën 20%, çlirimin e gazeve në atmosferë brenda vitit 2020, të garantojnë që 20% e energjisë së konsumuar prodhohet prej burimeve të rinovueshme, të reduktojnë me 20% konsumi e energjisë dhe të ndalojë humbjen dhe degradimin e biodiversitetit deri në 2020.

Për të përmbushur detyrimet që lindin nga këto konventa, janë miratuar një sërë ligjesh si më poshtë: ligji nr.57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, ligji nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, ligji nr.10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, ligji nr.10120, datë 23.04.2009, “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, ligji nr.10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”.

Po ashtu, për t’u përfruar me direktivat e BE-së në mbrojtje të biodiversitetit dhe të trashëgimisë natyrore u miratuan ligji nr. 81, datë 04.04.2017 “Për zonat e mbrojtura” dhe ligj nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar. .

Në zbatim të tyre, u miratuan VKM nr. 532, datë 5.10.2000 “Për Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për mbrojtjen e biodiversitetit” dhe VKM nr.897, datë 21.12.2011, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes”, VKM nr.303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumenteve të natyrës shqiptare”, VKM nr.266, datë 24.4.2003, “Për administratat e zonave të mbrojtura”, VKM nr.267, datë 24.4.2003, “Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike”, VKM nr.804, datë 4.12.2003, “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje”, VKM nr. 593, datë 09.10.2018 “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”, VKM nr.84, datë 27.1.2009, “Për përcaktimin e kriterëve për ngritjen e rrejtit të inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit”, VKM nr.477, datë 30.07.2021 “Për miratimin e listës së llojeve të huaja invazive dhe përcaktimin e procedurave për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit”.

e. Mbrojtja nga mbetjet

Konventa e Bazelit “Për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe gruposjen e tyre” vendos theksin tek përgjegjësia e shteteve për të menaxhuar mbetjet në mënyrë të përshtatshme për mjedisin, ndërsa në qershor të vitit 2022 kjo konventë u amendua dhe tashmë ndalon plotësisht lëvizjen ndërkombëtare të mbetjeve.

Më tej në Konventën e Roterdamit “Për procedurën e dhënies së Pëlqimit Paraprak mbi bazë informacioni për kimikatet dhe pesticidet në tregtinë ndërkombëtare” në 1998 u përcaktua për herë të parë në një traktat shumëpalësh për substancat e rrezikshme, **dhënie e pëlqimit paraprak bazuar në informacionin e marrë**, si mjet parësor në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit.

Konventa e Stokholmit “Për ndotësit organikë të qëndrueshëm”, rregullon pesticidet dhe përbërësit e padekompozueshëm, të cilët mund të dëmtojnë zinxhirin ushqimor, mjedisin apo shëndetin e njeriut, ndërsa Konventa e Përbashkët “Për sigurinë e menaxhimit të karburantit të konsumuar dhe sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive” ishte i pari traktat që detyronte ligjërisht trajtimin e mbetjeve radioaktive në nivel global, për të garantuar mbrojtjen ndaj efekteve të menaxhimit të karburantit apo mbetjeve radioactive si dhe parandalimi i aksidenteve në këto veprimtari.

Direktiva e Këshillit Nr.84/631 EEC, e vitit 1984, “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin brenda Komunitetit Evropian të ngarkesave të mbetjeve brenda dhe jashtë Komunitetit Evropian”, rregulloi lëvizjen e mbetjeve

jashtë kufijve, e sidomos eksportin e paligjshëm të tyre. Në vitin 2008 Direktiva 2008/98/EC, “Për mbetjet”, ose Direktiva Kuadër për Mbetjet, e cila shfuqizoi të gjitha direktivat e mëparshme për tregtinë e mbetjeve. Ndër vite Komisioni Evropian ka miratuar vendime dhe rregullore për të përcaktuar Listën e mbetjeve, për të rregulluar menaxhimin e lëndësive të mbetjeve, llumrat e kanalizimeve, vajrat, bateritë dhe akumulatorët, paketimin, mbetjet nga pajisjet elektrike, djegien e mbetjeve apo administrimin e mbetjeve të industrisë nxjerrëse.

Krahas rregullimeve ndërkombëtare përmes akteve të OKB-së dhe BE-së, edhe Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin ka trajtuar importet dhe exportet e mbetjeve duke krijuar që në vitin 1984 një sistem kontrolli mbi tregtinë e mbetjeve.

Shqipëria sa i përket menaxhimit të mbetjeve ka miratuar me qëllim përafrimi me legjislacionin e BE-së, VKM-në nr.418, datë 27/05/2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”.

Në zbatim të detyrimeve që lindin nga aderimi në Konventën e Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, u miratua ligji nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me të cilin, kufizohet më tej importi i mbetjeve të rrezikshme ndërsa me ligjin nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” u ndalua plotësisht importimi dhe tranzitimi i mbetjeve të rrezikshme ose jo në Shqipëri.

Për mbetjet e ngurta, është miratuar ligji nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili synon përafrimin e Direktivës Kuadër për Mbetjet të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Më tej për zbatimin e një qasjeje të integruar, u krijua Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, me VKM nr.967, datë 25.10.2013, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, i cili bashkërendon detyrat e ministrive për menaxhimin e integruar mjedisor të mbetjeve.

Sa i përket menaxhimit të mbetjeve në landfillet, u miratua VKM nr.452, datë 11.7.2012, “Për landfillet e mbetjeve” e cila është mbështetur në Direktivën e Këshillit 1999/31/EC, datë 26.4.1999, “Për lëndfillin e mbetjeve”.

f. Zbatimi i legjislacionit të BE-së në shtetet anëtare dhe në vendet joanëtare të bllokut

Bashkimi Evropian është pjesë në shumë marrëveshje mjedisore rajonale dhe globale për një tërësi çështjesh që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, që nga lëvizja e mbetjeve të rrezikshme përtej kufijve të shteteve, tek asgjësimi i tyre, te ruajtja e biodiversitetit, mbrojtja nga zjarret në pyje, mbrojtja e lëvizjes së florës dhe faunës, etj. Megjithatë, ashtu si zbatimi i direktivave të vetë BE-së lidhur me mjedisin, edhe konventat ndërkombëtare ku shtetet anëtare të BE-së bëjnë pjesë si shtete të veçanta apo si pjesë e bllokut, mbetet i paplotë. Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës miratuan në vitin 2001 standardet minimale për inspektimet mjedisore, të cilat janë jodetyruese dhe synojnë të adresojnë pabarazinë mes shteteve në nivelin e zbatimit të legjislacionit ndërkombëtar kundër krimit mjedisor. Shtetet anëtare të BE-së, ashtu si shumë shtete të tjera në rajon, e më gjerë, përfshirë edhe Shqipërinë, parashikojnë në legjislacionet e tyre penale veprime kundër mjedisit që sanksionohen si vepra penale, të cilat përkthehen në dënime që duhet të jenë proporcionale, efektive dhe funksionale për veprat më të rënda kundër mjedisit apo për vepra me pasoja të rënda kundrejt mjedisit ose shëndetit të njerëzve.

Sa i përket vendeve që nuk janë ende anëtare të BE-së, por kanë statusin kandidat, ato kanë detyrimin **të harmonizojnë në legjislacionin kombëtar konventat dhe direktivat mjedisore të BE-së**, në mënyrë që të barazojnë nivelin e përpjekjeve që bëhen nga shtetet anëtare në drejtimin e ruajtjes së një cilësie të caktuar të ajrit dhe ujit, në menaxhimin, lëvizjen dhe asgjësimin e mbetjeve, në mbrojtjen e zonave të

mbrojtura, pyjeve dhe biodiversitetit, si dhe në menaxhimin e riskut të ndotjes industriale, kimikateve, toksinave, pesticideve dhe organizmave të modifikuar gjenetikut.

Përtej transpozimit të legjislacionit të BE-së në ligjet vendase, shtetet candidate, ashtu si edhe vetë shtetet anëtare të BE-së duhet të krijojnë një strategji dhe një plan veprimi kombëtar në mbrojtje të mjedisit si dhe të ngrenë një infrastrukturë për zbatimin e këtyre ligjeve përmes një administrate të forte e të mirë pajisur, që të jetë në gjendje jo vetëm të luftojë krimin mjedisor brenda shtetit, por edhe të bashkëpunojë në nivel të lartë me institucionet simotra në vendet e tjera të rajonit dhe të Evropës e më gjerë.

Për të plotësuar kërkesat e BE-së në rrugën e anëtarësimit, tashmë jo vetëm si një vend kandidat, por edhe si një vend që ka konsoliduar bashkëpunimin me bllokun për t'u integruar sa më shpejt, Shqipëria ka synuar të harmonizojë gjithmonë e më shumë legjislacionin e BE-së në kuadrin kombëtar ligjor kundër krimit mjedisor.

3.2.1 Legjislacioni kombëtar për krimet mjedisore

Në kuptimin e zakonshëm, krimi mjedisor nënkupton të gjitha veprimet që i shkaktojnë dëm mjedisit. Mirëpo në kuptimin ligjor ky përcaktim në mënyrë të përmbledhur mund të kuptohet si *“tërësia e dispozitave që vendosin përgjegjësinë penale (apo administrative/civile kur nuk kemi të bëjmë me veprë penale) për sjelljet e caktuara për shkak të dëmit qoftë ky i mundshëm apo efektiv ndaj mjedisit”*.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 56 të saj se kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Më tej në kapitullin e objektivave sociale në nenin 59 paragrafi 1 pika d) dhe dh) kushtetuta përmban një rregullim më specifik të mjedisit duke parashikuar që “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”.

Detyrimet e mësipërme kushtetuese detajohen edhe në akte të rëndësishme ligjore ku përfshihet dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Legjislacioni ynë penal garanton mbrojtje juridiko-penale ndaj mjedisit duke marrë përsipër të mbrojtje në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet juridike të vendosura në Kushtetutë apo në ligje të tjera që lidhen me mjedisin. Normat penale sigurojnë mbrojtje të mjedisit nga të gjitha veprimet apo mosveprimet shoqërisht të rrezikshme si të tilla të kundra ligjshme të kryera me faj dhe që shoqërohen me ardhjen e pasojave të rrezikshme. Në kuadër të mbrojtjes juridiko-penale parashikohen dënime konkrete penale të cilat zbatohen nga gjykata ndaj autorëve të këtyre veprave penale.

Jo vetëm individët por edhe personat juridikë përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. **Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë** së tyre nga funksionarët e tyre. Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale. Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligjin nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë janë parashikuar figura konkrete të veprave penale kundër mjedisit si edhe dënimet përkatëse për autorët e këtyre veprave penale. Veprat penale kundër mjedisit së bashku me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi në datën 08.10.2019 janë parashikuar në Kreun IV të Kodit Penal aktual, si më poshtë:

- **Neni 201- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës**

Vepra e ndotjes së ajrit, e ujërave dhe e tokës mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga personi fizik/juridik, që është i detyruar të marrë masa të caktuara për mbrojtjen nga ndotja, të ajrit, tokës dhe ujit.

Në këto raste, kryerja e veprimeve apo mosveprime të kundraligjshme, qëndron në ndotjen në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimin e rëndë të kafshëve ose bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, **tej kufirit të normave të lejuara me ligj**, ose zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka **shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës**.

Rastet kur ndotja përbën kundërvajtje administrative janë të caktuar në ligjin²⁶ për mbrojtjen e mjedisit, si dhe ligjet e tjera të veçanta që lidhen me të dhe kanë objekt mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja. Dënimi për kundërvajtjet penale është parashikuar me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. **Përbëjnë kundërvajtje penale vetëm rastet kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative.**

Vepra konsiderohet e kryer **në rrethana cilësuese** kur nga ndotja e ajrit, e kryer nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të sipërpërmendura në kundërshtim me ligjin, kanë ardhur **pasoja të rënda** për jetën e shëndetin e njerëzve, konkretisht, vdekja apo gjymtimi, shëmtimi, ndërprerja e shtatzënisë, ose rrezikimi për jetën në çastin e shkaktimit të tij. Dënimi, në këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- **Neni 201/a - Menaxhimi i mbetjeve**

Vepra menaxhimi i mbetjeve mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia dhe konsiston në grumbullimin, transportimin, rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e vend depozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, **dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.**

Në këtë mënyrë ligjvënësi ka bërë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me mosrespektimin e legjislacionit në fuqi që përbëhet nga ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve²⁷ dhe aktet e tij plotësuese. Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Kur kjo vepër konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese, dënimi, për këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- **Neni 201/b - Transportimi i mbetjeve**

Vepra transportimi i mbetjeve, që parashikon transportimin e mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet. Kjo vepër penale kryhet me dashje ose nga pakujdesia nga persona apo subjekte juridik që kanë shkelur rregulla të vendosura për transportimin pa leje të lëndëve/mbeturinave të ndryshme. Në këto raste, veprimet aktive të kundërligjshme, qëndrojnë në transportimin (me mjete të transportit rrugor, hekurudhor, ajror ose edhe ujqor) transit (për në një shtet të huaj) të mbeturinave.

Vëmendja edhe në këtë rast duhet drejtuar tek fakti që kjo vepër penale mund të shkaktohet pikërisht duke shkelur elementë të caktuar të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve apo ligjet të tjera sektoriale,

²⁶ Neni 69 i ligjit nr.10 431 datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar

²⁷ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar

duke kriminalizuar kështu veprime të caktuara që gjithsesi vlerësohen rast pas rasti nga organet ligj zbatuese.

- **Neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme**

Vepra aktivitetet e rrezikshme konsiston në funksionimin e një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjisllacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. Edhe këtu lidhja shkakësore bëhet me ligjin sektorial, por në ndryshim nga nenet e tjera, pasoja që vjen nga shkelja është shumë e qartë dhe ka të bëjë me shkaktimin e dëmeve të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë. Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese , dënimi, për këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- **Neni 201/ç - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme**

Në veprën materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme, prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjisllacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kjo vepër kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

- **Neni 202- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër**

Vepra penale e dëmtimit të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër, kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridikë që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit, për zonat e mbrojtura dhe ligjin për peshkimin. Veprimet e kundraligjshme konsistojnë në vrasjen, shkatërrimi, zotërimin, marrjen e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve. Kundravajtësi në këto raste dënohet me gjobë ose me burgim.

Këto veprime konsiderohet se i kanë sjellë pasojat e tyre kur **shkaktojnë prishjen e ekuilibrit ekologjik** , që do të thotë se pasojat ndjehen në faunën dhe florën, duke dëmtuar apo zhdukur specie peshqish, bimësi, kafshë etj.

- **Neni 202/a - Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër**

Vepra tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër parashikon tregtimin e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe

autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve. Kjo vepër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

- **Neni 202/b - Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore**

Vepra e dëmtimit të habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore përbëhet nga veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kjo vepër mund të kryhet, me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit, të ujërave të deteve, lumenjve, tokës nga ndotja me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera. Në këtë rast, veprimet e kundraligjshme qëndrojnë në hedhjen/shkarkimin, nga anijet që lundrojnë apo të ankoruara në porte; avionë; mjete të tjera transporti, rrugor apo hekurudhor; uzina, fabrika, ente të ndryshme, individë, etj., të mbeturinave apo lëndëve toksike, radioaktive apo substanca të tjera.

- **Neni 203-Substancat ozonholluese**

Vepra tjetër që konsiston në prodhimin, importimin, eksportimin, nxjerrjen në treg ose përdorimin e substancave ozonholluese, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

- **Neni 204- Peshkimi i ndaluar**

Vepra penale e peshkimit të ndaluar²⁸, kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin për peshkimin nr. 64/2012, i ndryshuar. Veprimet e kundra ligjshme, qëndrojnë në peshkimin në kohë të ndaluar, kohën e shtimit; peshkimin me mjete të ndaluara, peshkimin në vende të ndaluara, si zonat e mbrojtura etj. Peshkimi i kryer në kohë, me mjete, në vende dhe mënyra të ndaluara nga ligji për peshkimin, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj. Në rastet kur peshkimi kryhet me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj., kjo vepër, konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese²⁹, dhe kundërvajtjesi penal dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

- **Neni 205- Prerja e paligjshme e pyjeve**

Vepra e prerjes së paligjshme e pyjeve kryhet me dashje nga persona apo subjekte juridik që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin e zbatueshëm për pyjet, si dhe ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. Veprimet e kundërligjshme aktive konsistojnë në prerjen apo dëmtimin e pyjeve pa lejen e organeve kompetente, prerjen apo dëmtimin e pyjeve në kohë të ndaluar, (në kohën e rigjenerimit, moratorium,) dhe prerjen apo dëmtimin e pyjeve në vende të ndaluara, (në zonat e mbrojtura, vende që rrezikohet erozioni, përmytja, rrëshqitja e tokës, etj.);

Rastet se kur prerjet apo dëmtimi i pyjeve përbëjnë kundërvajtje administrative janë të caktuar ligj për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin për pyjet, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim tyre. Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, **dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.**

- **Neni 206- Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë**

Vepra e prerjes së drurëve dekorativë dhe frutorë kryhet me dashje, nga persona apo subjekte juridik, duke prere drurët dekorative (pisha, bredha, plepa, etj) që janë mbjelle anës rrugëve ne qytete e ne vende te

²⁸ Neni 204 i Kodit Penal.

²⁹ Neni 204 paragrafi i dytë i Kodit Penal

tjera; dëmtuar lulishte dhe parqe nëpër qytete, (shkullur lule, future bagëti në këto lulishte e parqe, etj); prere drurët në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente. Dënimi për kundërvajtjen penale, të prerjes së drurëve dekorativ dhe dëmtimin e parqeve dhe lulishteve është me gjobe, ndërsa për prerjen e pemtoreve, ullishtave e vreshtave është me burgim deri në tre muaj.

- **Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve**

Vepra e shkatërrimit me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, kryhet, me dashje, me veprime aktive duke përdorur mjete të rrezikut të përbashkët me zjarr që shkaktojnë:

- shkatërrimin apo dëmtimin, me pasoja të rënda materiale, të fondit pyjor, të fidanishtes pyjore, të grumbullit pyjor ose të çdo njësie të ngjashme me to. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga pesë deri në tetë vjet.
- ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kjo vepër, konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuar kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve si dhe kur ka shkaktuar dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura. Dënimi për këto raste është me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

- **Neni 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor**

Vepra e shkatërrimit me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, kryhet me pakujdesi, duke përdorur mjete të rrezikut të përbashkët me zjarr që shkaktojnë shkatërrimin apo dëmtimin, me pasoja të rënda materiale të fondit pyjor, fidanishtes pyjore, grumbullit pyjor ose të çdo njësie të ngjashme me to. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kjo vepër, konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuar kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, për shëndetin ose jetën e njerëzve si dhe kur ka shkaktuar dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura. Dënimi për këto raste është me burgim nga tre deri në tetë vjet.

- **Neni 207- Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve**

Vepra e shkeljes së karantinës së bimëve dhe kafshëve kryhet, nga subjekte të posaçme, duke vepruar apo mos vepruar në kundërshtim me rregullat e caktuara për karantinën e bimëve dhe shërbimin veterinar. Këto rregulla janë të caktuara me ligjin mbi shërbimin veterinar nr. 10465 datë 29.09.2011, i ndryshuar dhe ligjin për mbrojtjen e bimëve nr.105/2016. Për të pasur përgjegjësi penale duhet, që nga shkelja e rregullave të karantinës të kenë ardhur pasoja të rënda, në kuptimin që dëmtimi i bimëve nga sëmundjet e rrezikshme, ose ngordhja e kafshëve nga sëmundje ngjitëse të jetë në masë të lartë, ose të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Kjo vepër penale klasifikohet si kundërvajtje penale dhe është e dënueshme me gjobë.

Nr.	Vepra penale kundër mjedisit	Masa ndëshkimore në varësi të rrezikshmërisë
1.	Neni 201- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës	Burg deri në 15 vite
2.	Neni 201/a - Menaxhimi i mbetjeve	Burg deri në 15 vite
3.	Neni 201/b - Transportimi i mbetjeve	Gjobë deri në burgim 5 vite
4.	Neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme	Burg deri në 15 vite
5.	Neni 201/ç - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme	Burg deri në 20 vite
6.	Neni 202- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Gjobë deri burgim 7 vite
7.	Neni 202/a - Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Gjobë deri burgim 3 vite
8.	Neni 202/b - Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore	Gjobë deri burgim 5 vite
9.	Neni 203-Substancat ozonholluese	Burg nga 1 deri në 7 vite
10.	Neni 204- Peshkimi i ndaluar	Gjobë ose burgim deri në 2 vite
11.	Neni 205- Prerja e paligjshme e pyjeve	Gjobë ose burgim deri në 1 vit
12.	Neni 206- Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë	Burg deri në 3 muaj
13.	Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	Burg deri në 20 vite
14.	Neni 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Burg deri në 8 vite
15.	Neni 207- Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve.	Gjobë

Tabela 1. Përmbledhje e dënimeve për veprat penale kundër mjedisit

Megjithatë, jo vetëm veprat penale janë tregues apo orientues i identifikimit të krimit mjedisor. Në çdo ligj të posaçëm listohen një sërë shkeljesh mjedisore që mund të shërbejnë si orientim dhe referencë për identifikimin e krimeve mjedisore, duke lexuar ato dispozita në harmoni apo paralelisht me veprat penale të shpjeguara më sipër. Për shembull, përsa i takon mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake, referencë duhet bërë edhe tek ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” por edhe në Kodin Penal.

NjQV-të kanë kompetenca të caktuara në këtë ligj për mbetjet. Këto kompetenca, mund t’i japin mundësinë cilitdo punonjës të bashkive të marrin dijeni apo vendosen përballë krimeve mjedisore të përcaktuara në nenin 201/a - Menaxhimi i mbetjeve, nenin 201/b - Transportimi i mbetjeve, neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme dhe neni 201/ç - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme, etj., të Kodit Penal.

Po në të njëjtën mënyrë, nëse gjatë një procedure kontrolli ose thjesht pas një konstatimi, nëpunësi i një autoriteti shtetëror qendror ose lokal konstaton se legjislacioni është shkelur, ose nuk është zbatuar në mënyrën e duhur, ky i fundit duhet të raportojë menjëherë nëse Inspektoratet që mbulojnë fushën e mbetjeve (sipas llojit të ndotjes nga mbeturinat mund të jenë: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit; Drejtoria e Shërbimit Veterinar; Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit etj). Megjithatë, nëse konstatohet një vepër penale, nëpunësi duhet të ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar provat e veprës penale, objektet mbi të cilat është kryer vepra penale, prova të tjera dhe të informojë prokurorin ose Policinë e Shtetit mbi çështjen. Kontrollori vlerëson në mënyrë të pavarur se cilat prova do të përdoren për të vërtetuar faktet

kryesore por nuk i prek ato, thjesht ja tregon organeve ligj zbatuese pasi ka lexuar se cila mund të jetë vepra penale e konstatuar.

3.3 Politikat dhe strategjitë kombëtare për adresimin e çështjeve që lidhen me krimin mjedisor

Krimi mjedisor është një koncept relativisht i ri për kontekstin shqiptar edhe pse mbi mjedisin kanë qenë të pranishëm në forma dhe shtrirje të ndryshme përpara se ky nocion të njëjti dhe adresohet në kuadrin ligjor dhe institucional. Duke qenë ngushtësisht i lidhur me mjedisin si komponenti kryesor, por edhe duke ndërvepruar me shoqërinë dhe ekonominë nga ana tjetër, krimi mjedisor paraqitet mjaft dinamik sa i përket adresimit të tij përmes kuadrit rregullator dhe atij institucional. E parë në këndvështrimin e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së, kuadri rregullator që adreson shkeljet dhe veprat kundër mjedisit, ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Në këtë këndvështrim, sa i përket kuadrit të politikave kombëtare për adresimin e çështjeve që lidhen me krimin mjedisor është paraqitur në mënyrë skematike në figurën 2 më poshtë.




Figura 1. Kuadri strategjik, ligjor për krimin mjedisor në Shqipëri

Referuar skemës më sipër vërehet se nuk ka një dokument politikash të dedikuar për të adresuar aspektet e krimit mjedisor, por këto politika janë të shpërndara në sektorë të ndryshëm ku sektori i mjedisit përfshin pjesën më të madhe të tyre. Me ndryshimin struktural të politikave qeverisëse mjedisore, strategjia ndërsektoriale e mjedisit është rikonfiguruar dhe elementët e kësaj politike janë të shpërndara në sektorë specifikë si ruajtja e natyrës, menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i pyjeve etj. Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, dokumenti horizontal ndërsektorial i cili orienton politikat

mjedisore dhe rrjedhimisht edhe ato që lidhen me aspekte të krimit mjedisor është Plani Kombëtar i Integritimit Evropian 2022-2024.

Në kapitullin 27 të këtij dokumenti paraqitet kuadri i politikave të ndërmarra dhe ato që planifikohen të ndërmerren nga shteti shqiptar në funksion të adresimit të problematikave që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Këtu përmendet se përforsimi i kuadrit ligjor sa i përket krimit mjedisor konsiston në ndryshimet sidomos në Kodin Penal si edhe miratimin e akteve të tjera ligjore e nënligjore për fusha specifike si ajri, ujërat e brendshme, mbetjet, zhurmat dhe kimikatet, biodiversiteti, pyjet, ndryshimet klimatike³⁰. Megjithatë edhe në këtë dokument sfida kryesore e evidentuar është zbatimi i kuadrit ligjor në mënyrë efektive, i cili kushtëzohet nga kapacitetet njerëzore e financiare në shumicën e hallkave ligjzbatuese.

Transpozimi i pjesshëm i disa direktivave që lidhen me krimin mjedisor si Direktiva për Krimin Mjedisor (përafshuar 65%), Direktiva për Përgjegjësinë Mjedisore (përafshuar 28%) dhe Rregullorja për Kriteret Minimale të Inspektimit (përafshuar 62%) kanë shënuar një progres relativisht të mirë sa i përket adaptimit të politikave në këtë fushë. Kjo evidentohet edhe në raportin paraprak të hartuar nga grupi i përbashkët ndërsektorial i punës i mbështetur nga programi “Mbështetja e negociatave shqiptare në fushën e mjedisit - Kapitulli 27” SANE 27³¹. Edhe në raportin e progresit të hartuar nga DG-NEAR theksohet se zbatimi i parimit “ndotësi paguan” në zbatimin e legjislacionit mbetet një sfidë. Në këtë kontekst, nevojiten përpjekje për të arritur harmonizimin e plotë me direktivën për përgjegjësinë mjedisore.

Hartimi i një strategjie kombëtare dedikuar sektorit të mjedisit mund të përcaktoj linja me të qarta të përgjegjësisë midis institucioneve dhe të rrisë koordinimin ndërmjet agjencive të ndryshme në zbatim të ligjit. Në mungesë të një strategjie kombëtare gjithëpërfshirëse, kuadri ligjor ekzistues nuk është i rregulluar siç duhet, duke e bërë sfidues bashkëpunimin ndër-institucional në luftën kundër krimeve mjedisore.

Përveç politikave të pasqyruar më sipër, në rrafshin horizontal, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë politikash sektoriale specifike në fushën e mjedisit si:

- Strategjia kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit (2014),
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (2015),
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (2020-2035),
- Dokumenti i Politikave për Pyjet (2019-2030),
- Strategjia e Ndryshimeve Klimatike (2019),
- Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (2017-2027) etj.

Një tjetër strategji ndërsektoriale është edhe Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) e cila përcakton vizionin, objektivat strategjike dhe specifike të edukimit ligjor të publikut (ELP) përgjatë periudhës 2019-2023. SELP është dokumenti i parë strategjik i miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve. Ky dokument është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës hartimi dhe konsultimi. Njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve luajnë një rol thelbësor në çdo shoqëri demokratike, ku sjellja, veprimet dhe marrëdhëniet mes tyre disjelojnë nga norma e rregulla ligjore. Këto norma e rregulla janë ndonjëherë komplekse apo u nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme.

³⁰ <https://integrimi-ne-be.punetejashtrme.gov.al/anetaresimi-ne-be/plani-kombetar-i-integritimit-pkie/>

³¹ <https://sane27.com/sq/about-us/>



4 Vlerësimi i kuadrit institucional



4. Vlerësimi i kuadrit institucional

Në Shqipëri ekzistojnë disa institucione dhe agjenci të ndryshme përgjegjëse për aspekte të ndryshme që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Ndjekja dhe ndëshkimi i veprave kundër mjedisit, ndahet në ndjekjen penale dhe dënimin e tyre nga gjykata, nëse këto shkelje konsiderohen kundërvajtje penale (*ose krime sipas neneve përkatëse në Kreun IV të Kodit Penal*), dhe shkelje administrative të cilat ndiqen dhe dënohen nga institucionet apo agjencitë përgjegjëse shtetërore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Në nivelin ministror, përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit ndaj krimeve mjedisore apo **ndaj shkeljeve të legjislacionit** përkatës kryhet nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në një shkallë më të ulët, ndërsa Këshilli i Ministrave mban përgjegjësi për hartimin e legjislacionit apo akteve nënligjore të përshtatshme. Në nivelin e agjencive: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, dhe Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit dhe Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura ndajnë peshën më të madhe të përgjegjësisë për identifikimin, monitorimin, raportimin dhe ndjekjen administrative të shkeljeve të legjislacionit në mbrojtje të mjedisit.

Sa i përket **procedimit penal dhe gjykimit të veprave penale kundër mjedisit**, policia gjyqësore pranë Policisë së Shtetit, Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, Gjykatat e Rrethit, në dhomën penale, si dhe ato të Apelit mbajnë peshën e hetimit, procedimit dhe dënimit të shkeljeve në dëm të mjedisit që konsiderohen si kundërvajtje apo si krime.

Në bazë të intervistave, por edhe sipas raporteve të Prokurorisë së Përgjithshme, Progres-Raportit të BE-së dhe dokumenteve të tjera të shqyrtuara në funksion të këtij raporti, ndarja midis ndjekjes penale dhe administrative bëhet ndonjëherë e vështirë dhe shfaqet nevoja për bashkëpunim me të koordinuar midis administratës shtetërore dhe policisë gjyqësore pranë Policisë së Shtetit që kanë rol parësor në hallkën e parë të zinxhirit të procedimit të veprave penale kundër mjedisit që në fund sjellin ndëshkimin e tyre nga Gjykata (Administrative apo Penale, sipas llojit të shkeljes), duke dekurajuar pjesën tjetër të qytetarëve të veprojnë në mënyrë të papërgjegjshme ndaj mjedisit.

4.1 Institucionet qeveritare me rol inspektues

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjëse për miratimin e strategjive dhe politikave kombëtare mjedisore dhe lehtëson përafrimin me acquis mjedisore të BE-së. Po ashtu, ai është autoriteti menaxhues për Konventat Ndërkombëtare ku aderon edhe Shqipëria, që nga CITES, te Konventa e Aarhusit, Bonit, Bazelit etj. Po ashtu, Ministria përmes Drejtorisë për Biodiversitetin dhe Zonat e Mbrojtura është përgjegjëse për lëshimin e lejeve dhe certifikatave të Konventës së CITE-s.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u krijua në vitin 2014 me VKM nr.150 dhe është përgjegjëse për vlerësimin e kushteve për dhënien e lejeve mjedisore dhe për hartimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe për monitorimin e gjendjes së mjedisit. Nga viti 2020, AKM ka nën varësi edhe strukturën inspektuese të mjedisit. *Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në AKM* ka marrë përsipër disa nga përgjegjësitë e ish-Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Ujërave, Pyjeve dhe Turizmit. Gjithashtu, degët rajonale të AKM-së kanë në strukturën e tyre një drejtori të kontrollit dhe inspektimit mjedisor. Pra, AKM organizohet si organ qendror në nivel kombëtar me 4 agjenci rajonale të mbrojtjes së mjedisit dhe një staf prej 304

personash. AKM po ashtu monitoron dhe analizon e raporton të dhënat, si dhe është përgjegjëse për transferimin e mbetjeve, përfshirë mbetjet e rrezikshme. Për rolin e saj monitorues AKM raporton jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe tek disa organizata ndërkombëtare.³²

Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) është institucion në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përgjegjëse për verifikimin, licencimin (leje mjedisore), monitorimin dhe inspektimin e gjithë aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis. Aktualisht, në territorin e vendit operojnë 4 ARM. Përgjithësisht, ARM-të janë të organizuara në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Sektorin e shqyrtimit të VNM-ve dhe lëshimit të lejeve mjedisore, Sektorin e monitorimit dhe Sektorin e Komunikimit dhe Informacionit. Veç sa më sipër, në çdo qendër qarku ka një zyrë informacioni. *ARM-të ndjekin shkeljet administrative dhe njoftojnë policinë dhe IKMT për shqyrtimin dhe ndjekjen e shkeljeve që përbëjnë vepër penale.* Inspektimet bëhen sipas planeve vjetore e mujore duke përdorur një model standard për raportin e inspektimit në terren i cili plotësohet online. Rastet e shkeljeve të referuara për ndjekje të mëtejshme në institucionet e tjera (polici, IKMT, prokurori) *nuk ndiqen drejtpërsëdrejti nga inspektorët e ARM, të cilët nuk informohen për ecurinë e procesit të hetimit dhe gjyqimit dhe rezultatet e tij (masat e dënimit për shkelësit).*

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), e themeluar në vitin 2015, është një ent publik i krijuar si institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përgjegjës për sistemin e zonave të mbrojtura të vendit. AKZM është e organizuar në Drejtorinë e Monitorimit dhe Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve dhe Zyrën e Projekteve. *Spektori i Monitorimit, në Drejtorinë e Monitorimit dhe Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura* është përgjegjës për ndjekjen e shkeljeve dhe aktiviteteve të paligjshme që zhvillohen brenda territorit të zonave të mbrojtura. AKZM punëson aktualisht (2022) 304 punonjës, nga të cilët 24 janë në zyrat qendrore në Tiranë dhe pjesa tjetër janë të organizuar në 12 Administrata Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura: Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (AdZM) është institucion në varësi të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e gjithë zonave të mbrojtura të përfshira në territorin e Qarkut. AdZM-të janë të organizuara në dy sektorë: sektori i menaxhimit, i cili ndjek zbatimin e aktiviteteve të nevojshme për mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura; dhe sektori i monitorimit, i cili është përgjegjës *për evidentimin e shkeljeve në territorin e zonave të mbrojtura dhe raportimin e tyre pranë organeve ligjzbatuese (IKMT, prokurori).* Pjesë e sektorit të monitorimit janë edhe rejnshersat, të ndarë sipas zonave. AdZM-të nuk kanë specialist finance dhe jurist në strukturën e tyre.

Ligji i Zonave të Mbrojtura (81/2017) përcakton çdo aktivitet të paligjshëm brenda territorit të zonave të mbrojtura si kundravajtje penale. Ligji i Zonave të Mbrojtura i njeh drejtorit të AdZM dhe shefit të sektorit të monitorimit autoritetin e Oficerit të Policisë Gjyqësore (OPGJ), çka parimisht i lejon këta të fundit të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm dhe të përcjellin dosjen hetimore në prokurori, **por aktet nënligjore mbështetëse janë të nevojshme për të qartësuar këtë përcaktim.** Aktualisht, stafi i AdZM bën konstatimin e rasteve dhe denoncimin e tyre në prokurori. Prokuroria shpesh i referohet ligjit të pyjeve për kundravajtjet e paraqitura nga AdZM.

³² AKM është gjithashtu përgjegjëse për hartimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe për monitorimin e gjendjes së mjedisit me publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit, kryerja e shërbimeve të matjes së ndotjes së mjedisit, ngritja dhe menaxhimi i sistemit të informacionit mjedisor; krijimin dhe menaxhimin e Regjistrat të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve; ofrimin e informacionit mjedisor për publikun e përfshirë në procesin e vendimmarrjes mjedisore.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) është krijuar në vitin 2020, në vijim të përpjekjeve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për përmirësimin dhe forcimin e sektorit të menaxhimit të pyjeve,³³ si një Institucion përgjegjës për menaxhimin e pyjeve në tërë kompleksitetin e tyre, përfshirë edhe zbatimin e ligjshmërisë. Në këto dy vite, detyra kryesore e AKP-së ka qenë konsolidimi i strukturave dhe detajimi i kërkesave të ligjit të pyjeve dhe plotësimi i akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Specifikisht, AKP është duke punuar për unifikimin e standardeve për strukturat e kontrollit dhe inspektimit në pyje. Aktualisht, në zbatim të ligjit të pyjeve, strukturat e kontrollit dhe inspektimit në pyje përfshijnë pushtetin vendor (Bashkitë), Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, e cila duhet të koordinojë dhe drejtojë procesin në nivel qendror, ndërkohë që dy strukturat e tjera kanë më shumë përgjegjësi në nivel lokal (terren).

Agjencia Menaxhimit të Burimeve Ujore. Agjencia Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është krijuar në vitin 2018. Misioni i Agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike.³⁴ Në strukturën e AMBU-së është Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila ndër funksionet e saj ka edhe monitorimin dhe kontrollin e burimeve ujore, duke garantuar që ato të shfrytëzohen në përputhje me qëllim e përcaktuar dhe sipas kriterëve/kushteve të përcaktuara në lejet e miratuara duke menaxhuar në mënyrë të plotë ciklin e administrimit të burimeve ujore (Planifikim – Përdorim – Monitorim).³⁵

Inspektorati Kombëtar i Kontrollit të Territorit (IKMT). Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është një institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme, i cili pjesë të detyrave kryesore ka jo vetëm ndalimin dhe procedimin e personave përgjegjës për ndërtimin pa leje, por edhe mbrojtjen e territorit dhe të peisazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e paligjshme duke garantuar mbrojtjen e mjedisit të tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja apo dëmtimet e çfarëdolloji. Referuar VKM nr. 513, datë 1.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave,"Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit" përcakton që Inspektorati Kombëtar i Mbrojtja e Territorit, tashmë ka si objektiv parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e peizazhit, tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja, dëmtimi apo ndërhyrjet e paligjshme të çdo lloji. Në zbatim të urdhrit nr. 22, datë 3.2.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit", në të cilin drejtoritë në qendër dhe në qarqe u ristrukturuan duke krijuar drejtori të reja në fushën e mjedisit dhe pyjet. Në këtë kuadër, Ministria e Brendshme nëpërmjet strukturave në varësi të saj, IKMT dhe Policisë së Shtetit, në vijim të veprimeve për mbrojtjen e mjedisit nga krimi mjedisor, ndërmerr masa administrative nga IKMT dhe nisjen e procedimit penal nga Policia e Shtetit për shkelësit dhe ndotësit e mjedisit. Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka 13 punonjës, Drejtoria e Inspektimit Pyjor pranë IKMT ka 10 punonjës. Drejtoritë Rajonale të IKMT në 12 qarqe kanë nga 5 punonjës për fushën e mjedisit dhe 4 punonjës për pyjet.

Bashkitë. Bashkitë janë një institucion thelbësor në kontrollin e territorit dhe menaxhimin e burimeve natyrore në nivel vendor. Në varësi të madhësisë dhe shtrirjes së burimeve natyrore, Bashkitë kanë krijuar

³³ Në linjë me Dokumentin e Politikave të Pyjeve dhe Ligjin e Pyjeve të miratuar në 2019.

³⁴ AMBU funksionon sipas hierarkisë, me këto njësi organizative: a) Në nivel qendror: (Drejtori i Përgjithshëm; Drejtori; Sektorë); b) Në nivel baseni ujqor (ZABU): Drejtori i Zyrës; Sektorë.

³⁵ **Sektor i Monitorim-Kontrollit në varësi të kësaj drejtorie, kryen këto detyra kryesore:** Identifikon përdorimet pa leje dhe autorizime, si dhe monitoron zbatimin e rregullave dhe kriterëve mbi përdorimin e burimeve ujore; Monitoron dhe ndjek zbatimin e kushteve të lejeve dhe autorizimeve nga subjektet përkatëse; Mbikëqyr mbrojtjen dhe përmirësimin e burimeve ujore me qëllim garantimin e statusit të përcaktuar; Kontrollon ruajtjen e zonave/brezave të mbrojtjes për burimet ujore; Propozon masa dhe bashkëpunon me inspektoratin përgjegjës për ujërat për marrjen e masave ndëshkuese ndaj subjekteve të gjendura në shkelje me qëllim garantimin e ligjshmërisë; Bashkërendon punën me organet e tjera ligjzbatuese në kuadër të formalizimit të përdorimit të ujit dhe garantimit që përdorimi i burimeve ujore nga subjektet të ndryshme është në përputhje me kërkesat ligjore. Monitoron përmbushjen e detyrave nga subjektet, institucionet, siç përcaktohet në vendimet e KKU-së dhe KBU-së nëpërmjet Zyrave të Administrimit të Basenit Ujqor.

drejtori apo sektorë që janë përgjegjëse për ndjekjen e problematikave mjedisore dhe për menaxhimin e burimeve natyrore (pyje e kullota) që administrohen nga Bashkia. Ndërkohë, brenda administratës së Bashkive funksionon edhe Polica Bashkiake dhe Inspektorati i Kontrollit të Territorit. Përgjithësisht, bashkia bën inspektime në pyje, por në bazë të ankesave apo sinjalizimeve nga qytetarët verifikon edhe ngjarje të tjera mjedisore për të cilat njofton ARM dhe IKMT si institucione të specializuara. Inspektorët e pyjeve dhe kullotave kanë për detyrë menaxhimin e gjithë aspekteve të pyjeve dhe kullotave, përfshirë konstatimin e shkeljeve dhe referimin në IKMT, e cila ndjek procesin në vijim. Pritet që së shpejti, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP) të krijohet inspektorat i veçantë për pyjet e kullotat në bashki. Është e nevojshme dhe e rëndësishme të unifikohet dokumentacioni për ndjekjen e shkeljeve. Përgjithësisht kapacitetet njerëzore të bashkisë janë të kufizuara si në numër edhe në aftësi/njohuri specifike lidhur me shkeljet mjedisore.³⁶

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për zhvillimin e ekonomisë së vendit përmes inkurajimit të bujqësisë, por po ashtu sipas sektorëve të programit zhvillohet edhe peshkimi në mënyrë të kontrolluar, mbrojtja e diversitetit biologjik dhe e pyjeve, etj. Brenda Ministrisë së Bujqësisë ekziston Inspektoriati i peshkimit, me shtrirje lokale i cili është përgjegjës për inspektimin e e peshkimit të paligjshëm .

4.2 Institucionet ligjzbatuese

Prokuroria. Prokuroria e Rrethit ka rol kryesor në kryerjen e kontrollit të hetimit që kryen policia gjyqësore, si dhe ka për detyrë ndjekjen penale të rasteve të kallëzuar nga qytetarët, nëpunësit publikë ose të referuar nga policia gjyqësore, duke mos përjashtuar edhe fillimin e ndjekjes penale. Po ashtu, Prokuroria e Përgjithshme përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit dhe merr masa e mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale. Në rastet e identifikimit të veprave penale kundër mjedisit, është detyra e institucionit kompetent publik ta raportojë çështjen në prokurori dhe kjo e fundit, për këtë qëllim, duhet ta ketë shumë qartë diferencën midis veprës që konsiderohet shkelje administrative dhe merr si dënim masë administrative apo nëse njihet si vepër penale.

Prokuroria e Përgjithshme. Prokurori i Përgjithshëm, kompetencat i ka të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Ndër të tjera Prokurori i Përgjithshëm përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme; nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre; siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë së juridiksionit të Përgjithshëm etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në varësi të Ministrisë së Brendshme, ishte një nga palët e intervistuar gjatë procesit të intervistave për realizimin e këtij raporti. Si hallka më e lartë që përcakton detyrat dhe bashkërendimin e punës së drejtorive vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka si prioritet të punës luftën kundër kriminalitetit në të gjithë vendin. Kontrollin e territorit me synim parandalimin e goditjen e krimit mjedisor dhe në mënyrë të veçantë evidentimin e ndërtimeve pa leje dhe procedimin e vënien para drejtësisë e autorëve të tyre. Policia e Shtetit ka rol parësor në gjetjen dhe raportimin e krimit kundër mjedisit. Që nga 2015 policia është ristrukturuar dhe ky ndryshim synon të sjellë një efikasitet më të lartë në punën e policisë, duke bashkërenduar punën e

³⁶ Bashkia nuk ka personel të aftë për inspektimin dhe ndjekjen e problemeve komplekse si ndota e ajrit, uji apo tokës. Në shumicën e rasteve ka mungesë në mjete lëvizëse për sektorin e pyjeve dhe mjedisit. Disa bashki kanë siguruar pajisjet e nevojshme IT (kompjutera, printera) si dhe pajisje për matjen e pyjeve. Inspektorët nuk kanë uniforma apo mjete të tjera dalluese.

departamenteve dhe linjave të reja të aksionit. Punonjësit e Policisë së shtetit kanë dhe një rol të rëndësishëm në hetimin e veprave penale nëpërmjet oficerëve të policisë gjyqësore. Policia gjyqësore është organizuar dhe funksionon në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” ndërsa veprimtaria e oficerëve të Policisë Gjyqësore mbështetet dhe kryhet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Funksionet e Policisë Gjyqësore në Shqipëri kryhen nga seksionet e policisë gjyqësore, të ngritura pranë prokurorive dhe nga shërbimet e policisë gjyqësore, të organizuara në strukturat hetimore të Policisë së Shtetit ose Policisë Kufitare dhe në institucionet e tjera shtetërore të cilave ligji u njuh te drejtën e ushtrimit të funksioneve të policisë gjyqësore, sikurse janë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Policia Ushtarake, etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e rregullave në lidhje me importin dhe eksportin. Megjithëse ky institucion është në varësi të Ministrisë së Financave, ai i raporton prokurorisë në rastet e identifikimit të shkeljeve kundër mjedisit, si dhe raporton çdo vit në Zyrën e Kimikateve të dhënat e vitit të kaluar për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme. Po ashtu, me kërkesë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Doganave jep informacion mbi tregtimin e mërkurit.

4.3 Institucione të tjera

Institucionet e tjera që lidhen me krimin mjedisor përfshijnë institucionet arsimore, formuese dhe akademike (universitetet), organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri.

Institucionet akademike

Universiteti i Tiranës

Universiteti i Tiranës, është një nga institucionet akademike më të mëdha në Shqipëri, i cili përgatit specialistë të fushave të ndryshme ku përfshihen edhe specialistët që trajtojnë aspekte të ndryshme të krimit mjedisor. Fusha e mjedisit dhe specifikisht e krimit mjedisor më së shumti është e lidhur me dy fakultetet kryesore të këtij Universiteti: **Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës.**

- **Fakulteti i Drejtësisë** është institucioni fillestar kryesor në vend që përgatit specialistë të së drejtës përfshirë këtu edhe krimin mjedisor. Ky Fakultet përgatit juristë të cilët marrin njohuri në fushën e hetimit dhe gjykimin duke u bërë pjesë e sistemit të drejtësisë pas kalimit përmes Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, ky Fakultet përgatit juristë të cilët bëhen pjesë e strukturave të politik-bërjes në nivel qendror e lokal. Në këtë kontekst, aftësimi i tyre dhe përfitimi i njohurive që lidhen me të drejtën mjedisore në përgjithsi e sidomos me atë të krimit mjedisor në veçanti, ka një rëndësi të madhe në trajtimin e mëpasshëm të kësaj problematike. Megjithatë nga të gjitha programet e studimit që ofron Fakulteti i Drejtësisë në UT, Programi i studimit “Master i integruar i shkencave në Drejtësi”, i cili zhvillohet në kohështrirje 5-vjeçare, e trajton të drejtën e mjedisit si një lëndë dytësore me zgjedhje. Aftësimi specifik mbi të drejtën mjedisore për studentët mbetet vetëm në nivelin e leksioneve të hapura të cilat rastësisht e sporadikisht mund të trajtojnë aspekte të së Drejtës Mjedisore.
- **Fakulteti i Shkencave të Natyrës** është gjithashtu një institucion akademik i lidhur ngushtë me fushën e mjedisit. Më së shumti ky fakultet përgatit specialistët, të cilët do të trajtojnë aspekte të menaxhimit mjedisor ku përfshihen monitorimi, inspektimi dhe vlerësimi i mjedisit. Nga 9

Departamentet e këtij Fakulteti, Departamenti i Biologjisë dhe ai i Kimisë janë ata të cilët ofrojnë programe studimore apo lëndë specifike që lidhen ngushtësisht me fushën e Mjedisit. Masteri i dedikuar për biologjinë e mjedisit trajton më së shumti aspekte të menaxhimit të mjedisit, ku përfshihen Monitorimi i Mjedisit, e Drejta Mjedisore, Vleresimi i cilësisë së Mjedisit si edhe vlerësimi i Ndikimit në mjedis të projekteve të ndryshme zhvillimore. Ky program studimesh përgatit specialistët të cilët më pas punojnë në sektorë dhe institucione të ndryshme që operojnë në fushën e menaxhimit të mjedisit, monitorimit, inspektimit, etj. Departamenti i Kimisë, gjithashtu në programin mësimor Master i shkencave në kimi, trajton aspekte që lidhen me monitorimin e mjedisit dhe të kimikateve, të cilat trajtohen në lëndën e “teknologjisë dhe mbrojtjes së mjedisit”. Megjithë trajtimin e tematikave që lidhën më menaxhimin e mjedisit, sërish në të dyja këto fakultete të përmendura më sipër, mungon në kurrikulën e tyre trajtimi specifikisht i krimeve kundër mjedisit. Njohuritë që lidhën me krimin mjedisor janë të kufizuara për studentët të cilët si mundësi të vetme për t’u informuar dhe aftësuar në këtë kuadër kanë vetëm trajnimet ekstrakurrikulare apo leksionet e hapura që mund të organizojë sporadikisht fakulteti përkatës. Duke i’u referuar Fakultetit të Shkencave të Natyrës, mungon bashkëpunimi me institucionet që trajtojnë hallka të caktuara të elementeve të krimit mjedisor. Ky bashkëpunim është mjaft sporadik vetëm në rastet shumë specifike ku institucionet që hetojnë krimin mjedisor kërkojnë ndihmën e specialistëve të FSHN, në lidhje me specie të caktuara të faunës, apo laboratorëve të FSHN për substanca dhe komponentë kimikë të caktuar të cilët janë objekt i krimit mjedisor.

Universiteti Bujqësor i Tiranës. Universiteti Bujqësor i Tiranës përfshin disa fakultete e departamente që janë të lidhura me procesin e identifikimit dhe ndjekjes së shkeljeve mjedisore. Më poshtë përshkruhen dhe analizohen dy prej tyre.

- **Fakulteti i Shkencave Pyjore.** Fakulteti i Shkencave Pyjore, pjesë e Universitetit Bujqësor të Tiranës, realizon edukimin profesional dhe shkencor të studentëve përmes programeve të studimit, kërkimit dhe trajnimit në fushën e shkencave të pyjeve dhe të drurit. Pjesë e programit mësimor në këtë fakultete është edhe lënda “Njohuri për të drejtën –Legjislacioni pyjor e mjedisor” është lëndë semestrale (45 orë), pjesë e programit të detyrueshëm “bachelor” që zhvillohet në vitin e parë të studimeve. Lënda përmbledh konceptet bazë të hartimit të ligjeve, ligjshmërinë e kontratave, të drejtën e punës, administratën publike si dhe ndalet më specifikisht në përmbajtjen dhe analizimin e ligjeve që lidhen me pyjet, zonat e mbrojtura dhe mjedisin në përgjithësi. Lënda trajton edhe kundravajtjet penale sipas përcaktimeve të kodit penal dhe kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Lënda nuk përfshin aspekte praktike të ndjekjes dhe hetimit të kundravajtjeve në pyje, përfshirë hartimin/plotësimin e proces-verbaleve apo formave standarde të vlerësimit të dëmit. Lënda nuk është pjesë e programit të studimit “Master Profesional”. Lektorët e Fakultetit të Shkencave Pyjore nuk janë përfshirë në trajnime specifike lidhur me krimin mjedisor. Fakulteti nuk ofron kurse ad hoc lidhur me këtë problematikë.
- **Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit.** Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore, pjesë e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit në Universitetin Bujqësor të Tiranës ofron njohuri shkencore multidisiplinore për studentët nëpërmjet programeve të studimit të fokusuara në shkencat mjedisore dhe agromjedis. Lënda “E drejta për burimet natyrore” (60 orë), është pjesë e programit të detyrueshëm “bachelor” që zhvillohet në vitin e tretë të studimeve. Lënda përmbledh njohuri mbi historikun e legjislacionit mjedisor në botë dhe zhvillimet e tij në Shqipëri, parimet themelore të ligjeve mjedisore përfshirë edhe konventat ndërkombëtare, reflektimi dhe përafrimi i parimeve ndërkombëtare në legjislacionin kombëtar, karakteristikat dhe problematikat e hartimit të legjislacionit mjedisor. Direktivat Evropiane për mjedisin trajtohen si temë më vete në programin e lëndës, ku përfshihen edhe informacione mbi

nivelin e përafrimit dhe zbatimit të këtyre direktivave në Shqipëri. Pjesë e programit është edhe plotësimi i dokumentacionit për shkeljet mjedisore. Sidoqoftë, programi i lëndës nuk përfshin njohuri mbi organizimin dhe kryerjen e inspektimeve si dhe ndjekjen apo hetimin e krimeve mjedisore. Po ashtu, në programin “Master Profesional” zhvillohet lënda “Legjislacioni mjedisor dhe kuadri institucional”, e cila fokusohet më shumë në përshkrimin e rolit të institucioneve të ndryshme në fushën e mjedisit. Lëndë të ngjashme ofrohen edhe në programet e tjera të studimit si “E drejta agrare” në Master Profesional në Bujqësi dhe “E drejta mjedisore” në Master Profesional “Turizmi rural”. Departamenti nuk ofron kurse specifike kualifikimi/trajnimi lidhur me legjislacionin mjedisor apo ndjekjen/hetimin e krimeve mjedisore.

- Në analogji me institucionet akademike që janë listuar më sipër, në Shqipëri, janë edhe institucionet e tjera rajonale si Universiteti i Vlorës, Shkodrës, Gjirokastrës, Elbasanit etj. ashtu si edhe Universitetet private. Edhe këto universitete janë të ngjashme me ato të trajtuara më sipër duke shfaqur të njëjtat mangësi sa i përket qasjes së kurrikulave të tyre në raport me adresimin e Krimit Mjedisor.

Akademia e Sigurisë është rithemeluar në 2015 dhe është pjesë e Policisë së Shtetit Shqiptar, e fokusuar në edukimin, specializimin dhe trajnimin e oficerëve dhe agjentëve të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese. Akademia ofron programe studimi dhe kurse specializimi dhe trajnime mbi policimin, zbatimin e ligjit dhe çështjet e sigurisë.³⁷ Drejtoria e Kurrikulave pranë AS është përgjegjëse për hartimin e programeve dhe në fushën e trajtimit të krimit mjedisor. Tematika e veprave kundër mjedisit trajtohen si në programin bazë dhe në trajnimin e vazhduar për oficerë dhe agjentë të karrierës. Aktualisht, ngarkesa e trajtimit të temave dhe veprave kundër mjedisit është vetëm 3 orë për trajnimin e vazhduar dhe qëllimi është që në 2023, këto tematika të pasurohen në 3 ditë për programin e trajnimit të vazhduar.

Shkolla e Magjistraturës është themeluar në vitin 1996 dhe mundëson rekrutimin dhe formimin fillestar të kandidatëve për magjistratë, formimin e vazhdueshëm profesional të magjistratëve në detyrë, si dhe zhvillon teste për këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësit ligjorë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe për ish-këshilltarët ligjorë në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, e për ish-gjyqtarët e ish-prokurorët që dëshirojnë të hyjnë në sistem, për të cilët nuk ka raporte vlerësimi për aftësitë e tyre profesionale.³⁸ Shkolla e Magjistraturës, si pjesë e veprimtarisë së saj kryen trajnime të vazhdueshme, por nuk janë specifike për krimin mjedisor. Magjistratët në programin shkollor i dedikohen hetimit dhe ndjekjes gjyqësore të krimeve kundër mjedisit për vetëm 3 ditë, ndërsa sa i përket formimit të vazhdueshëm, ka pasur vetëm një trajnim lidhur me krimin mjedisor të organizuar në tetor të vitit 2022. Drejtuesit e Shkollës së Magjistraturës ishin ndër të intervistuarit për përgatitjen e këtij punimi dhe **shprehën nevojën për përgatitjen e kurrikulave specifike për krimin mjedisor si dhe ofrimin e trajnimeve të ndryshme për magjistratët e rinj në luftën kundër krimit mjedisor.**

³⁷ www.asp.gov.al/akademiaesigurise

³⁸ <https://www.magjistratura.edu.al/sq/aktiviteti-i-shkolles>

4.3.1 Organizatat e Shoqërisë Civile

Hulumtimi në lidhje me aktorët dhe institucionet e duhura për luftimin e krimit dhe veprave penale mjedisore konsistoi në analizimin dhe përshkrimin e aktorëve dhe institucioneve të tjera jo-shtetëore si OJQ-të dhe media.

OJQ-të po marrin gjithnjë e më shumë një kombinim të roleve mbrojtëse dhe zbatuese në lidhje me krimin mjedisor. Ato punojnë në mënyra të ndryshme në të gjitha nivelet e funksionimit, si puna në komunitet, nivel kombëtar ose rajonal dhe në disa raste një kombinim i këtyre shkallëve të ndryshme. Krahasuar me agjencitë qeveritare, ato zakonisht kanë shumë më pak burime (fuqi punëtore, financim) në dispozicion, por edhe më pak kufizime në disa nga aktivitetet e tyre, p.sh. në lidhje me shpërndarjen e informacionit.

OJQ-të kryejnë fushata avokuese dhe ndërgjegjësuere për çështjet mjedisore, disa prej të cilave lidhen me krimin mjedisor. Për sa i përket aktiviteteve investiguese/hetuese, pak OJQ kanë mandat për të hetuar kundër mjedisit, por disa prej tyre kontribuojnë në mënyrë joformale në zbatimin penal duke mbledhur informacion dhe duke ia paraqitur atë zyrtarëve shtetërorë ose publikut më të gjerë. Për më tepër, OJQ-të marrin një rol të konsiderueshëm në zbatimin e MSHP si CITES në mbledhjen, përpilimin dhe shpërndarjen e informacionit përkatës tek sekretariatet e MSHP-ve, autoritetet shtetërore dhe publiku më i gjerë, duke qenë kështu një burim i rëndësishëm për pajtueshmërinë mjedisore.

- Organizata të specializuara në fushën e ruajtjes së natyrës si **PPNEA, AOS, INCA, EcoAlbania** etj. kanë një kontribut të veçantë jo vetëm në gjenerimin e informacionit mjedisor sa i përket fushës së ruajtjes së natyrës por edhe në nxitjen dhe përmirësimin e politikave monitoruese dhe inspektuese.
- Organizata si REC, EDEN, Milieucontact, URI etj. trajtojnë aspekte të legjislacionit horizontal, dhe politikat e menaxhimit të mjedisit urban si mbetjet, ndotja, zhurmat etj. Ato gjithashtu kanë një kontribut në studimin dhe ofrimin e të dhënave në këto fusha specifike të cilat në konceptin e krimit mjedisor përbëjnë gjithashtu një element të rëndësishëm.
- Edhe organizatat e specializuara në ndërgjegjësim dhe llogaridhënie si Ekolëvizja, Ecovolis, Shoqata e Bujqësisë Organike etj. në jo pak raste kanë patur ndikimin e tyre në nxitjen e politikave të caktuara që lidhen me adresimin e mjaft çështjeve të mprehta mjedisore.
- Përveç punës individuale të organizatave të caktuara që operojnë në fushën e mjedisit dhe që trajtojnë aspekte të ndryshme të krimit mjedisor, OSHC-të shpeshherë janë organizuar në rrejte dhe aleanca tematike, siç është rasti i nisës së **Grupit Këshillimor Kundër Krimit Mjedisor**. Grupi Këshillimor Kundër Krimit Mjedisor i Organizatave të Shoqërisë Civile (GKKKM) u krijua në fund të vitit 2019, me iniciativën dhe mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.³⁹ Ky grupim është një organizëm jo formal, i pavarur dhe vullnetar i 18 ekspertëve mjedisorë, organizatave të shoqërisë civile dhe gazetarëve që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin në nivel qendror dhe lokal, për të ndihmuar në avancimin e agjendës së qeverisë në luftën kundër krimit mjedisor, duke bashkëpunuar me autoritetet përgjegjëse dhe komunitetet me synim adresimin e krimit mjedisor. Grupimi funksionon në bazë të takimeve periodike dhe ka një kontribut në ndërtimin e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet politikëbërëse mjedisore.

³⁹ www.osce.org/albania

Megjithë shkëmbimi i shpejtë i informacionit, bashkëpunimi i qendrueshëm dhe i ndërsjellë si edhe spektri i ekspertizës mes OSHC-ve dhe agjencive ligjzbatuese mjedisore, mbeten ende sfida të mëdha në adresimin e krimit mjedisor në Shqipëri.

4.3.2 Media

Aktualisht në Shqipëri ka afërsisht 45 televizione, 55 radio, rreth 800 portale online, 11 mediaprint, 3 platforma dixhitale, dhe rreth 5100 punonjës. Megjithatë, edhe pse ka një larmi të mjeteve të informimit, gazetarët e intervistuar në kuadër të këtij vlerësimi bazë pohojnë se ka një rënie të cilësisë së informimit.

Gjithashtu, aktorët e përfshirë në këtë vlerësim bazë shprehen se raportimet mbi krimin mjedisor dhe çështje të tjera mjedisore janë të pakta, duke e zënë hapësirën lajmet “sociale” dhe ndonjëherë “ekonomike” në lidhje me lajmet e ditës.

Në këtë kuadër në televizionet e mëdha kombëtare mungon një hapësirë e dedikuar e çështjeve të mjedisit. Në asnjë prej mediave televizive kombëtare nuk ka një gazetar të dedikuar për të raportuar çështjet mjedisore. Raportimet mjedisore pozicionohen në grupin e fundit të lajmeve dhe jo në pak raste “vuajnë” nga mungesa e autorësisë⁴⁰.

Nga intervistat me gazetarë të ndryshëm, ata janë shprehur se shumë prej pronarëve të mediave në Shqipëri zotërojnë paralelisht edhe sipërmarrje që konistojnë në shfrytëzim të burimeve natyrore dhe kjo përbën një pengesë specifike të trajtimit të paanshëm të rasteve të dëmtimit të mjedisit nga media të caktuara.

Megjithatë disa emisione investigative, tanimë duke u specializuar në tematika mjedisore, si:

- “Inside Story” – Top Channel,
- “STOP” – TV Klan,
- “EcoScanner” – SCAN TV,
- “Veting” – abc neës, etj,

kanë trajtuar jo pak investigime që trajtojnë çështje të caktuara që lidhen me elementë të krimit mjedisor. Çështje të caktuara mjedisore kanë gjetur vëmendjen e duhur, sidomos kur ato gërshetohen me elemente të korrupsionit, cënimit të të drejtave themelore të komuniteteve etj. Në këtë kontekst **BIRN**, **Faktoje.al**, **Citizens Channel** por edhe portale të tjera kanë trajtuar herë pas here tematika të nxhehta mjedisore nëpërmjet shkrimeve investigative dhe reportazheve.

Një nga prodhimet e BIRN që trajton në mënyrë të përmbledhur historinë 15-vjeçare të dëmtimit të lumenjve pa kriter si pasojë e ndërtimit të HEC-eve është dokumentari “Pro Rrymës”⁴¹. Cikli i emisioneve “Inside Story” shpeshherë ka trajtuar problematika të mprehta mjedisore si, “Hidrocentralet në Valbonë” apo “Grabitja e Zonave të Mbrojtura”⁴².

Gjithashtu edhe emisioni “Veting” ka trajtuar shpesh problematika që lidhen me mbetjet urbane. Një investigim i plotë ky emision ka zhvilluar mbi temën e trajtimit të mbetjeve spitalore⁴³.

“Elementi i pestë”⁴⁴, është një platformë online, e cila mund të konsiderohet si një ndër hapësirat e pakta të dedikuar mjedisit dhe zhvillimit të qendrueshëm. Platforma konsiston në një cikël dokumentarësh të cilët përveç investigimit të çështjeve mjedisore, promovojnë vlerat e natyrës në Shqipëri si edhe edukojnë publikun mbi këto vlera.

⁴⁰ https://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2019/11/Raport-MECA_ALB.pdf

⁴¹ https://www.youtube.com/watch?v=RPnQWY8KsE8&ab_channel=EltonBaxhaku

⁴² https://www.youtube.com/watch?v=towEHpGQblA&ab_channel=TopChannelAlbania

⁴³ https://www.youtube.com/watch?v=SpFYnoJirgs&ab_channel=ABCNewsAlbania

⁴⁴ <https://www.elementipeste.al/>



5

Analiza e mangësive



5. Analiza e mangësive

5.1. Mangësitë në kuadrin ligjor

Kodi Penal parashikon ndëshkimet penale për çdo veprë penale në mjedis, por shpeshherë për të përcaktuar rëndësinë dhe madhësinë e veprës referim bëhet tek legjislacioni i posaçëm i zbatueshëm për atë veprë. Për shembull, neni 201 i Kodit Penal përcakton se *ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, **tej kufirit të normave të lejuara me ligj**, dënohen me burgim deri në tre vjet*. Siç mund të vihet re, Kodi Penal parashikon ndëshkimet penale, por këto ndëshkime bazohen në specifikime dhe madhësi pasojash që janë të matshme jo nga vetë Kodi Penal por vetëm nga legjislacioni i posaçëm që rregullon atë çështje mjedisore.

Pra, Kodi Penal kërkon ndihmën e legjislacionit të posaçëm për të klasifikuar veprën penale dhe përcaktuar dënimin adekuat. Është pikërisht legjislacioni i posaçëm që përcakton rregullat mbi mbrotjen e ajrit, ujit, tokës, pyjeve, kafshëve, faunës, etj, sjelljet-veprimet apo mosveprimet që duhet të konsiderohen si shkelje administrative, saksionet për këtë shkelje, organet që i përcaktojnë këtë shkelje si dhe **vlerësimin e dëmit dhe mënyrën se si do ta kryejnë këtë vlerësim (në shembullin konkret, kufirin e normave të lejuara)**, në mënyrë që Gjykata të përcaktojë llojin dhe masën e ndëshkimit.

Ligjet e posaçme kanë në fakt të parashikuara si ndëshkim **masa administrative** për çdo shkelje, duke i kategorizuar këto masa sipas llojit, rëndësisë së shkeljes dhe shpeshtësisë së saj. Masat janë kryesisht të karakterit administrativ (*pezullim dhe/ose pushim aktiviteti*) ose monetar (*gjoba të ndryshme për shkeljet e kryera apo zhdëmtim, rikuperim i pasojave negative*), por kur shfaqen pasojat e specifikuara në secilën veprë të Kodit Penal, transformohen automatikisht në krime ose kundërvajtje penale mjedisore dhe rrjedhimisht të dënueshme edhe me burgim.

Kriteri për të përcaktuar nëse një shkelje mjedisore ndëshkohet nga ligji administrativ apo ai penal është vlera e dëmit të shkaktuar në mjedis. Megjithatë aktet nënligjore që përcaktojnë kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të rënda nga ato të lehta, deri në datën e këtij punimi ende nuk janë miratuar. Ligji nr.57/2020 “Për Pyjet” mund të përdoret si shembull në këtë drejtim sa i përket ndarjes së dënimeve në bazë të dëmit. Megjithatë edhe ky ligj shfaq probleme në tejkalimin apo mbivendosjen e shkeljes mjedisore si administrative apo penale. Për shembull rekomandohet rishikimi i nenit 36 i këtij ligji, i cili në disa pika të tij ka ndikuar negativisht në strukturën e kriminalizimit të dëmeve mjedisore dhe pasojave nga shkeljet mjedisore në pyje. Konkretisht, pika 8 e nenit 36 ka prishur strukturën e kriminalizimit sepse shkelje të tilla si: shkarkimet e kimikateve, të ujërave të ndotura industriale në fondin pyjor kombëtar; gjurmimi për karriera të çdo lloji që përdorin lëndë plasëse pa lejen përkatëse; djegia e sipërfaqeve në fondin pyjor kombëtar, dënohen me gjobë, ndërkohë që Kodi Penal penal veprimet të tilla i kategorizon minimalisht si kundërvajtje penale. Po ashtu, ky nen e konsideron djegien e pyjeve si kundërvajtje administrative, megjithëse kjo shkelje/veprë është veprë penale e mirëfilltë, duke u mbivendosur madje duke rënë në kundërshtim flagrant me dispozitat e Kodit Penal. Pika 9 e nenit 36 të ligjit për pyjet, bie po ashtu në kundërshtim me Kodin Penal, sepse thekson se kur pasojat janë të rënda aplikohet ndëshkim administrativ me gjobë, ndërkohë që pasojat e rënda i bëjnë automatikisht këto shkelje mjedisore krime mjedisore të mirëfillta dhe si rrjedhojë të dënueshme nga Kodi Penal.

Për hir qartësie, mbrojtja juridike penale parashikohet vetëm në Kodin Penal. Veprimet apo mosveprimet e kundraligjshme që cënojnë mbrojtjen e mjedisit (ajrin, ujin, tokën, bimët, pyjet, etj.) nga ndotja janë vepra penale, kur ato janë kryer me faj dhe parashikohen shprehimisht nga legjislacioni penal. Si rregull, ato që nuk parashikohen nga ligji penal do të thotë që janë shkelje administrative. Megjithatë, duke patur në konsideratë legjislacionin administrativ për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin penal, si dhe faktin se fillimisht këto vepra apo sjellje të kundraligjshme identifikohen, zbulohen, materializohen nga organet administrative të ngarkuara me ligj për këtë detyrë, të cilët bëjnë dhe vlerësimin dhe përcaktojnë llojin e përgjegjësisë (atë administrative të kundërvajtësve) dhe kur nuk është e tillë detyrohen ta kallëzojnë apo referojnë faktin në prokurori. Në këtë mënyrë ekspertët ndajnë të njëjtin mendim se organet administrative nga mënyra se si janë organizuar dhe funksionojnë, duke patur si detyrë të parandalojnë dëmet/ndotjet mjedisore, janë të parët që duhet të marrin masat administrative dhe kur këto shkelje nuk parashikohen si shkelje administrative në ligjin e tyre duhet ta kallëzojnë në prokurori, sipas rregullimeve që bën çdo ligj i posaçëm në dispozitëërkatëse mbi kundërvajtjet administrative

Ajo që mbetet problematike është ambiguiteti ligjor i kompetencave që i janë dhënë disa autoriteteve nga pikëpamja administrative por edhe vete identifikimi i atyre veprimeve apo mosveprimeve që mund të bien nën suazën e krimit mjedisor. Sistemi i mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri, që përbëhet pikërisht nga lidhja midis ligjeve administrative dhe dispozitave të Kodit Penal, nuk përmban një dallim të qartë se çfarë përbën një kundërvajtje administrative dhe çfarë përbën vepër penale në dritën e mbrojtjes së mjedisit. Një hap i rëndësishëm përpara në këtë drejtim është bërë nëpërmjet ligjit 57/2020 “Për pyjet”. Në këtë ligj përcaktohet se çdo referim tek Inspektorati/Policia Pyjore dhe për shkelje në fondin pyjor kombëtar do të nënkuptojë respektivisht kontrollin dhe procesin e inspektimit sipas strukturave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, përveç mbrojtjes dhe sigurisë së pyjeve ndaj veprave penale në to, për të cilat bëhet referim në strukturat e posaçme të mbrojtjes së pyjeve pranë ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit.

Megjithë përmirësimet e konsiderueshme në Kodin Penal sa i përket krimit mjedisor, ekspertët mendojnë se Kodi Penal ka pak nevojë për saktësim, qartësim dhe harmonizim me ligjet e posaçme në drejtim të saktësimin dhe mirëkategorizimit të veprës penale. Si shembull konkret sjellim nenin 201/c të Kodit Penal në të cilin duhet qartësuar gjuha e togëfjalëshit: *ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda*. Përdorimi i termit *ka mundësi*, në kontekstin e dëmit mjedisor nuk duket i legjitimuar pasi dëmi, fjala vjen në ajër, ose shkaktohet ose nuk shkaktohet. Si koncept juridik, togëfjalësi “*ka mundësi*” barazohet me kuptimin e tentativës së veprës penale, por tentativa nuk ekziston si institut ligjor në veprat penale kundër mjedisit. Po ashtu, neni 205 i Kodit Penal i cili përcakton se “Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit” tanimë duket i pazbatueshëm, sepse shkeljet mjedisore dhe dëmtimet e pyjeve të çfarëdo lloji janë listuar të gjitha si kundërvajtje administrative në kuptim të ligjit për pyjet, duke e bërë këtë dispozitë të Kodit Penal jo efektive dhe të pazbatueshme siç u shpjegua më sipër.

Po ashtu, në Kodin Penal për veprat kriminale mjedisore nuk parashikohet si rrethanë rënduese e si pasojë me dënim më të rëndë **përgjegjësia e veprës kur është në bashkëpunim**. Teksa, me ndryshimet e 2019 janë parashikuar rrethana rënduese dhe lehtësuese, mungon përgjegjësia e bashkëpunëtorit sipas parimeve të Kodit Penal për çdo person që vepron si “ekzekutues”, “nxitës” ose “ndihmues” në kryerjen e veprës penale.

Po ashtu, mungojnë **ndëshkime penale ndaj personave juridike që kryejnë krime kundër mjedisit**, duke lehtësuar pozicionin e tyre në sanksionim, pasi këta të fundit dënohen kryesisht me gjobë⁴⁵, përkundrejt dënimeve të shtuara maksimale për individët, që shkojnë deri në burgim.

Si parim, ndotësi apo dëmtuesi i mjedisit duhet të rimburojë çdo kosto e cila vjen nga ndotja e mjedisit në përputhje me parimin “ndotësi paguan”. Vlerësimi real i dëmit mjedisor, sipas legjislacionit administrativ për mbrojtjen e mjedisit, kryhet nga organet kompetente administrative, që mbi bazën e kësaj vlere të dëmit të shkaktuar përcaktojnë nëse veprimet apo mos veprimet e kryera në shkelje të ligjit të posacëm dhe atij për mbrojtjen e mjedisit (si rezultata i së cilës ka ardhur ky dëm/ndotje) përbën kundravajtje administrative apo vepër penale. Konkretisht neni 12 i Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” parashikon parimin “Ndotësi paguan” duke theksuar se: *“Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimitit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar”,* Megjithëse ndëshkimet që parashikohen për ndotësit në ligjet e posaçme si në shembullin e ligjit për mbrojtjen e mjedisit e referojnë parimin ‘ndotësi apo dëmtuesi paguan’, ende mungojnë aktet nënligjore që përcaktojnë metodologjinë e këtij parimi, pra parashikimi i veprimeve që vlerësojnë dëmin e shkaktuar nga shkelësi në masën e nevojshme për rehabilitimin e mjedisit.

Një hap përpara në këtë drejtim është legjislacioni i zonave të mbrojtura. VKM 128/2020 “Për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, mënyrën e vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj” parashikon llojin e dëmtimit në zonat e mbrojtura mjedisore, edhe pse kjo VKM nuk përcakton se mund të përdoret e njëjta metodologji sipas kësaj VKM edhe për të gjitha zonat pyjore në vend.

Po ashtu, shoqëritë mund të vazhdojnë aktivitetin e tyre edhe nëse janë nën hetim apo gjykim për ndotje mjedisi, edhe pse nuk kanë paguar gjobat e përcaktuara apo edhe pse nuk janë as të detyruar të paguajnë për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar prej tyre. Pra në praktikë parimi ndotësi paguan nuk zbatohet dhe mungesa e një kuadri ligjor për ndëshkimin e tyre vështirëson vënien në praktikë të këtij parimi.

Hapa përpara në këtë drejtim i takojnë legjislacionit për mbrojtjen e pyjeve që megjithatë ende duhet plotësuar⁴⁶. Për të evidentuar mangësitë nga ana praktika janë kryer një seri intervistash me zyrtarë të institucioneve të ndryshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ngriti gjatë intervistës çështjen e mungesës së raportimeve nga qytetarët të krimeve mjedisore, duke theksuar se këto të fundit identifikohen dhe evidentohen nga kontrollet në terren. Në vendin tonë, ka mundësi të raportohen krimet mjedisore përmes formave shumë të lehta të komunikimit me organet e policisë, si raportimi përmes numrit të dedikuar 112 dhe Komisaritat Digjital, por mungon ndërgjegjësimi i qytetarëve për përgjegjësinë e tyre individuale në raportimin e krimit mjedisor. Në rastet e raportimeve reagimi nga patrulla dhe inspektorët e policisë në terren është i menjëhershëm. Nga ana tjetër, sa i përket vetë burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, një nga kërkesat e ardhura nga organet e policisë në BE, Europol është krijimi i një grupi të dedikuar pune për krimet mjedisore. Janë zhvilluar vitet e fundit trajnime me forcat policore shqiptare, të organizuara dhe realizuara nga karabinieria italiane, për

⁴⁵Neni 9 i Ligjit nr.9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”. Më tej neni 10 “Dënimet plotësuese” parashikon se ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, bashkë me dënimin kryesor mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënimet plotësuese:

a) mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik;

b) vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar;

c) ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike;

ç) heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve;

⁴⁶ Një shembull hap përpara në këtë drejtim është sjellë për këtë është ligji i ri “Për Pyjet” nr. 57, i vitit 2020, ku parashikohet se mënyra e zbatimit të parimit ndotësi paguan përcaktohet në një Vendim të Këshillit të Ministrave, VKM e cila pritet të miratohet së shpejti.

të cilët oficerë të policisë shqiptare kanë udhëtuar për në Itali, megjithatë ka nevojë të kryhen trajnime të tilla edhe në nivel inspektorësh.

Në intervistat me prokurorët, një aspekt i rëndësishëm i evidentuar ka të bëjë me diskrecionin e inspektorit për të bërë një kallëzim penal kundër shkelësit, dhe problemi qëndron pikërisht në faktin që këta inspektorë hezitojnë sepse mungon një ndarje e qartë se kur shkelja konsiderohet vepër penale dhe kur procedohet në rrugë administrative. Ndërkohë ka **trajnime të vazhdueshme** që po bëhen nga Shkolla e Magjistraturës, por nuk janë specifike për krimin mjedisore, prandaj kjo e fundit duhet të mbështetet me programe trajnimesh sa i përket krimit mjedisor.

Nga ana tjetër edhe **Akademia e Sigurisë** duhet të përgatisë trajnime të tilla për anëtarët e saj në mënyrë që të bëhet më e lehtë vënja në zbatim e këtij legjislacioni në momentin që ata janë edukuar mbi këtë fushë dhe nisin të praktikojnë detyrën në zbatim të ligjit.

5.1.2. Ndëshkueshmëria e krimeve mjedisore

Sipas raportit vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme⁴⁷, vihet re një tendencë në ulje për procedimin e kësaj veprë penale në vitin 2021, me 41,46% krahasuar me 2020, ndërsa nga 2019 janë shënuar rritje nga 36 procedime në 41 procedime penale të regjistruara në vitin 2020.

Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore zë një peshë prej 4,46% në 2021 në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit”, ndërsa në 2020 ka qenë 7,25%. Të dhënat statistikore tregojnë një ulje të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 202/b i Kodit Penal “Dëmtimi i

habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore” në krahasim me vitin 2020, me 41,67%. Kjo veprë u shtua në vitin 2019, dhe gjatë vitit 2020 janë regjistruar 24 procedime penale për shkeljen e këtij neni⁴⁸.

Sa i përket ndjekjes, gjyqimit dhe ndëshkimit të veprave penale kundër mjedisit, në pesë vitet e fundit, nga viti 2017 e deri më sot, **ndotja e ajrit** ka pësuar rritjen më të lartë në vitin 2018 sa i përket regjistrimit të procedurave për shkeljen e këtij neni me 62 procedime, ndërsa sa i përket **prerjes së pyjeve** ishte viti 2020 kur shënoi rekordin e rasteve të regjistruara me 185 procedime.

Përkthyer në shifra, për veprat kundër mjedisit, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, gjatë vitit 2021, 33,34% e kërkesave kanë qenë për dënimin me gjobë dhe 66,66% për dënimin me burg, ku është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 84,09% të rasteve⁴⁹. Në 2020, prokuroria ka kërkuar për 53,19 % të rasteve dënimin me gjobë dhe 46,81 % për dënimin me burg, e për të gjithë të pandehurit është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë⁵⁰.

⁴⁷ Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, viti 2021, fq.143.

⁴⁸ Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, viti 2021, fq.143.

⁴⁹ Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, viti 2021, fq.144.

⁵⁰ Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, viti 2020, fq.151.

Përgjatë 2021, gjykata ka vendosur në 29,23% të dënimeve dënimin me gjobë dhe në 70,77% dënimin me burg, ku në 71,74% të rasteve është pezulluar vendimi i dënimit me burgim dhe i pandehuri është vendosur në provë. Në 1 rast është vendosur pushim çështje dhe 1 rast pafajësi. Ndërsa në 2020, gjykata për 44,68 % të dënimeve ka vendosur dënimin me gjobë dhe në 55,32 dënimin me burg, ku të gjithë dënimet janë pezulluar dhe i pandehuri është vendosur në provë. Për veprat penale kundër mjedisit, në vitin 2021 janë pezulluar 80 procedime që përbëjnë 25,48% të procedimeve të regjistruara, tregues në rritje krahasuar me vitin 2020 ku procedimet e pezulluara përbënin 21,45 % të numrit të procedimeve të regjistruara. Në fakt, gjatë vitit 2020, ky tregues ishte në ulje krahasuar me vitin 2019 ku procedimet e pezulluara përbënin 25,19% të numrit të procedimeve të regjistruara. Ky tregues vë në dukje se edhe nëse nis procedimi për ndjekjen e krimeve mjedisore, nuk arrin deri në dënimin e personave përgjegjës.

Prerja e paligjshme e pyjeve zë 47,13% të procedimeve të veprave kundër mjedisit në 2021, ndërsa në vitin 2020 kjo shifër ishte 55,89%. Ka një tendencë në ulje për procedimet e regjistruara për këtë vepër me 8.76% krahasuar me vitin 2020⁵⁷ dhe më tej nëse krahasohet me vitin 2019, ku zinte 61,28% të vlerës së të gjitha veprave penale kundër mjedisit. Trendi për këtë vepër kundër mjedisit tregon që është në rënie.

Duke iu referuar tabelës së mësipërme, më të raportuara dhe më të proceduara janë ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës, dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore dhe prerja e pyjeve.

Më të raportuara kundër mjedisit dhe niveli i procedimit e dënimit	VITI 2020					VITI 2021				
	Procedime të regjistruara	Procedime të dërguara në Gjykatë	Të pandehur të regjistruar	Të pandehur të dërguar në Gjykatë	Të pandehur të dënuar	Procedime të regjistruara	Procedime të dërguara në Gjykatë	Të pandehur të regjistruar	Të pandehur të dërguar në Gjykatë	Të pandehur të dënuar
N.201 ⁵¹	41	25	36	26	13	24	8	8	1	15
N.202/b ⁵²	24	2	18	3	0	14	0	4	0	0
N.204 ⁵³	9	4	14	5	3	9	2	10	5	4
N.205 ⁵⁴	185	30	64	33	28	148	47	76	52	34
N.206 ⁵⁵	16	1	2	1	1	14	3	1	3	2
N.206/a ⁵⁶	20	0	2	0	0	31	0	7	0	0

Tabela 2. me frekuencë më të lartë 2020/21. Burimi: Prokuroria e Përgjithëshme

Ndikimi në mjedis është ndër më të shpeshta në Shqipëri, megjithatë raportimet apo kallëzimet dhe referimet e veprave penale, edhe sipas intervistave me palët e interesuara nuk janë të shpeshta.

Në vitin 2021, sipas raportit veprat penale kundër mjedisit kanë pësuar një ulje sa i përket procedimeve të regjistruara me 5.14%, ndërsa raporti që këto vepra zënë në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2021 është një masë shumë e vogël prej 1.12%, ndërsa në vitin 2020 ishte 1,19%⁵⁸.

Sa i përket procedimeve në gjykatë ka pasur në vitin 2021 një rritje prej 25% lidhur me veprat penale kundër mjedisit, ndërsa numri i të pandehurve të regjistruar në vitin 2020 është ulur me 8,23%, por nga ana tjetër,

⁵¹ Neni 201- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës

⁵² Neni 201/b - Transportimi i mbetjeve

⁵³ Neni 204- Peshkimi i ndaluar

⁵⁴ Neni 205- Prerja e paligjshme e pyjeve

⁵⁵ Neni 206- Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë

⁵⁶ Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve

⁵⁷ Raporti i Prokurorisë Përgjithshme mbigjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021, mars 2020, fq.143.

⁵⁸ Raporti i Prokurorisë Përgjithshme mbigjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021, mars 2020, fq.141.

është rritur numri i të pandehurve të dërguar në gjykatë me 27,14% dhe çka është më e rëndësishme, është rritur numri i të pandehurve që kanë marrë dënim nga gjykata për kryerjen e veprave penale kundër mjedisit me 38,29% krahasuar me vitin 2020.

Kryesisht të pandehurit e regjistruar për krime penale kundër mjedisit janë meshkuj, me raportin 97,16% meshkuj dhe 2.84% femra⁵⁹. Më shumë se gjysma e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, më saktë 54,61% nuk kanë arsim të mesëm, 43,97% kanë kryer arsimin e mesëm dhe vetëm 1,42% kanë kryer arsimin e lartë. Më shumë se gjysma e tyre janë të papunë dhe gati tre të katërtat e shkelësve të legjislacionit mjedisor jetojnë në fshat, ndërsa sa i përket gjendjes gjyqësore 80,8% e tyre janë të padënuar më parë.

Shpërndarja më e lartë e krimeve kundër mjedisit shënohet në qarkun e Tiranës me 39,12%, pasuar nga Elbasani dhe Lezha⁶⁰, ndërsa në Mat është regjistruar numri më i ulët i krimeve mjedisore, për vitin 2021. Përgjatë këtij viti numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit, ishte në prokuroritë e Krujës dhe Beratit, me 11% të numrit total të procedimeve, në Elbasan me 10% dhe Tiranë me 9%. Mati ishte sërish i fundit në listën e procedimeve për veprat kundër mjedisit, krahas Pukës, Kavajës, Lushnjes dhe Përmetit me më pak se 2% të numrit total të procedimeve penale të regjistruara për këtë grup veprash.

Megjithëse numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër mjedisit, është regjistruar në Tiranë me 12%, koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Kukës me 36 procedime dhe në Gjirokastrë me 26 procedime.

Pesha që zënë veprave penale të ndotjes së ajrit, ujërave dhe tokës në grupin e veprave kundër mjedisit është 7,65% për vitin 2021, ndërsa në 2020 ishte 12,39%, e në 2019 ka qenë 13,53%.

5.2 Mangësitë në kuadrin institucional, aspektin e kapaciteteve, burimeve dhe infrastrukturë

a) Kuadri institucional

- i. Një nga mangësitë e ngritura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është fakti se statistikat lidhur me numrin e çështjeve penale që të cilat janë çuar në gjykatë në 3 vitet e fundit, janë të aksesueshme vetëm me kërkesë zyrtare. Megjithatë raportet vjetore të përgatitura për Kuvendin nga Prokuroria e Përgjithshme mbulojnë një vështrim të përgjithshëm në shifra dhe përqindje të veprave penale dhe kriminalitetit në Shqipëri, duke përfshirë edhe kundër mjedisit.
- ii. Formalisht, bashkëpunimi me organet e sigurisë (polici, prokurori) është i mirë, pasi ekzistojnë disa marrëveshje e programe bashkëpunimi. Megjithatë, roli i organeve të sigurisë shikohet me dyshim pasi hetimet e tyre për që lidhen me pyjet janë të kufizuara. *P.sh., një automjet pa letra që transportonte lëndë drusore i ndaluar nga inspektorët e pyjeve është dënuar nga prokuroria vetëm për transport material drusor pa letra (shkelje administrative), ndërkohë që nuk është thelluar hetimi lidhur më lëndën e prerë (ku e si është prerë, nga kush) dhe dëmin e shkaktuar në fondin pyjor.* Shpeshherë prokuroria mjaftohet me vetëdeklarimet e shkelësve dhe nuk bën hetime të mëtejshme, duke sjellë që shumica e kallëzimeve penale të trajtohen si shkelje administrative.

⁵⁹Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021, mars 2020, fq.142.

⁶⁰Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021, mars 2020, fq.143.

- iii. Një aspekt i rëndësishëm i ndjekjes nga ana e prokurorisë e krimeve kundër mjedisit ka të bëjë me diskrecionin e inspektorit për të bërë një kallzim penal kundër shkelësit, dhe problemi qëndron pikërisht në faktin që inspektorët hezitojnë. Mungon një ndarje e qartë ku shkelja konsiderohet vepër penale nëse kalon një masë të caktuar, e në të kundërt, konsiderohet ende shkelje administrative dhe procedohet në rrugë administrative.
- iv. Mungon një strukturë qendrore e cila të jetë përgjegjëse për adresimin, trajtimin dhe koordinimin e krimeve mjedisore. Një strukturë e tillë mund të ishte një sektor, apo edhe një grup pune brenda Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin ose Policisë së Shtetit, e cila të kishte kompetenca për adresimin e Krimit Mjedisor. Për shkak të mosekzistencës së një strukture të posaçme, mungojnë edhe të dhënat statistikore të elementeve të krimit mjedisor. I vetmi burim informacioni që prodhon statistika është Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme. Megjithatë mungon një raport i vlerësimit të ecurisë dhe gjendjes së Krimit Mjedisor në analogji me Raportin e Gjendjes në Mjedis, i cili prodhohet nga AKM.
- v. Problematikat kryesore të aktiviteteve të paligjshme përqendrohen te prerja e pyjeve, zjarret, gjuetia, peshkimi, aktivitetet turistike. Vitet e fundit shkeljet e investiguara në territorin e zonave të mbrojtura kanë rënë. Kjo edhe për arsye të aktiviteteve të shumta ndërgjegjësuere të ndërmarra nga AdZM në kuadër të programit të edukimit dhe ndërgjegjësimit në shkolla. Po ashtu janë reduktuar edhe rastet e gjuetisë së paligjshme. Rejnxhershats kanë për detyrë të konstatojnë çdo aktivitet të paligjshëm të identifikuar në zonën e tyre dhe më pas në bashkëpunim me specialistin e monitorimit përcaktojnë vlerën e dëmit. Dokumentacioni i përgatitur për këtë qëllim i përcillet IKMT dhe policisë për ndjekje.
- vi. Inspektimet e ADZM-ve (*lëvizjet në teren të rejnxhershave dhe specialistëve të monitorimit*) bëhen në bazë të planeve mujore e vjetore. Planet mujore mundohen të mbulojnë lëvizjen e rejnxhershave në të gjithë zonën e caktuar për ta. Për rastet e kontrollit nga specialistët e monitorimit ngrihet grup pune me urdhër të drejtorit të AdZM, në bazë të të cilin ndiqen probleme specifike. **AdZM-të nuk janë pjesë e inspektimit online.**⁶¹
- vii. Sipas Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, problematika kryesore është sigurimi i pavarësisë së funksioneve. Funkzioni i kontrollit duhet të jetë i pavarur nga funksioni i menaxhimit. Nga ana tjetër, ka një mbivendosje të strukturave të kontrollit dhe inspektimit në pyje. Ligji i pyjeve ngarkon agjencinë kombëtare të pyjeve me funksionet e inspektimit dhe kontrollit të ligjshmërisë, ndërkohë që edhe Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit ka kompetenca për ndjekjen e shkeljeve ligjore në pyje. Kjo praktikë do të sjellë përplasje e mbivendosje të kompetencave midis AKP dhe IMKT për kontrollin e zbatimit të ligjit në pyje (rast i ngjashëm me AKM dhe IKMT për krimet mjedisore). Formatet e dokumenteve të kontrollit janë të miratuara. Plotësimi i dokumentacionit do të bëhet online. Sistemi online për regjistrimin dhe ndjekjen e procesit të inspektimit dhe kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në pyje është mjaft efikas dhe ndihmon shumë në rritjen e shkallës së vjeljes së gjobave. Modelet e përdorura nga ish Inspektorati i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave kanë qenë të mira dhe ekziston përvoja në përdorimin e tyre.
- viii. Në nenin 95 të ligjit nr 111/2012 “ Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar nëpërmjet ligjit nr. 6/2018 përcaktohet se: Inspektoratet, që mbulojnë fushën e mjedisit, shëndetësisë dhe bujqësisë, janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, nën

⁶¹ AdZM-të përgatisin një evidencë mujore të shkeljeve të konstatuara në territorin e zonave të mbrojtura, të cilën e dërgon pranë AKZM cdo muaj.

menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së (si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore). Inspektorati, që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, dhe agjencitë rajonale të mjedisit janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Edhe pse ligji i sipër cituar ka një përcaktim të tillë, prapë inspektimi dhe kontrolli i veprimtarive të jasht-ligjshme në burimet ujore ngelet i paqartë dhe ka mbivendosje të kompetencave. Kjo referuar edhe faktit të shpërbërjes të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyejeve, Ujrave dhe Turizmit në vitin 2020, kompetencat e të cilit janë transferuar midis AKM dhe IKMT.

- ix. Përgjithësisht, ndryshimi i vazhdueshëm i strukturave dhe lëvizjet e pamotivuara të personelit kanë sjellë paqëndrueshmëri institucionale dhe mbivendosje kompetencash. Aktualisht kundërvajtjet mjedisore ndiqen nga një numër institucionesh, brenda dhe jashtë Ministrisë së Mjedisit, përgjegjësia institucionale e të cilave është e paqartë.

b) Kapacitetet

- i. Sa i përket vetë burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, një nga kërkesat e ardhura nga organet e policisë në BE (Europol) është krijimi i një grupi të dedikuar pune për krimet mjedisore. Vitet e fundit janë zhvilluar trajnime me forcat policore, të organizuara nga karabinieria italiane, megjithatë ka nevojë të kryhen trajnime të tilla edhe në nivel inspektorësh mjedisorë.
- ii. Deri tani nuk janë kryer trajnime të mirëfillta lidhur me krimin mjedisor. Është e nevojshme të organizohen trajnime lidhur me krimin mjedisor, kryesisht përsa i përket kuadrit ligjor, procedurave të hetimit dhe kontrollit. Përveç rregullimit të kuadrit ligjor, nevojiten edhe trajnime specifike dhe/ose udhëzues të qartë për zbatimin korrekt të dispozitave ligjore lidhur me kundërvajtjet administrative dhe penale dhe krimet mjedisore.
- iii. Ndër vite, në fushën e pyjeve ka pasur një interes në rritje për trajnime që lidhen me kundërvajtjet mjedisore, kryesisht të mbështetura nga donatorët e huaj. Ka pasur disa raste kur ekspertë të AKP janë thirrur për të trajnuar përfaqësues të organeve të sigurisë lidhur me ligjshmërinë dhe problematikat e krimit në pyje. Por, niveli dhe fusha e arsimimit të personelit pyjor në bashki lë shumë për të dëshiruar. Po ashtu, numri i ulët i personelit sjell një ngarkesë të lartë (sipërfaqe për person) pune për personelin ekzistues, duke e bërë të vështirë kontrollin e gjithë territorit të pyjeve nën juridiksion.
- iv. Sipas Raporti Vjetor për Kuvendin mbi Kriminalitetin 2021, e cila zbaton rekomandimin e Këshillit të Ministrave, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, identifikonte se temat ku vlerësohet se duhet të thellohen njohuritë e tyre, përfshijnë krimin kibernetik, veprat penale në fushën e mjedisit, trafikimi i qenieve njerëzore, dhuna në familje dhe dhuna ndaj gruas, krijimi i grupeve hetimore për hetimet pro aktive dhe skuadrat e përbashkëta hetimore.

c) Infrastruktura/burimet

- i. Niveli aktual i infrastrukturës në institucionet monitoruese/kontrolluese/inspektuese është i ulët, kështu që kapacitetet infrastrukturore janë të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme për të kryer detyrat e tyre përkatëse. Diku infrastruktura është problematike, ndërsa diku mungon plotësisht,

teknologjia mund të jetë e vjetëruar dhe diku ka mungesë të pajisjeve të zyrës. Inspektorët/kontrolloret/monitoruesit duhet të pajisen me pajisje IT (kompjuterë, tablet, etj).

- ii. Një problem i mbartur është (mos) profilizimi i specilistëve të emëruar ose vendosur në pozicione që shpesh nuk kanë lidhje me profilin e punës. Ky fenomen ndikon drejtpërsëdrejti në efikasitetin e punës lidhur me parandalimin, identifikimin dhe hetimin e krimeve kundër mjedisit. Duhet vullnet politik për të ndryshuar strukturat ekzistuese e shtuar numrin e personelit në dispozicion të kontrollit e zbatimit të ligjshmërisë.
- iii. AKP po bashkëpunon më Inspektoratin Qëndror Shtetëror (institucion përgjegjës për hartimin dhe unifikimin e procedurave të inspektimit) për të përmbyllur përcaktimin e procedurave të kontrollit dhe inspektimit, në zbatim të përcaktimeve të ligjit për inspektimin.⁶² Referuar intervistës me përfaqësues të AKP, parashikohet që AKP të ngrejë një strukturë, e cila do të kryejë inspektime të programuara për zbatimin e ligjshmërisë nga Bashkitë dhe AKZM, si dhe subjektet private që operojnë në pyje. Ndërkohë që mund të ketë edhe inspektime të inicuar nga denoncimet e palëve të treta (përfshirë qytetarët). Kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë nga organet e qeverisjes vendore do të realizohet me programe të miratuara nga AKP duke marrë parasysh problematikat specifike dhe nivelin e riskut. AKP po bashkëpunon me bashkitë për ngritjen e strukturave të kontrollit dhe inspektimit në bashki, të cilat shpresohet të ngrihen deri në fund të vitit. Ndërkohë që sipas ligjit të pyjeve, veprat penale i referohen strukturave të sigurisë (polici, prokurori) për hetim dhe ndjekje.
- iv. AKP ka një bashkëpunim të mirë me njësitë e qeverisjes vendore dhe me AKZM. Sidoqoftë vërehet një vëmendje e ulët nga bashkitë në ndjekjen e shkeljeve ligjore në fushën e pyjeve. Edhe numri i kallëzimeve penale nga bashkitë është tepër i ulët. Megjithatë, jo të gjitha bashkitë janë njëjloj, ka edhe bashki që punojnë më seriozisht për çështjet e pyjeve (p.sh., Bashkia Shkodër). Përgjithësisht kapacitetet njerëzore të bashkisë janë të kufizuara si në numër edhe në aftësi/njohuri specifike lidhur me shkeljet mjedisore. Bashkia nuk ka personel të aftë për inspektimin dhe ndjekjen e problemeve komplekse si ndota e ajrit, ujat apo tokës. Në shumicën e rasteve ka mungesë në mjete lëvizëse për sektorin e pyjeve dhe mjedisit. Është e nevojshme të plotësohet inventari i pajisjeve të nevojshme IT (kompjuterë, printera) si dhe pajisje për matjen e pyjeve. Inspektorët e bashkisë nuk kanë uniforma apo mjete të tjera dalluese.
- v. Për veprat penale në pyje duhet anagzim më i madh i organeve të sigurisë (polici, prokurori). Eksperiencat e dikurshme e oficerave të policisë gjyqësore pranë Drejtorive të Shërbimit Pyjor ka qenë mjaft pozitive në lehësimin e bashkëpunimit me organet e prokurorisë dhe rriste ndjeshëm edhe shkallën e përgatitjes dhe ndjeshmërisë ndaj shkeljeve në pyje.

5.3 Bashkëpunimi, mbivendosja, duplikimi i rolit dhe qartësim i kompetencave

- i. Sa i përket bashkëpunimit midis policisë, prokurorisë, gjykatave, institucioneve dhe agjencive të administratës publike në kuadër të luftës kundër krimit mjedisor, ai është i vazhdueshëm, megjithatë sipas përfundimeve të arritura nga intervistat e zhvilluara me palët e interesuara, nuk ka një përcaktim shumë të qartë në ligj ose në praktikë se cila nga institucionet duhet të veprojë në momente të caktuara. Megjithatë në vlerësimin e ekspertëve, përderisa, legjislativi në fuqi për mbrojtjen e mjedisit (ajrit, tokë, ujrat etj.) ngarkon organet administrative për evidentimin dhe përcaktimin e llojit të shkeljes, vlerësimin e dëmit/ndotjes, caktimin e masave administrative ndaj

⁶² Ligji Nr.10 433, datë 16.6.2011 PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

kundërvajtësve administrativ, kallëzimin në prokurori kur vlerësohet se është vepër penale, kuptohet që janë këto organe që duhet të veprojnë fillimisht. Ushtrimi i ndjekjes penale nga prokuroria kryhet për ato shkelje të ligjit të cilat nuk parashikohen si kundërvajtje administrative.

- ii. Mekanizmat e vendosur për të inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet strukturave shtetërore që kanë funksione inspektuese dhe hetuese ende mungojnë. Të vetmet mekanizma që ekzistojnë janë: detyrimi i kryepleqve të fshatrave të bëjnë raportime për shkelje të ndryshme që ndodhin në territor.
- iii. Shpesh ka mbivendosje të përgjegjësive dhe dyfishim të punës, ndërsa ndërveprimi ndërinstitucional nuk është i rregullt dhe efektiv (në lidhje me inspektimin e pyjeve, ujit dhe ndotjes nga industria), si në rastin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Kombëtar të Menaxhimit të Territorit dhe degëve rajonale të tyre. Si rrjedhojë institucionet e tjera, sikurse është AKZM/AdZM dhe AMBU/ZABU, kanë vështirësi në identifikimin e institucionit të cilit duhet ti drejtohen në rastin e evidentimit të një krimi mjedisor në terren, duke qenë se edhe AKZM/AdZM edhe AMBU/ZABU kanë staf në terren për monitorim dhe kontroll.
- iv. Procesi i bashkëpunimit me IKMT paraqitet i kufizuar, pasi përgjithësisht nuk ka informacion mbi ecurinë e proceseve të iniciuara, të cilat janë siguruar përmes kërkimit dhe inspektimit të AKZM/AdZM, AMBU/ZABU apo edhe nga AKM/ARM (struktura inspektuese). Ndonjëherë IKMT nuk pranon rastet e referuara për shkak të ristrukturimit të përgjithshëm dhe kompetencave të paqarta, si një nga arsytet që ekspertët kanë identifikuar. IKMT ka mungesa të theksuara personeli, kryesisht në strukturat rajonale, çjka bën pothuajse të pamundur ndjekjen e të gjitha rasteve të referuara nga agjencitë e tjera inspektuese. Ndërkohë AdZM-të kanë marrëveshje bashkëpunimi me policinë, bashkëpunimi me të cilën ka shënuar rritje ndër vite.
- v. AKZM/AdZM si dhe AMBU/ZBU nuk janë pjesë e inspektimit online. AKZM/AdZM-të nuk kanë bashkëpunim të konsoliduar me AKM/ARM, për ndjekjen e shkeljeve specifike mjedisore (ndotje e ajrit, ujit, tokës, hedhje e mbeturinave, etj). AdZM nuk ka ndonjë bashkëpunim specifik me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP) për shkeljet në fondin pyjor.
- vi. Sipas specialistëve të AdZM, gjykata nuk e konsideron prerjen e pyjeve si vepër penale dhe përgjithësisht autorët lirohen pa u dënuar. Nevojitet një bashkëpunim më i ngushtë me organet gjyqësore dhe rritje e ndërgjegjësimit dhe informimit të tyre për rëndësinë e ndjekjes së duhur të krimeve mjedisore.
- vii. Specialistët e AdZM apo edhe AMBU/ZABU nuk janë thirrur ndonjëherë nga gjykata në rolin e ekspertit për çështje që lidhen me krimin mjedisor. P.sh. AMBU konfirmon se asnjë monitorues nuk është thirrur për të dëshmuar në procese gjyqësore. Gjyqësori ka konstatimet me foto dhe procesverbal monitorimi që mbahen nga monitoruesit e AMBU/ZABU. Nga ana tjetër, IKMT-ja dhe ARM-ja si institucionet përgjegjëse për marrjen e masave nuk i kanë proceduar kundërvajtësit. E njëjta gjë vlen edhe për AKM. Nuk ka pasur raste të thirrjes së AKP si ekspertë në proceset gjyqësore që lidhen me pyjet, ndërkohë që strukturat e bashkisë janë thirrur disa herë.
- viii. Bashkëpunimi me policinë dhe prokurorinë është i mirë. P.sh., së fundmi, ARM Fier është përfshirë në një grup pune të përbashkët për hetimin e krimeve mjedisore. Specialistët/inspektorët e ARM-ve janë thirrur nga policia për verifikimin e rasteve të shkeljeve mjedisore. Po ashtu, inspektorët thirren në gjykatë për të mbrojtur vlerësimet/ konstatimet e rasteve të inspektuara.

- ix. Nga prokurorët vërehet se hartimi i proces-verbaleve për identifikimin e kundërvajtjeve mjedisore, të cilat më pas i referohen Prokurorisë për ndjekje penale, janë jo të plota dhe me mangësi të theksuara që pengojnë ndjekjen, procedimin dhe gjykimin e duhur të kundërvajtjes mjedisore nga ana e prokurorisë.

5.1.1. Informimi, OJQ-të dhe media

- i. Nga takimet e zhvilluara me gazetarët, të cilët kanë trajtuar problematikat mjedisore konstatohet se ka një mungesë të incentivave nga ana e redaksive kundrejt tyre për të mbuluar emisione dhe shkrime që lidhen me problematikat mjedisore, duke i konsideruar ato si të parëndësishme, nëse nuk lidhen me elementë të tjerë të kundërvajtjeve ose krimeve si korrupsioni, mashtrimi, abuzimi me detyrën etj.
- ii. Mungesa e kanaleve efektive të shkëmbimit të informacionit mes autoriteteve publike dhe medias. Shpesh informacioni nuk jepet në kohë dhe media duhet të ndjekë ciklin e gjatë përmes Komisionerit për të Drejtën e Informimit për të siguruar informacion që lidhet me çështjet e mjedisit. Gjithashtu ata shprehen se mungon bashkëpunimi në formë sistematike i medias me aktorët dhe institucionet relevante që punojnë në fushën e mjedisit në tërësi, dhe në atë të Krimin Mjedisor specifikisht.
- iii. Mbulimi i çështjeve mjedisore shpeshherë tejkalon lajmin e ditës dhe si i tillë, kërkon më shumë kohë dhe burime financiare për t'u mbuluar e pasqyruar në mënyrën e duhur. Kjo është në shumicën rasteve e pamundur t'iu ofrohet gazetarëve nga mediat ku ata punojnë për shkak të qasjes së natyrës së "lajmit të ditës" që mediat në Shqipëri kanë në përgjithësi.
- iv. E lidhur ngushtësisht me këtë është edhe fakti se çështjet mjedisore dhe specifikisht kundër mjedisit kërkojnë që gazetarët të kenë njohuri të mira dhe aftësi të identifikojnë dhe investigojnë në mënyrë korrekte krimin mjedisor. Ndërkohë që redaksitë nuk ofrojnë mjedis mundësues për zhvillimin e trajnimeve që do të mundësonin aftësimin e tyre në këtë drejtim.
- v. Krijimi i një hapësire mediatike, në rastin më të mirë të një redaksie të dedikuar fushës së mjedisit, më gazetarë profesionistë të trajnuar mbi menaxhimin mjedisor, krimin mjedisor dhe elemente të tjerë të së drejtës mjedisore do të përbënte një hap të rëndësishëm më tej jo vetëm të kontributit të medias në adresimin e çështjeve të mjedisit por edhe në konsolidimin dhe specializimin e vetë sektorit të medias në këtë drejtim.
- vi. Mediat duhet të raportojnë më shumë për problemet mjedisore. Nga ana tjetër duhet punuar më shumë për ndërgjegjësimin e publikut për dëmin që shkaktojnë mjedisore. Kjo do të kontribuojë gjithashtu në ndërgjegjësimin e qytetarëve që të raportojnë krimet mjedisore pranë institucioneve përkatëse ose medias. Po ashtu është e nevojshme të theksohet dhe promovohet roli i institucioneve të specializuara si ARM.



6 Përfundime dhe rekomandimet



6. Përfundime dhe rekomandime

Ratifikimi i shpejtë i marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore tregon rëndësinë politike që Shqipëria i kushton bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet mjedisore. Megjithatë edhe pse ekzistojnë disa strategji specifike për çështjet për mjedisin, “Shqipëria nuk ka një kuadër të politikave ombrellë vizionare për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, ka ende një mungesë serioze të ndërgjegjësimit dhe njohurive, nga të gjithë aktorët përkatës dhe publiku i gjerë lidhur me krimet kundër mjedisit.

Vendi ka avancuar ndjeshëm në adoptimin dhe miratimin e legjislacionit mjedisor si proces i përafrimit me legjislacionin Evropian. Por, siç është vërejtur dhe nga analiza ligjore shumë prej akteve nënligjore mungojnë akoma, dhe disa të tjera ekzistuese nuk zbatohen. Shumë akte ligjore nuk kanë një praktike të hartimit të raporteve të zbatimit të tyre.

Shpesh është vërejtur gjatë intervistave që legjislacioni është shumë i avancuar për kapacitetet administrative, financiare dhe institucionale. Kjo vihet re dhe në mungesën e progresit lidhur me fushën e përgjegjësisë mjedisore, inspektimit mjedisor dhe kimit mjedisor.

Raporti i pre-screening hartuar nga projekti SANE 27, tregon qartë avancimin në fushën e adoptimit të legjislacionit dhe faktin se shumë nga sektorët e tjerë janë në fazën e hershme të zbatimit ose nuk ka avancim.⁶³

Progres Raporti i BE “Për Shqipërinë në 2022”⁶⁴ evidentoi një rritje në hetimin e krimeve mjedisore, duke theksuar gjithsesi nevojën për më shumë vëmendje në mbrojtje të mjedisit sidomos gjatë miratimit të investimeve private dhe në mbrojtjen e zonave me habitate të specieve të veçanta.

Gjatë 2021-2022, shumica e hetimeve u hapën për shkeljet sipas nenit 205 të Kodit Penal për “ Prerjen e paligjshme të pyjeve”, e ndjekur nga neni 201 “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës”, si dhe në vijim për shkelje që përfshihen në nenin 202, pika b) “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”. Po ashtu, ndjekje penale u zhvilluan gjatë vitit 2021- 2022 edhe ndaj shkeljeve të përcaktuara në : nenin 206, pika a) “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”, nenin 206 “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë” dhe nenin 204 “Peshkimi i ndaluar”.

Megjithëse dënimi më i kërkuar nga prokurori është ai me burgim, në 66.66% të rasteve të procedimit penal për krime kundër mjedisit, shpesh është kërkuar pezullimi i dënimit dhe vendosja në prove, ndërsa gjykata ka pranuar këtë kërkesë për mbi 70% të rasteve.

Nisur nga shqyrtimi i veprave penale më të shpeshta ndaj mjedisit, një trend në rënië vërehet përsa i takon procedimeve të këtyre veprave krahasuar një vit më parë, me një rënië prej 20% të “prerjeve të paligjshme” në vitin 2021. Ndërkaq, sipas Raportit Vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme, janë ulur në numër edhe procedimet për vepra të tilla si “Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës” dhe “dëmtimi i habitateve në Zonat e Mbrojtura mjedisore”.

Një tjetër mangësi që vërehet në shqyrtimin e procedimeve të regjistruar për veprat më të shpeshta kundër mjedisit, është se ka pasur tendencë në ulje për procedimin e veprave të tilla, ku në rastin e “Prerjes së paligjshme të pyjeve” kjo ulje ishte me 20% në 2021, krahasuar me vitin paraardhës. Po ashtu procedimet e regjistruara për veprat si “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës” apo “Dëmtimi i habitateve në zonat e

⁶³ SANE27

⁶⁴ https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/key-findings-2022-report-albania_en?s=214

mbrojtura mjedisore” kanë pësuar ulje, referuar Raportit vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme. Ky nuk është aspak tregues pozitiv sa i përket ndëshkueshmërisë së veprave penale kundër mjedisit.

Nga ana tjetër, numri i madh i ligjeve dhe akteve administrative në kuadrin ligjor mjedisor shqiptar e bën sfidues dhe të vështirë për aktorët e zinxhirit të forcimit të ligjit siç janë (*Policia, Prokuroria dhe Gjykatat*) për të përcaktuar se cili ligj specifik apo akt duhet të aplikohet në raste të veçanta.⁶⁵

Edhe pse janë zbatuar një sërë projektesh dhe nismash në fushën e inspektimit, lejeve dhe hetimit mjedisor (*SELEA IBECA, ECRAN, SANE27*), duke pasur parasysh prioritetin e ulët që i jepet krimit mjedisor në përgjithësi, dhe mungesën e vazhdueshme të ndërgjegjësimit të autoriteteve (si dhe publikut të gjerë), trajnime të mëtejshme dhe trajnime të përsëritura për të gjithë aktorët në zinxhirin e inspektimit dhe zbatimit duhet të rrisin ndërgjegjësimin për natyrën e krimit mjedisor, ndikimin përkatës dhe dinamikën e tij.

Ndërsa në lidhje me inspektimin mjedisor, shumë institucione përgjegjëse kanë paqartësi të kompetencave në aspekte të ndryshme të inspektimit siç janë pyjet (IKMT, AKP, Bashkitë) ndërsa të tjera nuk e ushtrojnë të drejtën ligjore për shkak të akteve sekondare (AKZM).

Në këtë kontekst, Inspektorët e mjedisti në radhë të parë dhe më pas prokurorët dhe oficerët e policisë do të duhet të asistohen me trajnime se si të **provojnë lidhjen shkakësore midis krimit** të tillë si ndotja e ajrit, ndotja e ujit ose shkatërrimi i pyjeve dhe pasojave të rënda të shkaktuara në shëndetin ose jetën e njerëzve (paragrafi 2 i neneve 201 dhe 203, dhe paragrafin 3 të nenit 206/a).⁶⁶

Një temë tjetër për prokurorinë është dhe kuantifikimi i dëmit mjedisor shkaktuar nga ndotja e mjedisit, siç mund të jetë ajri dhe uji, me qëllim zbatimin e parimit “ndotësi-paguan” dhe kërkesës për pagimin e dëmit. Në fakt kjo detyrë nuk është e prokurorisë por e institucioneve dhe inspektorateve të cilat duhet ta vënë këtë informacion në dispozicion të prokurorisë, por praktika tregon se Prokuroria kërkon analiza teknike ndërsa përgjigjet vijnë me shume vonese ose madje nuk vijnë fare për mungesë të aparaturave matëse. Prokuroria automatikisht pamundësohet të kryejë punën e saj për shkak të mangesive në ingranazhin e identifikimit dhe matjes së dëmit mjedisor.

Nga ana tjetër, mungon edhe një rregullim ligjor i drejtpërdrejtë dhe i qartë lidhur me vijën ndarëse midis shkeljes administrative dhe vepër penale. Këtë vijë ndarëse e përbën dëmi i shkaktuar dhe masa e këtij dëmi. Në kontekstin e dëmit, sipas rastit kufiri i normave të lejuara apo vlera dhe lloji i dëmit të shkaktuar, dallimi, midis shkeljes administrative dhe asaj penale, ose anga ana tjetër lloji i sjelljes/ veprimit apo mosveprimit i cili parashikohet si shkelje vetëm në njërin nga ligjet, administrative ose atë penale, si rrjedhojë ka ndarje midis dënimit adm dhe atij penal.

Prandaj është e nevojshme që analizë e thellë sidomos e dispozitave administrative të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme për të verifikuar nivelin apo vlerat sasiore dhe cilësore të ndotjes/dëmtimit të mjedisit për të cilat shkelësit e ligjit mbajnë përgjegjësi administrative me qëllim për të bërë dallimin me ato të parashikuara në Kodin Penal. Sigurisht këtu nuk bëhet fjalë për dëmin e shkaktuar në jetën dhe shëndetin e njerëzve e cila parashikohet vetëm në Kodin Penal, për për dëmin e komponentëve të mjedisit.

Duke mos patur një panoramë të qartë të parashikimeve mbi shkeljet dhe përgjegjësinë/saksionet e legjislacionit administrativ në fushën e mjedisit, nuk mund të konkludohet për parashikimin nga legjislatori të përgjegjësinë dyfishe (administrative dhe penale) për shkeljet e kryera në fushën e mjedisit.

Në një aspekt tjetër, megjithëse përgjegjësia e personave juridikë përcaktohet në ligj të posaçëm (*ligjin nr.9754, datë 14.6.2007* “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”) ndëshkimet e këtyre të fundit në fushën e krimit mjedisor nuk duken efektive apo proporcionale, pasi maksimumi i gjobës për personat

⁶⁵ Diskutimi i gjatë nëse është shkelje administrative apo penale dhe masës së dënimit.

⁶⁶ Intervistat me Prokurorinë dhe Drejtorinë e Policisë

juridikë është më i ulët se gjoba maksimale për individët që kryejnë të njëjtën kundërvajtje. Kjo ndodh sepse përcaktimi i dënimit bëhet rast pas rasti dhe ndarja midis kundërvajtjes administrative dhe asaj penale mbetet në diskrecion të organeve përgjegjëse për identifikimin dhe ndëshkimin e veprave të paligjshme kundër mjedisit.

Përtej ambiguitetit ligjor, një problem praktik lidhet me strukturat zbatuese të administratës shtetërore, kryesisht strukturat inspektruese kontrolluese të cilat kanë për detyrë të bëjnë kallëzimin penal tek strukturat e zbatimit të ligjit, por këto kallëzime mungojnë, ndoshta për shkak të mungesës së një qartësie ligjore të mirëfilltë që buron nga Kodi Penal dhe që në mënyrë kapilare shtrihet në legjislacionin e posaçëm. **Pyetja që ngrihet është cilat janë normat që duhen zbatuar dhe si duhen zbatuar? Rekomandimi më i rëndësishëm në këtë drejtim do të ishte hartimi i një udhëzuesi që të përcaktojë qartë nivelin e zbatimit të Kodit Penal, dhe sidomos cilat ligje të posaçme duhen shqyrtuar dhe zbatuar kur Kodi referon tek legjislacioni i posaçëm.** Për shembull, Kodi Penal përdor terma përgjithësuese si psh. “*përtej normave të lejuara*, kur kërkon përcaktimin e ndotjes në mjedis, duke referuar që këto norma duhet të jenë diku të rregulluara apo përcaktuara në legjislacionin e posaçëm primar ose sekondar. Më përgjithësisht, sa herë që nenet e Kodit Penal referojnë në legjislacionin e posaçëm, lind nevoja e qartësisht të këtyre referencave nëpërmjet një analize të mirëfilltë ligjore duke përgatitur një udhëzues që eventualisht do të tregojë në mënyrë të thjeshtë dhe gjithëpërfshirëse autoriteteve shtetërore cili është neni i legjislacionit të posaçëm që Kodi Penal indirekt referon.

Kjo analizë është e nevojshme edhe duke parë referencat e kryqëzuyara (administrative dhe penale) nga ana e legjislacionit të posaçëm që shpesh në dispozitat e ndëshkimeve administrative përdor, shprehjen “kur nuk përbën vepër penale, është shkelje administrative”. Kjo shprehje në vetvete nuk tregon ndarjen jo të qartë të këtyre përgjegjësive, pasi ndarja bëhet sikurse jemi shprehur më sipër duke lexuar në harmoni ligjin e posaçëm dhe Kodin Penal.

Problemi i kësaj shprehje qëndron se bie në kundërshtim me atë çfarë vetë gjithë legjislacioni administrativ ka parashikuar në tërësinë e tij, duke përcaktuar në mënyrë të tillë që të parët që duhet të vendosin mbi përgjegjësinë e shkelësit të ligjit administrativ janë organet administrative që e konstatojnë këtë shkelje dhe që bëjnë vlerësimin e ndotjes/dëmit të shkaktuar nga shkelësi. Nëse vlera e dëmit dhe lloji i shkeljes nuk parashikohet nga dispozitat administrative të cilat parashikojnë kundërvajtjet administrative, por parashikohet nga Kodi Penal, atëherë ata janë të detyruar të bëjnë kallëzim pra paraqesin rastin në prokurori, sikurse i detyron vetë ky legjislacioni administrativ. Sigurisht kjo e fundit bëhet me bashkëpunimin dhe ndihmën e juristëve të emëruar në këto organe ose me bashkëpunimin e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit të cilët e referojnë rastin në prokurori.

Kalimi i rasteve direk në prokurori do të sillte një angazhim, në kohë dhe kosto financiare për taksapaguesit shqiptar, zvarritje dhe mungesë eficence në veprimtarinë e organeve ligjzbatuese për të goditur në kohë shkelësit e ligjit. Qëllimi i legjislacionit është parandalimi, pastaj ndëshkimi administrativ dhe pastaj ai penal. Duhet patur parasysh parimi i veprimit në kohë të ligjit, kjo edhe sipas procedurave administrative dhe atyre penale. Prandaj Udhëzuesi që eventualisht do të tregojë në mënyrë të thjeshtë dhe gjithëpërfshirëse autoriteteve shtetërore cili është neni i legjislacionit të posaçëm dhe/ose i Kodi Penal i zbatueshëm është mëse i nevojshëm.

6.1. Propozime për përmirësimin e kuadrit ligjor

- a. Teksa Këshilli i Europës përgatitet të ndryshojë sërish Direktivën kuadër për krimin mjedisor, ku sipas kërkesës nga Komisionit, duhet të përfshihen në legjislacionin europian lloje të reja veprash penale kundër mjedisit, **sugjerohet të harmonizohen këto ndryshime** në ligjin shqiptar. Në varësi

të ndryshimeve të Direktivës, mund të lindë nevoja e rishikimit të veprave penale në mjedis në Kodin Penal, nëse ndryshimet e Direktivës do ta sugjerojnë këtë. Në këtë mënyrë, mund të rekomandohet të amendohen sërish krimet kundër mjedisit të parashikuara në Kodin Penal dhe sanksionet përkatëse duke i harmonizuar ato me risitë (nëse do të ketë të tilla) që mund të sjellë Direktiva.

- b. Rekomandohet të përcaktohet shumë qartë dallimi ndërmjet shkeljeve administrative dhe atyre penale për të mos lënë asnjë hapësirë për zbatim të ndryshëm në situata të ngjashme. Shembull merret Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”. Rekomandohet rishikimi i nenit 36 i këtij ligji, i cili në disa pika të tij ka ndikuar negativisht në strukturën e kriminalizimit të dëmeve mjedisore dhe pasojave nga shkeljet mjedisore në pyje. Konkretisht, pika 8 e nenit 36 ka prishur strukturën e kriminalizimit sepse shkelje të tilla si: shkarkimet e kimikateve, të ujërave të ndotura industriale në fondin pyjor kombëtar; gërmimi për karriera të çdo lloji që përdorin lëndë plasëse pa lejen përkatëse; djegia e sipërfaqeve në fondin pyjor kombëtar, dënohen me gjobë, ndërkohë që Kodi Penal penal veprimet të tilla i kategorizon minimalisht si kundërvajtje penale. Po ashtu, ky nen e konsideron djegien e pyjeve si kundërvajtje administrative, megjithëse kjo shkelje/vepër është vepër penale e mirëfilltë, duke u mbivendosur madje duke rënë në kundërshtim flagrant me dispozitat e Kodit Penal. Pika 9 e nenit 36 të ligjit për pyjet, bie po ashtu në kundërshtim me Kodin Penal, sepse thekson se kur pasojat janë të rënda aplikohet ndëshkim administrativ me gjobë, ndërkohë që pasojat e rënda i bëjnë automatikisht këto shkelje mjedisore krime mjedisore të mirëfillta dhe si rrjedhojë të dënueshme nga Kodi Penal.
- c. Rekomandohet përmirësimi i dispozitave të ligjeve të posacme administrative dhe atij penal, për të qartësuar pa ekuivoke llojin, tipin e shkeljes dhe vlerën apo kufirin e nivelit të ndotjes apo dëmit të mjedisit, për cila shkelësit duhet të mbajnë përgjegjësi administrative dhe atyre që duhet të mbajnë përgjegjësi, për të garantuar efikasitet më të lartë në sanksionimin e shkelësve.
- d. Në mënyrë që të adresohen të gjitha ndryshimet ligjore dhe kërkesat sipas acquis të BE-së, duhet të hartohet **një plan strategjik kundër krimit mjedisor**, i cili mund të përcaktoj përgjegjësitë e institucioneve, burimet e duhura financiare për të bërë të mundur këto ndryshime dhe roli që duhet të luajnë institucionet. Plani strategjik duhet të parashikojë forcimin e agjencive mbi krimet mjedisore, ose përcaktimin e një institucioni referues për krimet të tilla.
- e. Rekomandohet të **përcaktohet shumë qartë dallimi ndërmjet kompetencave administrative dhe atyre penale** për të mos lënë asnjë hapësirë për zbatim të ndryshëm në situata të ngjashme. Shembull mund të jetë Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, i cili tashmë përmban përcaktime të qarta për detyrat e inspektorëve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve në nenin 35 dhe bashkërendimin e punës me policinë bashkiake apo instanca të tjera përgjegjëse për ndëshkimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve administrative.
- f. Duke marrë parasysh se ndarja midis dënimit të personit që kryen një vepër kundër mjedisit nuk është e përcaktuar në një ligj të qartë, siç është rasti i neni 29 në ligjin “Për lejet e mjedisit” **rekomandojmë që të miratohet një akt i veçantë, në mënyrë të përbashkët midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit**, për të përcaktuar një ndarje midis asaj që përbën kundërvajtje administrative dhe veprës penale kundër mjedisit, për të garantuar efikasitet më të lartë në dënimin e personave juridikë që shkaktojnë ndotje të përsëritur të mjedisit, edhe në zbatim të parimit “ndotësi paguan”.

- g. Duke pasqyruar rekomandimet nga Progres-raportet e BE-së, sugjerojmë përafrimin e legjislacionit për cilësinë e ajrit me ligjet e BE-së dhe ngritjen e një sistemi funksional për monitorimin e kësaj të fundit.
- a. **Rekomandohet të hartohen udhëzime për krimin mjedisor** për rolet përkatëse: Inspektorë, Oficerët Policisë Gjyqësore, Policia e Shtetit, Prokurorë, Gjyqtarë.
- b. Ndërkohë, Kodi Penal ka nevojë për saktësim, qartësim dhe harmonizim me ligjet e posaçme në drejtim të saktësimin dhe mirëkategorizimit të veprës penale. Si shembull konkret sjellim nenin 201/c të Kodit Penal në të cilin duhet qartësuar gjuha e togëfjalëshit: *ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda...* Përdorimi i termit *ka mundësi*, në kontekstin e dëmit mjedisor nuk duket i legjitimuar pasi dëmi, fjala vjen në ajër, ose shkaktohet ose nuk shkaktohet. Si koncept juridik, togfjalësi "*ka mundësi*" barazohet me kuptimin e tentativës së veprës penale, por tentativa nuk ekziston si institut ligjor në veprat penale kundër mjedisit. Po ashtu, neni 205 i Kodit Penal i cili përcakton se "Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit" tanimë duket i pazbatueshëm, sepse shkeljet mjedisore dhe dëmtimet e pyjeve të çfarëdo lloji janë listuar të gjitha si kundërvajtje administrative në kuptim të ligjit për pyjet, duke e bërë këtë dispozitë të Kodit Penal jo efektive dhe të pazbatueshme siç u shpjegua më sipër.

6.2 Rekomandime për forcimin e kuadrit institucional, kapaciteve, burimeve dhe infrastrukturës

- c. Rekomandohet që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme **të ri-aktivizojnë/ri-strukturojnë nisma të mëparshme si përshembull Grupin Ndërinstitucional kundër Krimin Mjedisor**. Ky grupim duhet të ketë përfaqësim të lartë në nivel drejtuesish dhe nivel operacional në mënyrë që të jetë plotësisht funksional, dhe të kontribuojë në zbatimin e legjislacionit në fuqi për krimin mjedisor dhe për bashkëpunimin midis institucioneve.
- d. Është mëse e nevojshme të **zhvillohen trajnime me strukturat policore në rrethe dhe në qendër**, lidhur me identifikimin, ndjekjen dhe procedimin e krimeve mjedisore. Trajnimet duhet të kryhen përmes **Akademisë së Sigurisë** duke marrë shembuj dhe nga trajnimet e kryera nga karabinieria italiane në këtë drejtim.
- e. Shërbimi doganor shqiptar është i limituar në kapacitete dhe njohuri për trajtimin e krimit mjedisor me efekt ndërkufitar. Për këtë arsye punonjësit e shërbimit doganor kanë nevojë për më shumë trajnime dhe shkëmbim informacioni e njohurish me institucionet akademike dhe OJF-të e specializuara për të adresuar më mirë aspekte të krimit mjedisor që lidhen me trafikimin e specieve, trafikun e lëndëve të rrezikshme etj.
- f. Rekomandohet, **publikimi dhe promovimi i rezultateve të punës së prokurorive pranë gjykatave të rrethit (përveç raporteve vjetore të Prokurorisë së përgjithshme)** dhe gjykatave në procedimin e krimeve kundër mjedisit, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve por edhe të publikut të gjerë mbi gamën e krimeve mjedisore. Në këtë aspekt, mund të zhvillohet një sistem gjurmimi i të dhënave dhe rasteve për krimet mjedisore. Ky sistem gjurmimi do të ndihmonte, se në çfarë statusi ndodhen çështje të caktuara, si janë gjykuar duke rritur transparencën.

- g. **Shkolla e Magjistraturës do të duhej të rishikonte kurrikulat ekzistuese dhe në prezantimin e një programi trajnimesh sa i përket krimit mjedisor** për prokurorët dhe magjistratët e rinj dhe ata në detyrë. E njëjta situatë duhet të ndodh nga Akademia e Sigurisë, në përgatitjen e trajnimeve për anëtarët e saj në mënyrë që të bëhet më e lehtë vënia në zbatim e legjislacionit mjedisor.
- h. Nevojitet një punë më e madhe **për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi përgjegjësinë** individuale në raportimin e krimit mjedisor. Duhet të promovohen më shumë mënyrat e thjeshta të komunikimit me organet e policisë, si raportimi përmes numrit të dedikuar 112 dhe Komisarariatit Digjital.
- i. Roli dhe **mandati i inspektorateve mjedisore** (*tashmë të shpërndara në AKM, IKMT dhe AKP*) **duhet të përcaktohet qartë**, duke pasur parasysh se nga pikëpamja institucionale strukturat e Inspektoratit duhet të kenë në themel sistemin e sigurimit të përputhshmërisë. Duhet të ndiqet një qasje që kombinon stafin, ekspertizën, aftësitë dhe pajisjet e disponueshme për të rritur kapacitetet e AKM-së, IKMT-së dhe AKP-së.
- j. Rritja e efektivitetit të inspektimit mund të arrihej përmes **unifikimit të të strukturave inspektuese** brenda një institucioni të profilizuar dhe me kapacitete teknike të mjaftueshme në fushën e mjedisit dhe specifisht në fushën e Krimit Mjedisor. Mund të rishqyrtohet ideja e ribashkimit të të gjitha funksioneve inspektuese mjedisore në një inspektorat të vetëm (i ngjashëm me ISHMPU), i cili të mbështetet me kapacitetet e duhura njerëzore dhe infrastrukturore për mbulimin e gjithë territorit. Inspektorati Shtetëror Qendror duhet të luajë më mirë rolin e tij koordinues dhe mbikqyrës të standardeve e procedurave të inspektimit.
- k. Në çdo rast është e rëndësishme që OPGJ-te të jenë pjesë e strukturave inspektuese, dhe secili nga inspektoriatet të ketë në strukturën e tyre OPGJ-të. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e procesit të hartimit të proces verbale-ve të paraqitura në prokurori.
- l. Lufta ndaj krimeve mjedisore kërkon **staf të trajnuar dhe burime njerëzore në çdo institucion ekzistues**. Të gjitha këto institucione të ristrukturuara rishtazi duhet të marrin trajnime specifike për krimin mjedisor. Është shumë e rëndësishme që institucionet përkatëse si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Kombëtar i Menaxhimit të Territorit, të kenë trajnimin dhe pajisjet përkatëse për të matur normat e ndotjes së subjektit që emetojnë në ajër, ujë apo tokë në përputhje me ligjin. nr 10433 datë 16.06.2011 për “Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”. E njëjta gjë vlen edhe për prokurorinë, së cilës i mungon ekspertiza përkatëse për të paraqitur fakte të bazuara para gjykatës.
- m. Rekomandohet **plotësimi i strukturave institucionale me personel të mjaftueshëm** e të kualifikuar sipas standardeve të pranuar të ngarkesës me punë. Për të gjitha institucionet e përfshira, rekomandohet rishikimi/përditësimi i planeve/progrmeve të forcimit institucional dhe zbatimi rigoroz i rekomandimeve të dhëna në këto plane. Duhet identifikuar, forcuar dhe zbatuar mekanizmat e nevojshëm për të evituar emërime jashtë profileve të vendit të punës.
- n. Përveç rregullimit të kuadrit ligjor, **rekomandohet** unifikimi i dokumentacionit që duhet të mbajnë organet administrative dhe formatizimi i tyre, ku të gjejnë pasqyrim lloji i shkeljes, niveli i dëmit etj. si elementë të nevojshme dhe të domosdoshme të ligjit apo akteve nënligjore.

- o. **Mediat duhet të kryejnë raportim sistematik** për problemet mjedisore. Nga ana tjetër duhet punuar më shumë për edukimin dhe **ndërgjegjësimin e publikut** për dëmin që shkaktojnë krimet mjedisore.
- p. **Inventari i mjeteve** në dispozicion të inspektorateve mjedisore (*makina, motora, skafe*) duhet plotësuar, sidomos mjetet për lëvizjen në terren. Po ashtu, duhet të përmirësohet planifikimi dhe monitorimi i shpenzimeve operative (*karburant, mirëmbajtje mjetesh*) për të garantuar funksionimin efektive e të vazhdueshme të mjeteve. Është më se e nevojshme të plotësohet dhe përditësohet baza materiale për inspektimet, kryesisht me pajisje IT (kompjuterë, tablet, etj) dhe pajisje monitorimi (dylbi, GPS, drone) e mjete matëse për pyjet.
- q. Për veprat penale në pyje duhet angazhim më i madh i organeve të sigurisë (polici, prokurori). **Eksperiencia e dikurshme e oficerave të policisë gjyqësore** pranë Drejtorive të Shërbimit Pyjor ka qenë mjaft pozitive në lehtësimin e bashkëpunimit me organet e prokurorisë dhe rriste ndjeshëm edhe shkallën e përgatitjes dhe ndjeshmërisë ndaj shkeljeve në pyje.
- r. Në nivel vendor, **61 bashkitë duhet të rrisin ndërgjegjësimin e tyre dhe të forcojnë kapacitetet e tyre administrative përgjegjëse** për mjedisin, pyjet, ujin dhe mbetjet për të identifikuar dhe parandaluar mjedisore. Bashkitë duhet që të pajisin stafin me pajisje dhe trajnimet e nevojshme për të kryer detyrat e tyre dhe të sigurojnë mbështetje politike për të përballuar punën pa asnjë ndërhyrje.
- s. **Institucionet akademike përkatëse (drejtësisë, pyjeve, shkencave të natyrës) duhet të rrisin kapacitetet e nevojshme për adresimin** e problemeve që lidhen me përgatitjen e stafeve akademike, dhe duke zhvilluar trajnime specifike lidhur me krimin mjedisor. Njëkohësisht, është mëse e nevojshme që programi i lëndëve që zhvillohen aktualisht në këto institucione të përfshijë njohuri mbi organizimin dhe kryerjen e inspektimeve si dhe ndjekjen apo hetimin e krimeve mjedisore apo edhe hartimin/plotësimin e proces-verbaleve apo formave standarde të vlerësimit.
- t. Rekomandohet që institucionet akademike të organizojnë aktivitete të përshtatjes së kurrikulave si Kongrese apo konferenca shkencore, ku të studiohet nevoja dhe të induktojnë masat për përshtatjen e kurrikulave për përfshirjen e lëndëve apo seksioneve të caktuara didaktike që lidhen me trajtimin e Krimin Mjedisor. Ofrimi i programeve të studimit “Master profesional” në inspektimin e krimeve mjedisore mund të kontribuonte ndjeshëm në plotësimin e mangësive për personel të kualifikuar. Rekomandohet që institucionet akademike të organizojnë evente madhore të përshtatjes së kurrikulave si Kongrese apo Konferenca shkencore, të cilat të studiojnë nevojën dhe të induktojnë masat për përshtatjen e kurrikulave për përfshirjen e lëndëve apo seksioneve të caktuara didaktike që lidhen me trajtimin e Krimin Mjedisor. Ofrimi i programeve të studimit “Master profesional” në inspektimin e krimeve mjedisore mund të kontribuonte ndjeshëm në plotësimin e mangësive për personel të kualifikuar.



Literatura

- EFFACE (2016), "Environmental Crime and the EU: Synthesis of the Research Project," European Union Action to Fight Environmental Crime (EFFACE), pp.46. https://efface.eu/sites/default/files/publications/EFFACE_synthesis-report_final_online.pdf
- EIA (2008), "Environmental Crime. A threat to our future", Banks D., Davies Ch., Gosling J., et al (Eds), https://www.unodc.org/documents/NGO/EIA_Ecocrime_report_0908_final_draft_low.pdf
- EUROPOL (undated), "Defining serious and organized crime", <https://www.europol.europa.eu/socta/2017/defining-serious-and-organised-crime.html>
- EUROPOL (2011), "EU Organised Crime Threat Assessment. OCTA 2011", file:///C:/Users/User/Downloads/octa_2011_1.pdf
- GIZ (2017), "National Assessment of Biodiversity Information Management and Reporting Baseline For Albania", May, https://balkangreenenergynews.com/wp-content/uploads/2017/08/Albania-Assessment_ENG.pdf
- Nellemann C., Henriksen R., Pravettoni R., et al., (Eds) (2018), "World atlas of illicit flows. A RHIPTO-INTERPOL-GI Assessment. RHIPTO -Norwegian Center for Global Analyses, INTERPOL and the Global Initiative Against Transnational Organized crime, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/09/Atlas-Illicit-Flows-FINAL-WEB-VERSION-copia-compressed.pdf>
- Nellemann, C., Henriksen, R., Kreilhuber, A., et al., (Eds) (2016), "The Rise of Environmental Crime – A Growing Threat To Natural Resources Peace, Development And Security. A UNEPINTERPOL Rapid Response Assessment", United Nations Environment Programme and RHIPTO Rapid Response–Norwegian Center for Global Analyses, https://wedocs.unep.org/bitstream/handle/20.500.11822/7662/-The_rise_of_environmental_crime_A_growing_threat_to_natural_resources_peace%2C_development_and_security2016environmental_crimes.pdf.pdf?sequence=3&isAllowed=y
- Raporti i Prokurorit te Pergjithshem, mbi gjendjen e kriminalitetit ne Shqiperi, viti 2021, https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/
- Udhëzuesin e OSBE për kompetencave të autoriteteve vendore për adresimin e krimit mjedisor dhe procedurat standarte operacionale për zyrtarët vendorë të angazhuar në mbrojtjen e pyjeve, ajrit, ujit dhe tokës, 2019. <https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/451606.pdf>
- Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, Albania Report 2022, [Albania Report 2022 \(europa.eu\)](Albania_Report_2022_(europa.eu))
- MEDIA DHE ÇËSHTJET MJEDISORE NË SHQIPËRI, Raportimi në media i pesë çështjeve të përzgjedhura mjedisore, Eco Albania Raport-MECA_ALB.pdf (ecoalbania.org)
- SANE 27, Chapter 27 Environment and Climate Change, Screening preparatory assessment report.
- SPIDER WEB (2019). Baseline Study Report. Startegic Proeject to Increase the Detection and Disruption of ENVironemntal Crime in the Western Balkan. IMPEL, July 2019

8. Shtojca

Shtojca nr.1: Gjetje dhe rekomandime të shtuara nga takimi teknik i mbajtur në 2 shkurt 2023

Tavolina A: Aspekte hetuese dhe ndëshkuese (Prokurori, Polici)	Tavolina B: Institucionale (Institucionet menaxhuese, inspektuese)	Tavolina C: Edukimi dhe ndërgjegjësimi (Media, NGO, akademia)
		
<p>a. Ndër strukturat zbatuese të kuadrit ligjor, kryesisht struktura inspektuese apo kontrolluese është ajo që e ka për detyrë të bëjë kallëzimin penal tek strukturat e zbatimit të ligjit.</p> <p>b. Inspektoratet që veprojnë në Shqipëri janë autoritetet kryesore që vënë në zbatim rregullat e ndjekjes dhe ndëshkimit të shkeljeve mjedisore si dhe vënë shkelësit përpara përgjegjësisë për t'u përgjigjur. Këto janë inspektorate teknike dhe duhet të jenë vazdimisht të përgatitur por kjo nuk ndodh sepse këto inspektorate sidomos vitet e fundit janë ristrukturuar disa herë. Prandaj duhet të shmangen ristrukturimet e vazhdueshme pasi në këtë mënyrë institucioni humbet "memorien" duke qenë se të trajnuarit largohen ose ripozicionohen.</p>	<p>a. IKMT shprehet se nuk ka bashkëpunim me policinë e shtetit. Shpesh, fokusi kryesor ngelet tek organet inspektuese – policia merret me ne – por jo me kundërvajtjen që ndodh. Nuk kemi një rast, me shkresa zyrtare, që policia të na drejtohet për raste penale (psh cfare lloj druri, etj). Kemi marreveshje, por jo bashkëpunim konkret.</p> <p>b. AKZM – shprehet se ligji është i paqartë, dhe krijon vështirësi zbatimi në terren. AKZM ka të drejtën e inspektimit, dhe tek subjektet e paligjshme dhe ata që kanë leje që ndodhen brenda ZM. Përgjegjësia është e IKMT, por edhe e jona. Në varësi të rastit kjo i hap rrugë interpretimeve të ndryshme. AdZM-të gjithashtu nuk mund të vendosin gjobe.</p>	<p>a. Mungesa e kanaleve efektive të shkëmbimit të informacionit mes autoriteteve publike dhe medias. Shpesh informacioni nuk jepet në kohë dhe media duhet të ndjekë ciklin e gjatë përmes Komisionerit për të Drejtën e Informimit për të siguruar informacion që lidhet me çështjet e mjedisit. Mungon bashkëpunimi në formë sistematike i medias me aktorët dhe institucionet relevante që punojnë në fushën e mjedisit në tërësi apo në atë të Krimit Mjedisor specifikisht.</p> <p>b. Rekomandohet që mund të ishte e udhës, krijimi i strukturave/sectorëve të posaçme të trajtimit të Krimit Mjedisor pranë organeve ligjzbatuese si Polici apo Prokurori.</p> <p>c. Mostrajtimi nga ana e organeve ligjzbatuese, i çështjeve të denoncuar nga OJF-të apo qytetarët, ul nivelin e besueshmërisë të tyre ndaj adresimit të çështjeve mjedisore. Shpesh kjo përbën një vështirësi të shtuar në</p>

<p>c. Në praktikë vërehen mangësi të hetimit në pyje me metoda të thëlluara e të specializuara.</p> <p>d. Prokuroria kërkon prej institucioneve të administratës publike analiza teknike për të marrë në shqyrtim dhe për të ndjekur e ndëshkuar penalisht shkeljet kundër mjedisit, por në momentin që këto institucione përgjigjen, vihet re se përgjigjet janë jo të plota dhe me analiza të pa kryera sepse institucionet shpjegojnë se i mungojnë aparaturat e nevojshme për të bërë matjet dhe analizat teknike që kërkohen prej tyre.</p> <p>e. Prokuroria është një nga hallkat e këtij zingjir institucional, por e ka të pamundur të kryejë funksionin e saj për sa kohë nuk funksionon i gjithë ingranazhi. Në këtë drejtim, nuk është e arsyeshme që institucionet përkatëse për inspektimin e mjedisit të kërkojnë që matjet dhe analizat t'i kryejë prokuroria, sepse kjo është detyrë që i përket atyre. Gjithashtu, vihet re një mungesë ekspertësh të fushës dhe të laboratorëve për të matur dëmin në mjedis në mënyrë që të lehtësojnë dhe ndihmojnë prokurorinë. Pra mungesa në realizimin e analizave të nevojshme për të përcaktuar dëmin përfshin si burimet njerëzore, ashtu edhe ato materiale.</p> <p>f. Qëndron rekomandimi për t'iu përgjigjur nevojës për të qartësuar terminologjinë përgjithësuere në Kodin Penal, lidhur me masën e dëmit dhe me masën e ndotjes. Po ashtu, duhet mbajtur parasysh se nëpunësit civilë janë kallëzuesit kryesorë sipas ligjeve të tyre të posaçme, pra përgjegjësia bie mbi ata detyra, sepse ata kanë për detyrë të bëjnë vlerësimin rast pas rasti. Në këtë aspekt, nuk përbën problem legjisllacioni në vetvete, por zbatimi i tyre nga inspektorët sipas legjisllacionit. Janë</p>	<p>c. ARM Fier – Mangësitë në kuadrin ligjor, kapacitete (mjete), movitim kanë zbehur punën dhe ndërhyrjet nga ana jonë. Duhet të kemi një motivim, të paktën mjetet bazike që të marrim të dhënat (kampionime). ARM Fier mbulon një territor të konsiderueshëm. Përbal dinamikës së lartë që përballemi në terren, duhet të jemi me patjetër të motivuar.</p> <p>d. AKP: nisur nga eksperiencia, marrëveshjet nuk ndryshojnë asnjë gjë, përfshirë këtu edhe ngritjen e grupeve të punës.</p> <p>e. AdZM Elbasan: problem gjithashtu është edhe ikja e punonjesve, sapo trajtohen largohen, dhe gjithashtu paga jo e kënaqshme.</p> <p>f. AKZM: për AdZM të qartësohen ose të rritet kuptimi për ndarjen/dallimin midis kundravajtjeve administrative apo rasteve penale në Zonat e Mbrojtura. Rojet mjedisore ose specialistët të aftësohen për të mbajtur proces-verbal kur identifikohen ose evidentohen rastet e shkeljes (përfshirë shumë hapa, psh kampionimin).</p> <p>g. AKP: nuk ka burime njerëzore të duhura. Patjeter që AKP ka nevojë për baze materiale (manuale) për trajnime, jo detyrimisht trajnime.</p>	<p>punën e OJF-ve në evidentimin dhe denoncimin e rasteve të tjera të krimt mjedisor duke i përballuar ato me shkelësit dhe presionin e kërcënimit e këtyre të fundit.</p> <p>d. Një nga elementet e veprave kundër mjedisit janë edhe trajtimi i mbetjeve, për të cilat është vështirësisht i gjendshëm informacioni së si trajtohen rrymat specifike të mbetjeve në mënyrë përfundimtare. Mungon ky informacion i destinacionit përfundimtar si dhe i proceseve të trajtimit të rrymave të caktuara të mbetjeve.</p>
--	--	--

<p>këta të fundit, që duhet të propozojnë edhe aktet nënligjore kur në punën e tyre të përditshme konstatojnë mangësi që mund të rregullohen me akt nënligjor.</p> <p>g. Është e nevojshme që të adresohet mungesa e proscverbaleve dhe e tipologjisë së dokumentacionit, i cili nevojitet për të plotësuar në mënyrë të standardizuar sipas ligjeve specifike dhe Kodit të Procedurës Administrative (përmes formularëve të thjeshtë të cilët duhet të vihen në përdorim të inspektorëve, ku të përcaktohen fushat në formë tabelarë psh nëse ndotja e shkaktuar apo dëmi ndaj mjedisit janë brenda apo tej normës së lejuar për të bërë dallimin midis shkeljeve administrative nga ato më të rënda që mund të ndiqen nga ana penale.</p> <p>h. Këshillohet të adresohet mungesa e një sistemi të unifikuar <i>on-line</i> për strukturat ku të raportohen kundërvajtjet mjedisore dhe të mos ketë mundësi për të shmangur përgjegjësinë institucionet e ndryshme të administratës, pasi gjurma e raportimit mbetet në sistemin e unifikuar, gjë që i shërben edhe prokurorëve gjatë hetimit. Po ashtu vendosja e regjistrave elektronikë publik në dispozicion të hetimit, duke përfshirë lejet dhe licencat mjedisore, etj.</p> <p>i. Këshillohet të eliminohet rekomandimi specifik lidhur me nevojën për trajnimin e prokurorëve dhe specializimin e tyre në fushën e shkeljeve kundër mjedisit, pasi kjo kërkesë është tashmë e plotësuar. Në trupën e prokurorisë në të gjithë vendin ka prokurorë të gatshëm për të vepruar në çdo kohë dhe ka një numër publik të aksesueshëm nga të gjithë. Kushdo, qoftë qytetarët apo anëtarë të administratës publike mund të konsultohen kurdo me prokurorët.</p>		
--	--	--

Shtojca nr.2: Pyetje të mundshme kërkimore: Analiza ligjore, mjedisore dhe institucionale

Institucioni	Pyetje
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	1. A keni pasur raportime të shpeshta për mjedisore?
	2. Cili është numri i raportimeve për krime mjedisore në 3 (tre) vitet e fundit?
	3. A ka grup të dedikuar pune për mjedisore në polici?
	4. A ka trajnime të ndërmarra nga forcat policore me qëllim specifik për rastet e krimeve mjedisore?
	5. A keni bashkëpunim të vazhdueshëm me prokurorinë mbi rastet e krimit mjedisor?
	6. Sa është përqindja e individëve që pasi procedohen për krime kundër mjedisit, marrin dënimin me burgim apo dënime alternative?
	7. Cilat janë mekanizmat e vendosur për të siguruar/inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesuara nga zinxhiri i përputhshmërisë dhe zbatimit, në rastet e krimit mjedisor dhe cila është shtrirja dhe shpeshësia e tyre?
	8. A ka ndonjë mekanizëm për të inkurajuar publikun e gjerë që të raportojë tregtinë e paligjshme tek autoritetet përkatëse për hetime të mëtejshme të zbatuara në vendin tuaj?
Prokuroria e Përgjithshme	9. Cili ka qenë numri i procedime penale për sa i përket krimeve mjedisore në 3 (tre) vitet e fundit?
	10. Cili është numri i çështjeve penale për të cilat janë çuar në gjykatë në 3 (tre) vitet e fundit?
	11. A janë kryer trajnime specifike nga ana e prokurorëve në Shqipëri për sa i përket krimeve mjedisore dhe rregulimeve ligjore mbi to?
	12. A ka marrëdhënie specifike ndër-institucionale me Policinë e Rendit për sa i përket krimeve mjedisore?
Gjykata	13. Cili ka qenë numri i çështjeve në Gjykatat Shqiptare për sa i përket krimeve mjedisore në 3 (tre) vitet e fundit?
	14. Cili ka qenë numri i çështjeve të pushuara nga Gjykatat Shqiptare për sa i krimeve mjedisore në 3 (tre) vitet e fundit?
	15. A ka pasur bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm midis Gjykatave Shqiptare dhe institucioneve përkatëse për sa i përket rasteve të krimeve mjedisore?
	16. A ka pasur trajnime për gjyqtarët mbi legjislacionin e mjedisit dhe krimit mjedisor?
	17. A ka pasur një tendencë në rritje për sa i përket ashpërsimit të dënimeve që cakton gjykata në lidhje me krime kundër mjedisit në 3 (tre) vitet e fundit?
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	18. A planifikohet të zgjerohet fusha e veprimit të legjislacionit përkatës për sa i përket krimeve mjedisore?
	19. Cilat janë autoritetet shtetërore të përfshira në zbatimin e legjislacionit për krimin mjedisor?

	<p>20. A janë duke u ndërmarrë iniciativa ligjore (projektligje) për sa i përket krimeve mjedisore?</p> <p>21. A po zhvillohen bisedime me vende fqinje për të marrë praktikat më të mira për sa i përket legjislacioneve të huaja në qasjet ndaj krimeve mjedisore?</p> <p>22. A shihet si një objektivi i rëndësishëm rritja e bashkëpunimit ndër-institucional me organet e tjera shtetërore për rritje e mbrojtjes mjedisore</p> <p>23. A kanë institucionet shtetërore synimin të ashpërsojnë masat që mund të merren ndaj aktorëve të rëndësishëm në fushën e mjedisit duke vënë në zbatim detyrime më të përcaktuara dhe shtërnguese për veprimtari për të cilat është e domosdoshme leja mjedisore?</p> <p>24. A zhvillon Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe drejtoritë e saj aktivitete ndërgjegjësuere për rëndësinë e zbatimit të ligjeve në mbrojtje të mjedisit?</p>
<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Drejtoria e Inspektimit Mjedisor</p>	<p>25. Cilat janë kompetencat e institucionit tuaj në lidhje me verifikimin/inspektimin/ndjekjen e shkeljeve mjedisore</p> <p>26. Cili është numri i raportimeve për shkelje mjedisore në 3 (tre) vitet e fundit?</p> <p>27. A keni një nevojë për më shumë burime njerëzore/kapacitete specifike?</p> <p>28. A keni inventarin e duhur të jeteve dhe pajisjeve?</p> <p>29. A ka pasur trajnime për stafin e Agjencise mbi legjislacionin e mjedisit dhe shkeljeve mjedisore</p> <p>30. Cilat janë mekanizmat e vendosur për të siguruar/inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesuara nga zinxhiri i përputhshmërisë dhe zbatimit, në rastet e shkeljeve mjedisore dhe cila është shtrirja dhe shpeshësia e tyre?</p> <p>31. A ka ndonjë mekanizëm për të inkurajuar publikun e gjerë që të raportojë shkeljet mjedisore te autoritetet përkatëse për hetime të mëtejshme?</p>
<p>Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore</p>	<p>32. Cilat janë kompetencat e institucionit tuaj në lidhje me verifikimin/inspektimin/ndjekjen e shkeljeve mjedisore në burimet ujore?</p> <p>33. Cilat janë shkeljet me të shpeshta mjedisore të raportuara apo evidentuara nga ju në burimet ujore?</p>
<p>Ministria e Brendshme</p>	<p>34. A ka një nevojë për më shumë burime njerëzore në institucionet shtetërore përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen e krimeve (mjedisore)?</p> <p>35. A funksionojnë në të mirë të zbulimit të krimeve kundër mjedisit aplikacionet e dedikuara për përfshirjen e qytetarëve në denoncimin e krimeve apo kundërvajtjeve si Komisariati Digjital?</p> <p>36. A bashkëpunon Ministria e Mbrojtjes në instancat e saj përgjegjëse për mbrojtjen civile në rastet e emergjencave (përfshirë ato natyrore) të lidhura me mjedisin, me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë vendit për t'u trajnuar e për të qenë të përditësuar me metodat e reja e më efikase të përballimit të situatave të jashtëzakonshme?</p> <p>37. A po bashkëpunojnë institucionet vendase të mbrojtjes me organe simotra në vendet fqinje apo të BE-së për t'u trajnuar dhe për të shkëmbyer përvojë sa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe zbulimit e ndëshkimit të krimit mjedisor?</p>

<p>Inspektoriati Kombëtar i Menaxhimit të Territorit</p>	<p>38. Cilat janë kompetencat e institucionit tuaj në lidhje me verifikimin/inspektimin/ndjekjen e shkeljeve mjedisore</p> <p>39. Cili është numri i raportimeve për shkelje mjedisore në 3 (tre) vitet e fundit?</p> <p>40. A keni një nevojë për më shumë burime njerëzore/kapacitete specifike?</p> <p>41. A keni inventarin e duhur të jeteve dhe pajisjeve?</p> <p>42. A ka pasur trajnime për stafin tuaj mbi legjislacionin e mjedisit dhe shkeljeve mjedisore</p> <p>43. Cilat janë mekanizmat e vendosur për të siguruar/inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesuara nga zinxhiri i përputhshmërisë dhe zbatimit, në rastet e shkeljeve mjedisore dhe cila është shtrirja dhe shpeshësia e tyre?</p> <p>44. A ka ndonjë mekanizëm për të inkurajuar publikun e gjerë që të raportojë shkeljet mjedisore te autoritetet përkatëse për hetime të mëtejshme?</p>
<p>Drejtoria e Doganave</p>	<p>45. Çfarë është në dispozicion të inspektimit dhe doganës në kontrollin e pajtueshmërisë?</p> <p>46. Cilat janë kompetencat e inspektimit?</p> <p>47. Si i regjistroni të dhënat për dërgesat ndërkufitare të mbetjeve dhe specieve të rrezikuara?</p>
<p>Akademia e Sigurise/Universite shtetërore</p>	<p>48. A trajtohet legjislacioni mjedisor dhe ndaj mjedisit si pjesë e programeve të studimit që ofrohen nga Institucioni juaj</p> <p>49. A ofroni kurse/trajnime të specializuara për institucionet shtetërore të përfshira në luftën ndaj krimit mjedisor</p>
<p>NGOs/gazetarë investigativ</p>	<p>50. Cilat janë sipas jush problematikat në raportimin , investigimin dhe ndjekjen ligjore të krimeve mjedisore</p> <p>51. A bashkëpunoni me organet shtetërore lidhur me mjedisore? Si do ta pershkruani këtë bashkëpunim?</p> <p>52. Cili është roli i organizatës suaj në adresimin e krimit mjedisor në vend?</p> <p>53. A është organizata juaj pjesë ndonjë rrjeti ndërkombëtar që trajton krimin mjedisor</p> <p>54. Cilat janë elementet/llojet e krimit mjedisor që ju keni hasur më shpesh në punën tuaj gjatë viteve të fundit</p> <p>55. Çfarë hapash ndiqni ju zakonisht në adresimin e krimit mjedisor</p> <p>56. Si është bashkëpunimi juaj me institucionet dhe median?</p>
<p>Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura</p>	<p>57. Cilat janë kompetencat e institucionit tuaj në lidhje me adresimin e krimit mjedisor?</p> <p>58. A keni ju një regjistër të rasteve të krimit mjedisor dhe si e mirëmbani atë?</p> <p>59. Në çfarë niveli është bashkëpunimi me hallkat e tjera të zinxhirit institucional të adresimit të krimit mjedisor në rrjetin e ZM-ve?</p> <p>60. A keni ju një plan të rritjes së kapaciteteve të personelit tuaj për një adresim të rasteve të krimit mjedisor brenda rrjetit të ZM-ve?</p> <p>61. A do të donit të ndryshonit diçka specifike në kuadrin ligjor e cila sipas jush mund të adresonte në mënyrë më efektive krimin mjedisor brenda ZM-ve në Shqipëri?</p>
<p>Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura</p>	<p>62. Si i ndjekin Rojet Mjedisore rastet e krimit mjedisor brenda ZM-ve?</p>

	<p>63. A keni ju bashkëpunim me autoritetet e tjera vendore apo qendrore ne lidhje me adresimin e rasteve të krimit mjedisor?</p> <p>64. Cfarë pajisjes/mjetesh keni ju në dispozicion për adresimin e krimit mjedisor brenda ZM-ve?</p> <p>65. A keni marrë pjesë në trajnime qe lidhen specifikiisht me trajtimin e krimit mjedisor brenda ZM-ve?</p>
Bashkitë	<p>66. Cili është roli i institucionit tuaj në adresimin e krimit mjedisor? Cili është departamenti/sektori përkatës?</p> <p>67. Çfarë burimesh financiare dhe mjetesh keni ju në dispozicion për adresimin e krimit mjedisor</p> <p>68. Cilat janë llojet e krimeve mjedisore qe ka referuar më së shumti institucioni juaj?</p>
Universitetet	<p>69. Cila është pesha e çështjeve që lidhen me krimin mjedisor që trajtohen në kurrikulën e institucionit tuaj?</p> <p>70. A mendoni se studentët marrin mjaftueshëm njohuri për të qenë të aftë të trajtojnë krimin mjedisor në rolin e specialistit të ardhshëm?</p> <p>71. A organizon institucioni juaj leksione te4 hapura apo ëorkshope që trajtojnë tematika të adresimit të krimit mjedisor?</p>

Shtojca nr.3: Lista e aktorëve dhe institucioneve të intervistuar

Institucioni	Pozicioni
Ministria e Brëndshme	Zëvendës Ministër
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Specialist ne Sektorin e Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Drejtor i Kerkimit dhe Njohurive Mjedisore
	Drejtor i Vleresimit te Impaktit dhe Licensimit
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	Drejtor i Drejtorisë të Monitorimit së Projekteve
Administrata e Zonave të Mbrojtura Fier	Drejtor
Administrata e Zonave të Mbrojtura Vlorë	Drejtor i Komanduar
Administrata e Zonave të Mbrojtura Elbasan	Shefi i Sektorit të Monitorimit
	Specialist Monitorimi
	Specialiste Menaxhimi
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	Përgjegjës Sektori
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Shef i Sektorit të Krimeve mbi Pronën dhe Mjedisin
Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit	Drejtor i Mjedisit
	Drejtor i Pyjeve
Prokuroria e Përgjithshme	Prokuror - Drejtorja e Koordinimit Institucional / Sektori i Dekriminalizimit
Inspektoriati Shtetëror Shendetesor	Inspektor
Shkolla e Magjistraturës	Drejtor i Shkollës së Magjistraturës
Universiteti Bujqësor i Tiranës	Lektore, <i>Fakulteti i Shkencave Pyjore</i>
	Lektore, <i>Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit</i>
Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë	President
Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri	Drejtor Ekzekutiv
Rrjeti Ballkanik i Investigimit dhe Raportimit - Shqipëri	Drejtoresha Ekzekutiv
Scan TV	Gazetare
Top Channel	Gazetare Inside Story
Elementi I Pestë	Gazetar i pavaruar

Shtojca nr.4: Lista e harmonizimit të direktivave dhe koventave mjedisore

Nr.	Direktiva/ Konventa	Ligji që e ratifikon Direktivën/Konventën	Niveli i harmonizimit
1	Konventa "Për ndalimin e zhvillimit, prodhimit, stokimit e përdorimit të armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre", Gjenevë, më 3 shtator 1992	Ligji nr. 7747, datë 29.07.1993 "Për ratifikimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, prodhimit, stokimit e përdorimit të armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre" zëvendësuar nga ligji nr. 9092, date 3.7.2003 "Për zbatimin e Konventës "Për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre"	
2	Konventa e Bazelit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme", miratuar në vitin 1989 dhe në fuqi që prej vitit 1992.	Ligji nr. 8216, datë 13.05.1997 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre"	
3	Konventa e Bernës "Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës", firmosur në vitin 1979	Ligji nr. 8294, datë 02.03.1998 "Për ratifikimin e "Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës)"	
4	Konventa e Vienës "Për mbrojtjen e shtresës së ozonit" dhe Protokollin i Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit", në fuqi që prej vitit 1988 dhe ratifikuar në mënyrë universal në vitin 2009	Ligji nr. 8463, datë 10.03.1999 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vienës "Për mbrojtjen e shtresës së ozonit" dhe Protokollin e Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit"	
5	Konventa ndërkombëtare e mbrojtjes së bimëve, miratuar në vitin 1997	Ligji nr. 8483, datë 10.05.1999 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën ndërkombëtare të mbrojtjes së bimëve"	
6	Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësi të serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë", Paris, 14 Tetor 1994	Ligji nr. 8556, datë 22.12.1999 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësi të serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë"	
7	Konventa për të drejtën e publikimit për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, Aarhus, 25.06.1998	Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000, "Për ratifikimin e "Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikimit për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"	
8	Konventa "Për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja", Barcelonë, më 16 shkurt 1976	Ligji nr. 8690, datë 16.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zones bregdetare të detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese"	
9	Konventa "Për mbrojtjen e llojeve shtegtuese të kafshëve të egra", firmosur në 1979, në Bon	Ligji nr. 8692, datë 16.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bonit "Për mbrojtjen e llojeve shtegtuese të kafshëve të egra" dhe mirëkuptimet e kësaj Konvente"	
10	Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër, miratuar në Uashington, firmosur në vitin 1973 dhe në fuqi që prej vitit 1975	Ligji nr. 9021, datë 6.3.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër (CITES)"	

11	Konventën ndërkombëtare detare "Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi (OPRC), në fuqi që prej datës 13.05.1995	Ligji nr. 9692, datë 8.3.2007 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare detare "Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi (OPRC),1990"	
12	Konventa për përgjegjësinë civile për dëmet nga ndotjet me karburant e vitit 1992 (Konventa për përgjegjësinë civile, 1992)	Ligji nr. 9293, datë 21.10.2004 "Për aderimin e republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare "Për përgjegjësinë civile për dëmet nga ndotjet me karburant, 1992"	
13	Konventa ndërkombëtare për ndërhyrjen në det në raste të dëmtimeve shkaktuar nga ndotjet me karburant, e vitit 1969	Nuk është ratifikuar	
14	Konventa për përgjegjësinë civile në fushën e transportit detar të materialeve bërthamore, e 1971	Nuk është ratifikuar	
15	Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për transportin e mallrave me rrugë detare (Rregullat e Hamburgut)", e 1978.	Ligji nr. 9504, datë 3.4.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për transportin e mallrave me rrugë detare (Rregullat e Hamburgut)"	
16	Konventa ndërkombëtare për vendosjen e një fondi ndërkombëtar për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ndotjet me karburant, e 1971	Nuk është ratifikuar	
17	Konventa e Helsinkit për ujërat rrjedhëse ndërkufitare, e vitit 1992	Nuk është ratifikuar	
18	Direktiva e Këshillit 2003/87/EEC, datë 13 tetor 2003, "Vendosja e një skeme për emetimin e gazeve nga serat që lejon tregtinë Brenda Komunitetit dhe amendon Direktivën 96/61/EC"	Ligji nr. 155, datë 17.12.2020, "Për ndryshimet klimatike"	
19	Direktiva e Këshillit 2000/60/EC dhe Parlamentit Evropian e 23.10.2000 që vendos një plan veprimi kuadër për BE në fushën e politikave për ujërat	Ligji nr. 111 datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"	
20	Konventën e Roterdamit "Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare, e vitit 1998, rishikuar në 2005	Ligji nr. 10 277, datë 13.5.2010 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit "Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare"	
21	Konventa ndërkombëtare detare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet", e vitit 1973	Ligji nr. 9, datë 18.02.2020 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973", të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)	
22	Konventa ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet nga ndotjet me karburant bunkerit, e vitit 2001	Nuk është ratifikuar	

23	Konventa për ndotësit organikë të qëndrueshëm', Stokholm, e 2001	Ligji nr. 9263, datë 29.7.2004 Për ratifikimin e "Konventës së Stokholmit 'Për ndotësit organikë të qëndrueshëm'"	
24	Marrëveshja e Parisit, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike, datë 12.12.2015	Ligji nr. 75, datë 14.07.2016 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike"	
25	Konventa e Kiotos, në fuqi më 16.02.2005 me periudha përfundimi deri në 31.12.2012 për periudhën e parë dhe 31.12.2020 për periudhën e dytë	Ligji nr. 9334, datë 16.12.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e Kiotos, të konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike". Ligji 116/2020 "Për aderimin në amendamentin Doha, të protokollit të Kiotos, të konventës kuadër të kombeve të bashkuara, për ndryshimet klimatike, aderuar me ligjin nr.9334, datë 16.12.2004" ⁶⁷	
26	Konventën e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe"	Ligji nr. 9425, datë 6.10.2005, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe"	
27	Konventa e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"	Ligji nr. 10062, datë 29.01.2009, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare", të Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"	
28	Konventa e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"	Ligji nr. 10063, datë 29.01.2009, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30%" të Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"	
29	Konventa e Roterdamit "Për procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare	Ligji nr. 10277, datë 13.5.2010, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit "Për procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare"	
30	Konventa e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"	Ligji nr. 10436, datë 28.6.2011, " Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për reduktimin e mëtejshëm të çlirimit të squfurit" të Konventës "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"	
31	Direktiva e KE-së 1999/31/EC, datë 26.4.1999, "Për lëndfilllet e mbetjeve"	VKM nr. 452, datë 11.7.2012, "Për lëndfilllet e mbetjeve"	

⁶⁷ Shqipëria, duke qenë se është vend në zhvillim, nuk bën pjesë në palët e përfshira në aneksin I, në bazë të protokollit të Kiotos. Megjithatë aderimi në 2020 në amendamentin Doha të protokollit të Kiotos është një hap i vlefshëm për veprim global klimatik.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

■ **Prezenca e OSBE-së në Shqipëri**
Sheshi “Italia”,
Tirana, Albania

■ Tel: +355 4 2240001
🌐 www.osce.org/presence-in-albania
✉ pm-al@osce.org
🐦 @OSCEinAlbania
📘 @OSCE.Albania
📷 @osceinalbania